Përveç kësaj, siguria është një shqetësim i vazhdueshëm dhe në rritje. Për të mbrojtur korsitë vitale të anijeve dhe ekonominë globale, agjencitë qeveritare mbështeten në shërbimet e monitorimit të anijes për të mbrojtur Zona Ekonomike Ekskluzive (EEZ). Bizneset tregtare gjithashtu gjurmojnë anijet e tyre që tu garantojnë siguri dhe mbrojtje kundër humbjes së pasurive të vlefshme. Sistemet satelitore të navigimi dhe komunikimit international (ICON) ofrojnë subjekte publike dhe sipërmarrje komerciale me aftësinë për monitorim efikas dhe përgjigje efektive për aktivitetin e anijes.

1.2.1 Sistemet Satelitore ICON

Sot, komunikimi globale për zonat e thella është një karakteristikë e mirë-krijuar e shërbimeve satelitore. Përveç kësaj, Global Navigation Satellite Systems (GNSS) mundësojnë ndjekjen globale të pasurive mobile. Sistemet satelitore ICON në mënyrë të përsosur integrojnë komunikimin satelitor dhe të navigacionit për të siguruar një shërbim të ri për të përmbushur nevojat e komunitetit detar.

Sistemet satelitore ICON do të sigurojnë një sistem global komunikimi hapësinor me shërbime survejimi me vlerë të shtuar për ndjekjen/gjurmimin e anijeve në të gjithë botën dhe një zgjidhje pikë me pikë(end-to-end) për gjurmimin e aseteve dhe menaxhimin e flotës, pozicionimin dhe ndjekjen, dërgimin e mesazheve dhe sigurinë për të gjitha llojet e anijeve në det përmes komunikimeve satelitë gjeostacionar Inmarsat dhe dy mikro-satelitëve në orbitë të ulët të Tokës për të siguruar mbulimin e rajoneve polare. Kjo do të rrisë sigurinë në rajonet detare, do të mundësojë menaxhimin efikas të flotave të peshkimit dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve detare. Shërbimi punëson një mjet bazuar në terminalin e përdoruesit për të dërguar dhe për të marrë pozitën e lundrimit dhe informacione të tjera, si pjesë e mesazheve dixhitale. (SpaceTech7, Delft University of Technology Delft, The Netherlands, June 2005). Shërbimet e siguruara nga Sistemet Satelitore, janë paraqitur në tabelën 1.1si më poshtë.

Tabela 1.1. Shërbimet e siguruara nga Sistemet Satelitore ICON:

Shërbimi Bazë	Përshkrimi
Monitorimi i Mjetit	Transferimi automatik i rregullt i të dhënave të lundrimit të anijes dhe identifikimi.
Two-way Messaging[7]	Shkëmbimi i mesazheve të shkurtër ndërmjet përdoruesit detar dhe atij tokësor.
Ditar udhëtimi elektronik	Raportimi i aktiviteteve në bord, psh sasia e peshkut të kapur, përmes formave të paracaktuara.

[7] Njoftim dy –mënyrësh/krahësh

Geo-Fencing Alarm	Sigurimi i mesazheve të alarmit pasi zona të kufizuara janë shkelur/cënuar
Njoftim Alarmi/fatkeqësie	Transmetimi i mesazheve alarm nga një anije ne pritje të mesazhit të pranimit/njohjes

Sistemet satelitore ICON kanë krijuar një arkitekturë misioni të integruar që do të mundësojë një shumëllojshmëri shërbimesh për të përmbushur nevojat e tregut. Kjo arkitekturë përbëhet nga tri pjesë kryesore: segmenti i përdoruesit, segmentit i hapësirës dhe segmenti terren. Një segment përdoruesi përbëhet nga të gjithë terminalet e Sistemeve Satellitore ICON në bordin e anijes. Segmenti hapësirës është i përbërë nga Inmarsat dhe 'Mikro-satelitët që i përkasin Sistemeve Satelitore ICON. Së fundi, segmenti terren përfshin Qendrën e Shërbimit të Sistemeve Satelitore ICON si dhe ndërfaqe të Inmarsat.



Figura 1.3 Arkitekturë e Integruar që mundëson një shumëllojshmëri shërbimesh(SpaceTech7, June 2005)

- **Shërbimet e Sistemeve Satelitore ICON**

Në bazë të një ankete të gjerë të klientit, sistemet satelitore ICON kanë zhvilluar shërbimet modulare të përshtatura për nevoja specifike. Këto përfshijnë: Distress Messaging(dërgimi mesazheve të fatkeqësive ose shqetësuese), Vessel Monitoring(Monitorimi i Mjetit), Geo-

Fencing Alarm(Alarmi Geo-Fencing), Two-Way Messaging(Two-Way Mesazhimi) dhe Electronic log-book(libër logimi elektronik). Më poshtë kemi përshkruar vetëm dy prej këtyre shërbimeve modulare: Vessel Monitoring dhe Two -Way Messaging.

Ky koncept i shërbimit modular në të ardhmen do të lehtësojë shtimin e shërbimeve të tilla si raportimi i motit te anijet ose shërbimet e SCADA(Supervisory Control and Data Acquisition).



Figura 1.4 Disa Shërbime te Sitemeve Satelitore ICON (SpaceTech7, June 2005)

- **Monitorimi i Mjeteve dhe Two-Way Messaging[8](Rast Studimi Porti i Vlorës)**

Mesazhet dy drejtimshe mund të kryejnë njëkohësisht shkëmbimet anije-me-anije dhe anije-me-breg. Në intervale të rregullta, sistemi i monitorimit të anijes automatikisht transferon navigimin e sigurtë të mjetit dhe identifikimin e të dhënave për te qendra e shërbimit të sistemeve satelitore ICON. Duke iu referuar edhe figurave duhet patur parasysh që:

[8] Kalimi i mesazheve dy-drejtimësh

Figura 1.5 Mesazhet dy drejtimshe në shkëmbimet *anije-me-anije*.(Brigjet e Detit Adriatik, Vlorë, Anije të Bazës së Pashalimanit)

Figura 1.6 Mesazhet dy drejtimshe në shkëmbimet *anije-me-breg*.(Porti i vjetër në Vlorë)

- Shkëmbimi i mesazheve anije-me-anije ofron një komunikim të lehtë, të rehatshëm dhe të sigurt ndër-anijor, pa ndërprerë operacionet rutinë. (Fig.1.5)
- Në shkëmbimin e mesazheve anije-me-breg përdoruesi terminal komunikon me një përdorues tokësor nëpërmjet Qendrës së Shërbimit ICON Satellite Systems.(Fig.1.6)

- Shkëmbimi i mesazheve dy drejtimshe mundëson komunikimin ndërmjet përdoruesve gjeografikisht të largët dhe ofron komunikim të zgjeruar për rojet bregdetare dhe agjencitë e peshkimit.

1.2.2 Rrjetet Celular

Një rrjet celular është një rrjet komunikimi, ku hallka e fundit është pa tel. Rrjeti është i shpërndarë mbi zonat tokësore të quajtura qeliza, ku secila lidhet me një lokacion marrës fiks, i njohur si një site i qelizës apo stacion bazë.

Figura 1.7. Si punon një rrjet celular

Në figurën 1.7, më lartë tregohet qartë se stacioni bazë siguron qelizën me mbulimin e rrjetit i cili mund të përdoret për transmetimin e zërit, të të dhënave, etj... Një qelizë mund të përdor një grup të ndryshëm frekuencash nga qelizat fqinje, për të shmangur ndërhyrjen dhe për të siguruar cilësinë e shërbimit të garantuar brenda çdo qelize. Kur bashkohen së bashku këto qeliza sigurojnë mbulim radio mbi një zonë të gjerë gjeografike. Kjo mundëson një numër të madh të transceivers [9] portativ (p.sh., telefonat celularë, faqet, etj) për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe me transceivers fikse dhe telefona kudo në rrjet, nëpërmjet stacioneve bazë, edhe në qoftë se disa nga transceivers lëvizin përmes më shumë se një qelize gjatë transmetimit.

[9] Marrës-transmetuesa

Arkitektura e përgjithshme e një rrjeti celular është e përbërë nga:

- **Mobile Station (MS) :** Stacioni celular-Baza e telefonisë celulare
- **Base Station (BS):** Stacioni bazë i cili është i lidhur me telefoninë celulare/stacionin celular përmes një ndërfaqe grafike.
- **Mobile Switching Centre (MSC):** qendra mobile e ndryshimit/kalimit e cila kontrollon një numër të caktuar qelizash(cluster_a), duke organizuar stacionet base dhe kanalet per rrjetet celulare dhe lidhjet e trajtuara.
- **National Carrier Exchange:** Kjo është porta drejt PSTN(Public Switched Telephone Network) nacionale fikse. Shpesh është e integruar me MSC(Mobile Switching Centre).



Figura 1.8. Shërbimi Kombëtar Transportues(National Carrier Exchange)

Rrjetet celulare ofrojnë një numër karakteristikash të dëshirueshme:

- Më shumë kapacitet se një transmetues i vetëm i madh, pasi e njëjta frekuencë mund të përdoret për lidhje të shumta për sa kohë që ato janë në qeliza të ndryshme.
- Pajisjet mobile përdorin më pak energji se sa një transmetues i vetëm ose satelit meqë kullat e qelizave janë më afër.

- Zonë më e madhe mbulimi se sa një transmetues i vetëm tokësor, pasi kullat shtesë celulare mund të shtohen në një kohë të pacaktuar dhe nuk janë të kufizuara nga horizonti.

Ofruesit më të mëdhenj të telekomunikacionit kanë vendosur rrjetet e zërit dhe të të dhënave celulare mbi pjesën më të madhe të zonës së banuar të Tokës. Kjo lejon telefonat celularë dhe pajisjet e lëvizshme informatike të lidhen me rrjetin telefonik publik dhe internetin publik. Rrjetet celulare private mund të përdoren për hulumtime ose për organizata të mëdha ose në flotë, të tilla si dërgimi për agjencitë vendore të sigurisë publike apo i një kompanie taksi.

Megjithatë siç mund të kemi theksuar më parë(tek hyrja) edhe këto tipe rrjetesh kanë problemet dhe limitet e tyre, sidomos në sinkronizime dhe problemet me multipath.

Limitimet:

Po nëse …

- nuk ka Infrastrukturë në dispozicion? -P.sh., Në zonat e fatkeqësisë
- ndoshta është shumë i shtrenjtë / i papërshtatshëm për tu ngritur? –P.sh., Në largësi, e site me konstruksion të madh.
- nuk ka kohë për ta vendosur atë? -P.sh., Në operacionet ushtarake

Të gjitha këto janë probleme për tu zgjidhur.

1.2.3 Sistemi Automatik i Identifikimit, AIS

Sistemi Automatik i Identifikimit (AIS) është një sistem automatik i pavarur për shkëmbimin e informacionit lundrues ndërmjet anijeve të pajisura në mënyrë të përshtatshme dhe stacioneve bregdetare duke përdorur mesazhe të qarta dhe operon në dy kanale VHF detare të përcaktuara. (Të dhëna të arshivuara të marra nga Marina: “Reparti Delta Forcë për kufirin dhe Migracionin Vlorë”, Porti i Vjetër Vlorë)



Figura 1.9. Sistemi AIS ndihmesë në Navigim dhe në Aeroplanë(SAR Aircraft)

Ky sistem punon mbi parimin bazë të transferimit të të dhënave në mënyrë elektronike në lidhje me një frekuencë radio valë. Një pajisje AIS përbëhet nga frekuenca shumë të larta (VHF) të transmetuesve dhe marrësve. Transmetuesi dhe marrësi i bashkëngjiten ekranit dhe sistemeve sensorë të anijes nëpërmjet një lidhje komunikimi. Për të marrë informacion të saktë të anijeve të tjera dhe gjithashtu për të dërguar vetë-informacionin e saj, AIS gjithashtu ka një sistem të pozicionimit global (GPS), i cili është i lidhur me një satelit. GPS mund të jetë një pajisje e brendshme e bashkangjitur ose një sistem i pajisur veçmas. AIS është i lidhur edhe me të gjitha sistemet e tjera të anijes dhe kjo është se si ajo merr të dhënat e anijes dhe i dërgonë ato në anije të tjera.

AIS është i njohur edhe si sistemi më i rëndësishëm dhe më i sigurtë i navigimit në bordin e një anije. Siç tregohet edhe në figurën 1.10, a dhe b, më poshtë:



Figura 1.10. a)Parimi i punës së një AIS, b) AIS i integruar në anije

Kjo është për shkak se AIS punon automatikisht dhe vazhdimisht, duke dërguar dhe marr informacione pavarësisht nga pozita e anijes në lidhje me bregun. Për më tepër, edhe pse vetëm një kanal është i nevojshëm për të transferuar të dhënat, AIS ka gjithashtu një kanal të mesëm për të parandaluar çdo lloj ndërhyrje apo humbje të informacionit.

Gjithashtu, pasi secili prej anijeve ka sistemin e vet AIS, ekziston mundësia e lartë e rritjes së trafikut dhe bllokimit në kanalet. Megjithatë, kjo nuk ndodh kurrë. Sistemi AIS ka një sistem automatik që të zgjidhë pengesat midis vetes dhe stacioneve të tjera në dritën e rritjes së ngarkesës. Kjo është e mundur për shkak se çdo stacion ka slot(vendin e vet) e tij të transmetimit. Secili prej slot_eve është rreth 26.6 milisekonda, që do të thotë se çdo stacion mund të transmetojë informacionin gjatë asaj shumë kohë para se shansi të shkoj në stacionin e ardhshëm. Për këtë, ka gjithsej 2,250 sllot_e. Informacioni i dërguar nga një stacion në një slot të caktuar kohe shërben si referencë për informacionin e ardhshëm që vjen i cili ruhet në një slot tjetër të organizuar në mënyrë të rastësishme. Informacioni i marrë dhe i transmetuar nëpërmjet këtyre sllot_eve i transferohet menjëherë çdo automjeti i cili vjen në të njëjtën rang- radio. Kështu 2250 sllot_e të gjithë së bashku do të shërbejnë si një rrjet i përbashkët për të siguruar informacion për të gjitha anijet që vijnë nën kanalin e frekuencave të veçanta.

1.3 Problemet në Komunikimet Ndër-Navale dhe Nevoja për Protokolle të reja.

Siguri në det do të thotë të qëndrosh i lidhur në rrjet. Edhe pse çdo gjë në varkën tuaj është e ruajtur mirë dhe në gjendje të mirë pune, ju do të jeni i sigurt nëse ju jeni të siguruar, dhe kjo do të thotë marrje e informacionit të duhur të lundrimit, kur dërgoni një sinjal në rast emergjence .

Shumë probleme dhe situata si:

- trafiku i lartë
- moti i keq,
- emergjencat shëndetësor,
- urgjenca të tjera

- në anën tjetër shumicën e kohës nuk ka Wi-Fi ose mbulim tjetër, edhe nëse ajo është se nuk ka cilësi të mirë pritje për shkak të relievit dhe motit.

rrisin nevojën për përmirësime në komunikimet ndër-detare.

1.3.1 Komunikimi Anije –Breg

Komunikimi i të dhënave dhe zërit janë në dispozicion ndërmjet anijeve dhe bregut. Këto ndryshojnë nga koha në kohë si përmirësimi i teknologjive dhe lindin shumë plane të shërbimeve me kosto efektive *Komunikimet e-mail dhe aksesi web në det:* E-mail është në dispozicion në një bazë të afërt në kohë reale 24 orë në ditë dhe është metoda primare dhe e preferuar e kontaktit për qëllime personale dhe të biznesit.



Figura 1.11 Komunikime Breg- Anije

Komunikimet broadband të internetit janë kryer nga kërkimet e anijeve nga Scripps[10]-që operon në det me anë të disa satelitëve të pavarur dhe sistemeve celulare. Në det të hapur, sistemi primar është Scripps HiSeasNet, i cili siguron lidhje pothuajse të vazhdueshme të internetit në mbarë botën.

Scripps është një nga qendrat më të vjetra, më e madhe dhe më e rëndësishme për marinën dhe hulumtimin shkencor në tokë, arsimin dhe shërbimin publik në botë. Epërsia e saj në det, tokë, dhe shkenca atmosferike është reflektues i programeve të tij të shkëlqyer, të fakultetit dhe shkencëtarëve të shquar kërkimore, dhe lehtësira të pazgjidhura.

[10] Scripps është një nga qendrat më të vjetra, më e madhe dhe më e rëndësishme për marinën dhe hulumtimin shkencor në tokë, arsimin dhe shërbimin publik në botë.

Gjithashtu duhet të theksojmë se përpos gjithë shërbimeve, shumë të mira e të dobishme që sistemet e komunimeve satelitore dhe ato të rrjetave mobile kanë në komunimet globale ato janë shpesh edhe subjekti i dështimit në det. Komunikimi nuk mund të ndodhë për shembull, kur pamja e antenës satelitore është bllokuar nga superstruktura e anijes, e cila ndodhet zakonisht në pjesën e bashit të anijes...

Problemet:

Tek komunikimet me Satelit ndeshen shpesh këto probleme:

- Kosto e lartë
- Brishtësi, dështime për shkak të infrastrukturës së anijes
- Vonesat
- Dështimi për të dërguar tekste të gjatë ose në imazhe për shkak të rënies/ndërprerjes së shkurtër në linkun satelit-anije.

Disa probleme tek Rrjetet Celular :

a) *Bandwidth të kufizuar* b) *Siguria*

Le të shohim në vazhdim se çfarë është bërë në këtë drejtim dhe çfarë duhet bërë, cili është propozimi ynë për të shmangur këto probleme:

- Naval Air Systems Command (NAVAIR) është duke testuar një program pilot. (WWAN) për të rritur komunikimet ekzistuese të bazuar në satelit. Rrjeti LTE (përdor 4G) lejon që personeli mbi dy anije të marrë në kohë reale video -streaming nga nyjet ajrore montuar mbi helikopter.
- Problemet: Kosto, Sigurimi, 4G(LTE(Long Term Evolution))

1.3.2 Komunikimi navigacional anije me anije shkon drejt 4G

Anijet kanë pasur metodat e komunikimit intrafleet[11] që kur doli ideja që mjetet të luftojnë si një forcë e bashkuar. Herët mesazhet përcilleshin me anë të një sistemi të

[11] Ndër-flot_ore

sinjaleve me flamuj, pastaj me ndezje dritash. Me shfaqjen e radios, e komunikimit wireless ishte më e thjeshtë.



Figura 1.12. Komunikim Anije me Anije

Me kalimin e kohës, sasia e informacionit që mund të transmetohej(bandwidth) u rrit, por ajo mbeti prapa apo mbulonte më tepër rrjetet tregtare. Si telefonat celulare ashtu edhe pajisje të tjera mobile u bënë të famshme, rrjete te reja tregtare u shfaqen, dhe këtyre rrjeteve iu vendos në dispozicion Bandwidth i gjerë që tejkalonte edhe atë që shumica e ushtrisë kishte në dispozicion.

Për marinën e U.S, kjo ka qenë një pengesë e jashtëzakonshme për tu kapërcyer. Dhe nuk ka të bëjë vetëm me Bandwidth; ekzistojnë shqetësimet e sigurisë që çdo degë e ushtrisë ka kur përdor një rrjet celular publikisht të aksesueshëm. Marina gjithashtu përballet dhe me pengesa shtesë të jo çuditërisht pak antena të operatorëve celularë në ujërat ku luftanije të mëdha ndodhen në manovra. Kur nuk ka asgjë mbi sipërfaqen e ujit, por vetë anijet duhet të jenë kthyer në pikat e nevojshme rele. (Greg Crowe, GCN Magazine, 11 mars 2013).

Kjo është pikërisht ajo që Naval Air Systems Command (e NAVAIR) është duke bërë. Komanda ka testuar një program pilot në të cilën dy anije, USS Kearsarge dhe USS San Antonio, janë të pajisur me një rrjet me zonë të gjerë mikrovalë wireless (WWAN) për t'ia shtuar komunikimeve ekzistuese satelitore. Rrjeti LTE i i lejon personelit që ndodhet në dy anije të marrë në kohë reale video streaming nga nyjet ajrit montuar në

helikopterët, e cila nga ana e vet i lejon oficerët që të marrin vendime më shpejt dhe më të sakta bazuar në atë që paraprakisht njësitë janë bërë. (Greg Crowe, GCN Magazine, 11 mars 2013).

Larry Hollingsworth NAVAIR drejtor kombëtar për aviacionin R & D tha: "LTE i lejon NAVY të drejtoj të gjitha avantazhet e telefonat smart dhe broadband komerciale". "NAVAIR po përpiqet të trajtojë një kërkesë kritike për misionin VBSS [Vizita, bordi, kërkimi dhe konfiskimi], por përveç kësaj marinarët tashmë kanë gjetur rrjetin e tyre të dobishme në punën e tyre të përditshme. Kjo ka kuptim të përbashkët, pasi edhe pse ne të gjithë e përdorim teknologjinë e telefonit smart në jetën tonë personale, nuk është befasuese se marinarët do ta shtrinë atë gjë të dobishme për punën e tyre.

LTE, zakonisht emërohet si 4G LTE, është një standard për komunikimet me shpejtësi të lartë midis pajisjeve të lëvizshme, dhe i transmeton të dhënat në rreth 100 megabits / sek, me shpejtësinë e duhur për të trajtuar imazhet dhe videot si dhe zërin dhe tekstin. Në vitin 2012, policia në Florida testuar një rrjet i dedikuar LTE për të trajtuar sigurinë gjatë Konventës Kombëtare Republikane. Ekipet që u përgjigjen emergjencave në zonën e Denverit gjithashtu janë duke përdorur LTE për një rrjet të sigurisë publike.

Por çfarë është LTE dhe pse është i rëndësishëm për një rrjet të sigurt publik: Gjatë ngjarjeve të mëdha ne kemi vështirësi në përdorimin e telefonave tanë celularë për shkak të mbingarkesës në rrjet ", tha Moushon. Sepse rrjeti demo RNC nuk ka përdorur një bartës komercial dhe ishte dedikuar për policinë kur nuk kishte mbipopullim, duke i bërë shërbimet të avancuara që të vihen në dispozicion për komunikimet në misione-kritike. "Kjo ishte absolutisht e madhe për ne," tha ai. Sistemi 4G LTE(Long Term Evolution) vepron në Band 14 të rrjetit të sigurisë publike në rangun 700 MHz e broadband. Kjo është pjesë e një përpjekje për të siguruar responder-a e parë të rajonit me një teknologji që do të lejojë që ata të ndajnë komunikimin përtej kufijve juridiksionale, tha Frank Brzezinski, manaxher i zhvillimit të biznesit menaxher i divizionit i Sistemeve të Integruara të Raytheon, i cili instalon sistemin. (Nga William Jackson, Sep 17, 2012).

1.3.3 Komunikimet Littoral_e[12] Breg-Anije me mangësi, sipas GAO.

- GAO(Government Accountability Office) në kërkimet e saj së fundmi zbuloi se në sistemet e komunikimit mungon besueshmëria e nevojshme, shpejtësia dhe bandwidth_i.
- Ndërtimi i një infrasrukture për këto lloje komunikimesh rezulton shumë i shtrenjtë.

Anijeve Luftarake të Marinës të SHBA-së u mungojnë sistemet e fuqishme të komunikimit të nevojshme për të transmetuar të dhënat kritike për të mbështetur objektet në breg, sipas një auditimi të palëshuar të kongresit, i fundit në një varg të problemeve për programin e ndërtimit të anijeve është 34 milionë $.

Zyra e Llogaridhënies e Qeverisë Amerikane, në një përmbledhje të LCS, tha: Anijet e Lehta(me tonazh të lehtë) mbështeten në komunikimet anije-me-breg për të ndihmuar ekipet që monitorojnë gjendjen e anijes, kryejnë riparime dhe urdhërojnë furnizime mjekësore. Auditimi zbuloi se në sistemet e komunikimit mungon besueshmëria e nevojshme, shpejtësia dhe bandwidth.

Mangësitë e komunikimit i shtohen kritikave të mjetit/anijes, i cili ka për qëllim të jetë i vogël, i shpejtë, dhe i adaptueshëm për të patrulluar ujërat e cekëta pranë bregut në hapësira të tilla si të Gjirit Persik dhe Detit të Kinës Jugore.

Programi për të ndërtuar një total prej 52 anijesh në dy versione të bërë nga Lockheed Martin Corp dhe Austal Ltd është ballafaquar me një listë të zgjeruar të pyetjeve në lidhje me pozitat e tyre, armatimet/fuqi zjarri, mbrojtjen dhe mbijetesën edhe pse kostot e projektuara këtij ndërtimi e kanë kaluar parashikimin dhe Pentagoni përballet me shkurtime automatike buxhetore prej rreth 500 miliardë $, më shumë se gjatë një dekadë..

"Derisa sistemet e komunikimit dhe shqetësimet e Bandwidth janë adresuar plotësisht," aftësia e flotën "për të ndarë informacion me pajisjet mbështetëse në breg mund të jetë e kufizuar dhe mund të zvogëlojë disponueshmërinë operative të anijes," sipas raportit, të datës 9 Shtator të emërtuar "Për përdorimin zyrtar vetëm ", që është marrë nga Bloomberg News.

[12] Bregdetare

Auditimi GAO u bazua në vlerësimin e çështjeve të ngritura në katër raportime të brendshëm të Navy vitin e kaluar.

Përgjigja e NAVY[13]

Caroline Hutcheson Togere, një zëdhënëse e Navy, tha se "shumë përpjekje është bërë për të vlerësuar se si të përmirësohet Anija Luftarake Littorale", dhe "rekomandimet e GAO kanë qenë pjesë e diskutimeve të hollësishme se si Navy e vlerëson programin".

"Këshilli LCS i marinës, i formuar vitin e kaluar për të shqyrtuar programin" i është adresuar sistemeve të komunikimit të anijeve," tha Hutcheson në një e-mail. Ndërsa anijet kanë kapërcyer të metat e hershme, të tilla si çarjet dhe korrozionin, sipas GAO, ata përballen me pyetje të vazhdueshme, duke përfshirë aftësinë e tyre për të mbijetuar ndaj një goditje nga raketat kundër-anije.

Madje në rolin e tij të luftës të sipërfaqes, kur të gjitha sistemet e saj të armëve janë duke punuar si duhet, anija "është vetëm në gjendje të neutralizojë" anije të vogla të sulmit, si ato që Irani ka, dhe ajo "mbetet e pambrojtur ndaj anijeve" me raketa kundër-anije lundrimi që mund të udhëtojnë më shumë se pesë milje (8 kilometra), sipas një raporti të marsit të vitit 2012 të marinës.

Shkëmbimi i moduleve

Zyrtarët e marinës po ashtu kanë vënë në diskutim nevojën praktike të anijes 'për t'u kthyer në port për të shkëmbyer module të përshtatura për detyra të tilla si sipërfaqe luftarake, operacionet dhe misionet kundër - nëndetëse.

Dështim "katastrofikë"

Marina nuk e ka trajtuar plotësisht "pamjaftueshmërinë për të trajtuar të dhënat e rrjedhshme të vazhdueshme të nevojshme LCS" të një sistemit të madhë dhe nuk është "duke hetuar ose investuar në Bandwidth e sistemit të komunikimit dhe në tepricën e të dhënave që do të zbuste dështimin e sistemit," theksoi GAO.

[13] Marina

Zyrtarët e marinës njohën rëndësinë e komunikimit të besueshëm anije-me-breg në përgjigjen e tyre ndaj GAO, duke thënë se monitorimi efektiv i të dhënave të mirëmbajtjes së anijes "parandaloi një dështim katastrofik të sistemit" që i "lejoi marinës të marrë veprime lehtësuese dhe të shmang shpenzimet e mëdha." (Tony Capaccio , November 19, 2013)

1.3.4 Komunikimet Littoral_e[14] Breg-Anije me mangësi, të dhëna nga portet e Vlorës.

Sipas një inerviste që patëm me komandatin dhe teknikë të bazës së Policisë Detare, Vlorë por edhe me personat kompetentë që takuam në Portin e Vjetër, Vlorë u vërejt qartë nevoja e ekzistencës së komunikimeve të sigurta.
Madje nga një anlizë aktuale mbi komunikimin rezultonte që të gjitha skafet policore detare si dhe anijet e peshkimi dhe anije të tjera pasi kalonin Karabrunin(mbas tij) kishin probleme me komunikimin, me antenat dhe radiot, madje na u deklarua se kishin shkëputje në komunikimin me bregun, pra nuk kishin më mbulim(s'ka valë), për të siguruar një komunikim normal, më poshtë janë dhënë koordinatat ku ndodhin këto shkëputje me bregun:

- Kanal Jug.Karaburun 40 27 76 N 87 19 17. E
- Kanal Veri.Karaburun 40,31 54 N 19 15 99 E

Por jo vetëm në këtë zonë, por edhe në dis azona të tjera si p.sh. në zonën midis Qeparoit(në fund të tij) dhe Borshit raportohen shpesh nga drejtuesit e mejteve raste të tilla për mungesë komunikimi apo mbulimi vale për të patur një komunikim normal mjet me breg.

Përsa i përket zonës së Vlorës në bazë të materialeve të mbledhura nga Porti i Vjetër dhe Porti i Policisë Detare mund të listojmë disa nga pajisjet që përdoren në skafet dhe anijet që navigojnë në ujrat e këtyre porteve por edhe nëpër anijet që navigojnë gjithë bregdetin tonë, të tilla janë: Radari- Furuno Universla AIS(Fa-150), NavNet 3D; Salor-radiolidhëse; Radio-Sepura; Navionics (Humminbird); Furuno FI-50. Le të trajtojmë shkurt secilën prej tyre, për tu njohur më mirë me komunikimin breg- anije; anije –anije:

[14] Bregdetare

Figura 1.13. Furuno Universal AIS(Fa-150)

FA-150 është një AIS universal (Automatic Sistemit të Identifikimit) për det të hapur dhe për rrugët ujore të njësive të brendshme/mbyllura, të aftë për të shkëmbyer të dhëna navigimi dhe të anijes ndërmjet anijeve të tjera apo stacioneve bregdetare. Është në pajtueshmëri me IMO MSC.74 (69) Aneksi 3, A.694, ITU-RM.1371-4 dhe DSC ITU-R M.825. Ajo gjithashtu është në përputhje me IEC 61993-2 (testimit Typestandard), IEC 60945 (EMC dhe kushtet mjedisore*)(informacione të marra nga manuale që dispononte Baza e Policisë Detare, Vlorë).*



Figura 1.14. Sistemi i konfigurimit(marrë nga Baza e Policisë

Në Figurën 1.14 po paraqesim në mënyrë skematike **<u>Sistemin e Konfigurimit:</u>**

Sistemi i identifikimit Automatik (AIS) është zhvilluar fillimisht për të ndihmuar Vessel Traffic Services [15] (VTS) duke përdorur një transponder VHF që punon në Call Digital Selektiv (DSC) në VHF CH70, dhe është ende në përdorim përgjatë zonave bregdetare në UK dhe zona të tjera bregdetare. Disa

[15] Shërbimet e Trafikut të Anijes

kohë më vonë IMO zhvilloi një AIS universale duke përdorur teknologji të re të sofistikuar të quajtur Self-Organized Koha Division Multiple Access (SOTDMA) në bazë të të dhënave VHF Link (VDL).

Sistemi funksionon në tre mënyra – autonom (funksionimin e vazhdueshëm në të gjitha fushat), - në intervale të caktuara (transmetimin e të dhënave të kontrolluara nga distanca nga autoritet në shërbimin e monitorimit të trafikut) - dhe anketime (në përgjigje të pyetjeve nga një anije ose autoritet). Ajo është e sinkronizuar me kohën e GPS për të shmangur konfliktin ndërmjet përdoruesve të shumtë (IMO minimale 2000 Raporte për minutë dhe IEC kërkon 4500 raporte për dy kanale). Kanalet VHF 87B dhe 88B janë përdorur shpesh dhe përveç kësaj ka frekuenca lokal. Transponder_at AIS të anijes shkëmbejnë të dhëna të ndryshme siç përcaktohet nga IMO dhe ITU në ose frekuenca të krijuara automatikisht nga telekomandimi i menaxhimit të frekuencave pranuar nga marrësi DSC në anije.



Figura 1.15 Sistemi AIS

Siç përmendëm më lartë pajisje të tjera të rëndësishme janë edhe NavNet 3D; Salor-radiolidhëse, në figurën1.16 paraqitet pamje nga porti i Policisë Detare, pamje të sistemit të drejtimit, të kabinës së mjeteve (skafeve) të policisë detare, si dhe pamje nga Navnet 3D, Furuno.

Furuno ofron një linjë të plotë të pajisjeve të komunikimit për të na mbajtur të lidhur me të tjerët, duke përfshirë AIS, Radiotelefonë një apo shumë stacionesh, marrës NAVTEX, faksimile të motit dhe stacione tokësore mobile Inmarsat. Gama e gjerë e pajisjeve të komunikimit u ofron dejtuesve të mjeteve të vogla të njëjtën cilësi dhe besueshmëri të zgjedhur nga komuniteti tregtar detar.

Figura 1.16. Porti i Policisë Detare pamje të sistemit të drejtimit, të kabinës së mjeteve (skafeve) të policisë detare.

Navnet 3D është një sistem novator navigacioni, që paraqet koncepte të reja për ndërfaqen e përdoruesit që e bën lundrimin në anijet tuaj më të lehtë se kurrë më parë.

Por çfarë protokoll komunikimi përdorin pjisjet e komunikimit të ndërfutura në anije, siç është AIS?

CAN bus është një protocoll komunikimi që ndan të dhënat e shumta dhe sinjale nëpërmjet një kabllo të vetme si shtylla kurrizore.

Ne thjesht mund të lidhim ndonjë pajisje CAN bus në pjesën kryesore të kabllit për të zgjeruar rrjetin tuaj në bord. Me CAN bus, ID janë caktuar në të gjitha pajisjet, dhe statusi i çdo sensori në rrjet mund të detektohet. Të gjitha pajisjet e CAN të mund të përfshihen në rrjetin NMEA 2000.

Të gjitha sensorë e radarit Navnet 3D inkorporojnë një port CAN bus tek e cila disa sensorë CAN bus mund të lidhen direkt. Fuqia për këto sensorë të rrjetit furnizohet direkt nga vetë radari. Ky tipar unik lejon instalim fleksibël të sensorë të shumfishtë, pa nevojën për të drejtuar kabllot gjatë gjithë rrugës për njësinë kryesore procesor. Të dhënat e CAN bus

konvertohen dhe shpërndahen kudo në rrjetin Navnet 3D Ethernet. Ku, Navnet 3D është e ndërtuar mbi një rrjet Ethernet, duke lejuar që të shtohen komponentë pak ose shumë sa një person mund të dëshirojë së bashku me deri në dhjetë ekrane për të krijuar një suitë të përsosur lundrimi.

Për më tepër, këto pajisje si NMEA 0183 dhe CAN bus mund të lidhen tek çdo ekran apo procesor BB dhe mund të ndajnë/përcjellin informacionin automatikisht në të gjithë rrjetin Ethernet. Të dhënat e vendosura nga përdoruesi gjithashtu mund të transferohen duke përdorur kartat SD për sinkronizimin e parametrave të operimit përmes shfaqjeve të rrjetit. Sinkronizimi i fuqisë on / off përmes të gjitha njësive të ekranit Navnet 3D mund të arrihet kur përdoret një hub i dedikuar HUB101 Ethernet. Sistemi Navnet 3D është ndërtuar mbi teknologjinë më të përparuar chart plotter[16].

Po të shtohet Radar UHD ™ dhe Fish Finder[17] FDF ™, së bashku me zgjedhjen nga një shumëllojshmëri e gjerë opsionesh sensorësh dhe deri në dhjetë ekrane. Përveç kësaj, NAVpilot i Furuno gjithashtu mund të jetë i lidhur me sistemin. Është e lehtë për të parë se si ekrani chart plotter bëhet Gjeneza e suitës më të sofistikuar të lundrimit në dispozicion.

Konfigurimi bazë i Navnet 3D na lejon të zgjedhim ose MFD12, 12.1 "Multi Function Display ose MFD8, 8" Multi Function Display. Mbi të gjitha, Navnet 3D ofron konfigurimin Blackbox me të cilat ju mund të përdorni Furuno e MU-seri 12.1/15/17 "LCD me ngjyra ose një monitor porosi deri në zgjidhjen e ekranit SXGA. Të gjitha kombinimet deri në 10 MFDs janë të mundshme në një rrjet Navnet 3D.

Numri maksimal i Sensore Radar Digital (DRS) në një rrjet maksimumi është deri në katër DRS dhe secili prej MFD8/MFD12/MFDBB ka një Hard Disk Drive (HDD) të brendshëm me 40 gigabajt të kapacitetit të hapsirës së kujtesës.

[16] Një chartplotter është një pajisje e përdorur në navigacion detar e cila integron të dhënat e GPS me një tabelë elektronike lundrimit (ENC).

[17] Një Fishfinder ose jehone është një instrument i përdorur për të gjetur peshk nënujë duke detektuar impulse të pasqyruara të energjisë së tingullit, si në sonar. A Fishfinder moderne paraqet matjet e tingullit të pasqyruara në një ekran grafik, duke lejuar një operator për të interpretuar informacionin për të gjetur grumbujt e peshkut, mbeturinat nënujore, etj...

MFD pranon një mouse USB që është mbështetur nga Generic USB Driver. Shumica e veprimeve janë të mundshme duke përdorur një mouse USB. Por a mundet që të dhënat e makinës të shfaqen në NMEA2000 dhe çfarë është një NMEA 2000? Po mund të pranohen nga NMEA 2000 i cili është një protokoll rutimi i NMEA që lehtëson komunikimin me shpejtësi të madhe të vëllimit të madh të të dhënave gjithashtu edhe shpërndarjen me lehtësi të rrjeteve të sistemit të navigimit.

Përveç 2 protokolleve të përmendura më sipër, që ndihmonin në komunikimin navigacional, në çështjen më poshtë do të trajtojmë edhe disa protokolle të tjera, të cilat mund të kenë të bëjnë me rutimin, efiçencën e energjisë, lokalizime, etj...

1.4 Një Vështrim i Përgjithshëm i Protokolleve në Komunikimet Inter-Navale. Konkluzione

1.4.1 Një Taksonomi Mbi Protokollet Ndërnavale

Pjesa më e madhe e protokolleve IVC(komunikimi ndërmjetor) përdorin përmbytjen (flooding) si rrugën më të thjeshtë për transmetimin(broadcast). Por flooding performon relativisht mirë për një numër të kufizuar të nyjeve, kjo performancë bie ndjeshëm nëse numri i nyjeve rritet. Kur secila nyje merr dhe transmeton mesazhin pothuajse në të njëjtën kohë, kjo shkakton konflikt dhe përplasje, stuhi transmetimi dhe konsumim të lartë të bandwidth_it.

Nëse do të bënim një ndarje apo klasifikim të këtyre protokolleve të cilat ndihmojnë komunikimet mjet me mjet, në rastin konkret anije me anije, do të listonim si më poshtë:

- Protokolle Ad hoc (të rutimit)
- Protokollet gjeografike të internetit
- Protokolle rutimi që kanë të bëjnë me efiçiencën e energjisë.
- Protokolle rutimi që kanë të bëjnë me lokalizime, etj...

Ashtu siç mund të kemi theksuar dhe evidentuar më sipër, komunikimi anije me anije (Ship-to-ship) kontribuon në krijimin e një rrjeti ad-hoc wireless. Protokollet Ad-hoc janë shumë të përshtatshme për t'u përdorur në port, pikërisht në fushën e komunikimit ndër-detare.

Prandaj dhe në këtë temë jemi fokusuar dhe kemi patur për qëllim pikërisht ndërtimin e një protokolli rutimi të përshtatshëm në komunikimet anije me anije, dhe me anë të cilit të rritet siguria e njerëzve dhe mjetit të lundrimit. Por për këtë protokoll rutimi do të flasim, do e shpjegojmë dhe do e trajtojmë më gjerë në kapitujt më poshtë.

Në këtë pikë do të ndalemi tek trajtimi i disa prej protokolleve të cilat bëjnë pjesë në taksonominë e paraqitur më poshtë, dhe që janë pikërisht ato protokolle që ndihmojnë në komikimet ndërnavale.

- **Protokolle të tjera që ndihmojnë komunikimet Navale:**



Figura 1.17. Taksonomi e protokolleve të komunikmeve ndërnavale

- **Protokolle që lidhen me efiçiencën e energjisë**

Siç mund të shihet edhe nga taksonomia e më sipërme kemi disa protokolle të cilat ndihmojnë në eficiencën e energjisë, le të trajtojmë disa prej tyre:

MMBCR(Min-Max Battery Cost Routing): Idea është që të kuptojmë se çfarë performance dhe funksionimi ka protokolli i rutimit i efikasitetit të Energjisë për rrjetin

mobile ad hoc. Analiza e këtij protokolli është bërë duke marrë një rrjet si shembulli në figurën më poshtë:



Figura 1.18. Një snapshot/fotografi që tregon rrugën 0-4-5-6 që është zgjedhur nga MBCR(marr nga faqe web)

Protokollet e eficiencës së Energjisë marrin parasysh energjitë e mbetura të nyjeve ndërkohë edhe përzgjedhjen e rrugës për në destinacion. Min-Max Battery Kosto Routing (MMBCR) së pari e gjen nyjen që ka kapacitet minimal të baterisë në secilën prej rrugëve të mundshme dhe përzgjedh rrugën që ka vlera maksimale midis rrugëve të zgjedhura. Kjo do të thotë se është zgjedhur rruga që ka jetëgjatësinë maksimale. Por e metë kryesore e MMBCR është se ajo nuk i konsideron fuqitë e e transmetimit të nyjeve. Në MMBCR, informacioni i përditësuar nuk konsiderohet për zgjedhjen e rrugës. Një problem tjetër në protokollin ekzistues MMBCR është se sapo rruga është zgjedhur në fazën e zbulimit të rrugëzimit, rruga e zgjedhur është përdorur deri sa të gjitha paketat e të dhënave dërgohen ose deri sa rruga e zgjedhur dështon për shkak të shkarkimit të baterisë së nyjes. Nëse ndonjë nga nyjet në rrugën e zgjedhur nuk ka energji të mjaftueshme, ato nyje me siguri do të vdesin duke shkaktuar dështimin e rrugëzimit dhe kështu jetëgjatësinë e përgjithshme të rrjetit. Këtu, nyjet në rrugën e zgjedhur pësojnë shumë në mënyrë të vazhdueshme për shkak të paketave që vijnë nga nyjet e tjera.

Sigurisht që për të rregulluar këto probleme janë propozuar mekanizma zbulimi te cilët rregullojnë disi proçesin e rrugëzimit. Por mendohet se ka akoma shumë për tu bërë në këtë drejtim, shanset e dështimit të link_eve janë të shumta.

MTPR(Minimum Total Transmission Power Routing): Protokolli MTPR është përdorur për të minimizuar konsumin e energjisë totale të transmetimit për komunikim multi-hop. Që fuqia e transmetimit është proporcionale me distancën e transmetimit midis dy nyjeve fqinje, pra MTPR protokoll gjithmonë zgjedh një rrugë me fuqi më minimale të transmetimit, por me më shumë Hop_e. Megjithatë, protokolli MTPR pëson gjatë vonesës end-to-end, pikërisht nga numri më i madh i Hop_ve.

Kufizimet:

- Vështirësia, në lidhje, me baterinë e mbetur të një nyje
- Numri i madh i nyjeve të 'Vdekura'
- Vonesa të mëdha end-to-end

LEAR (Local Energy Aware Routing)protocol): Është një protokoll i bazuar në mekanizmin DSR të rutimit. Ideja kryesore e LEAR është të marri në konsideratë për komunikim vetëm ato nyje të cilat janë të gatshme të marrin pjesë në path_in e rrugëzimit. Kur nyjet e ndërmjetme do të kenë nivele të mirë të baterisë atëherë vetëm destinacioni do të marri mesazhin kërkesë rrugëtim. Pra, mesazhi i parë që arrin në destinacion konsiderohet që do të ndjekë një të energji efikas, si dhe rrugën më të shkurtër të mundshme. Ky protokoll ndihmon për të vlerësuar konsumin e energjisë dhe ekuilibrin në të gjitha nyjet mobile, rezultatet e mara nga simulimit tregojnë se ajo ka arritur konsumin e ekuilibruar të energjisë në të gjitha nyjet me sukses e cila është 35% më shumë se ajo e DSR(Baisakh, April 2013).

Por duhet theksuar se nuk mungojnë situata të tilla kur një nyje e vetme e ndërmjetme e një rruge totale e ka nivelin e energjisë së baterisë më të ulët se vlera e tij e pragut(threshold) (Er <Thr), pra kërkesa për rrugëzim thjesht ndërpritet. Duhet ribërë përsëri kërkesa që rrugëtimi i kësaj nyje të vazhdojë, pra burimi duhet të ridërgojë të njëjtën rrugë por me një numër sekuencial të rritur. Pra ky protokoll mund të përmirësoj dhe të ketë më shumë suksesë se protokolli DSR por nuk e zgjidh përfundimisht problemin që lind gjithmonë në konsumin e energjisë së baterisë të nyjes.

- **Protokolle gjeografike të Internetit**

Për disa prej këtyre protokolleve do të flasim gjatë në çështjet e kapitujve në vijim, si për shembull për protokollin AODV, DSDV, FSR, DSR, ABR,etj.. Ndërkohë më poshtë po trajtojmë protokollin NPV:

NPV(Neighbor Position Verification Protocol): Në rrjetet ad hoc mobile, ku një infrastrukturë fixe nuk është e pranishme analizojmë protokolle reaktive të tilla si verifikimi i pozicionit të fqinjit (NPV). Aftësia që të dish vendndodhjen është duke u bërë një aftësi e rëndësishme për pajisje informatike mobile, ku shumë protokolle kanë nevojë për njohuri të pozitës apo pozicionit të nyjeve pjesëmarrëse. Për shembull, njohuritë në lidhje me nyjet fqinje mund të përdoren për rrugëzimin, cluster_im dhe transmetimin në mënyrë efikase. Sa herë që një nyje ka nevojë të dërgojë të dhëna në një tjetër nyje në një rrjet, ajo duhet së pari të di se ku ta dërgojë atë. Nëse nyja nuk mund të lidhet direkt me nyjen e destinacionit, ajo duhet ta dërgojë atë nëpërmjet nyjeve të tjera përgjatë një rruge të duhur deri te nyja destinacion. Në raste të tilla është e domosdoshme që të sigurojë disponueshmërinë e informacionit të fqinjit. Procedura e përshkruar të NPV që mundëson secila nyje për të arritur lokacionet e shpallura nga fqinjët e saj, dhe të vlerësojë vërtetësinë/besueshmërinë e tyre. Por pengesa kryesore është përdorur për të verifikuar pozicionin e fqinjëve që nyjet deklarojnë.

Protokolli NPV është përdorur për shkëmbimin e mesazheve dhe verifikon pozicionin e komunikimit të nyjave. Në këtë protokoll shkëmbehen katër grupe të mesazheve. Ato janë:

- POLL(VOTO) mesazh: Një verifikues S inicion këtë mesazh(VOTO). Ky mesazh është anonim. Identiteti i verifikuar mbahet i fshehur.
- REPLAY(PËRGJIGJE) mesazh: Një fqinj i komunikimit X duke marrë mesazhin e sondazhit do të transmetojë mesazhin PËRGJIGJE pas një intervali kohor.

- REVEAL (ZBULO) mesazh: Mesazhi ZBULO i transmetimit është bërë duke përdorur adresën e vërtetë të verifikuesit MAC. Ajo përmban një dëshmi se S është autori i POLL_it origjinal dhe verifikues i identitetit.
- REPORT(RAPORTI)mesazh: RAPORTI mban pozicionin e X-it, kohën e transmetimit të PËRGJIGJES së X-it, si dhe listën e çifteve të kohëve të pritjes dhe identifikuesit e përkohshëm referuar transmetimeve PËRGJIGJE të marra të X.

Nga hulumtimet e bëra mbi protokollin NPV theksohet se verifikimi i pozicionit fqinj studiohet në kontekstin e rrjeteve ad hoc dhe sensor; Megjithatë, skemat ekzistuese të NPV shpesh mbështeten në nyje të besueshme fixe ose të lëvizshme, të cilat supozohet të jenë gjithmonë në dispozicion për verifikimin e pozicioneve/pozitave të shpallura nga palët e treta. Në mjediset ad hoc, megjithatë, prania depërtuese e secilës infrastrukturë apo nyjeje fqinje që mund ti besohet apriori është mjaft jorealiste.

- **Protokolle që lidhen me sigurinë dhe menaxhimin**

Standardi IEEE 802.10 ofron specifikimet për një protokoll të sigurisë të shtresës së ndërvepruese të të dhënave dhe shërbimet e ndërlidhura me sigurinë. Protokolli i shkëmbimit të sigurt të të dhënave (SDE-Security Data Exchange) është i mbështetur nga një protokoll i menaxhimit kryesor/kyç të shtresës së aplikimit (KMP) që përcakton asociacione të sigurisë për SDE dhe protokollet e tjera të sigurisë. Një opsion i etiketuar i sigurisë është i specifikuar që të mundësojë kontrollin e aksesit bazuar në rregulla që do të zbatohen duke përdorur protokollin SDE. Pra IEEE 802.10 është një standard i vjetër/mëparshëm për funksionet e sigurisë që mund të përdoren në të dy rrjetet LAN dhe MAN të bazuara në protokollet IEEE 802. 802.10 përcakton menaxhimin e sigurisë dhe menaxhimit kryesor, si dhe kontrollin e aksesit, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave.

IEEE 802,11 është një grup i MAC(media access control) dhe i specifikimeve të shtresës fizike (PHY) për implementimin e komunikimit kompjuterik të rrjetit lokal wireless (WLAN) në 900 MHz dhe 2.4, 3.6, 5, dhe me banda të frekuencave 60GHz. Ato janë krijuar

dhe mirëmbahen nga Instituti i Inxhinierëve Elektronikë dhe Elektrike (IEEE), Komiteti i Standardeve (IEEE 802) LAN / MAN .

IEEE 802,11 është aktualisht standarti më i përdorur gjerësisht i rrjetit lokal wireless në botë. Për shkak të përdorimit të saj të gjerë, çmimi i kësaj pajisje me performancë relativisht të lartë është shumë i ulët, duke e bërë atë hardware_in më të zgjedhur për testbeds IVC. 802,11 Shtresa e MAC zbatohet praktikisht në të gjithë simulatorët e rrjetit, duke bërë vlerësimin e performancës së sistemeve të IVC bazuar në 802.11 hardware relativisht të lehtë.

Ka disa specifikime standartesh në familjen 802,11: 802.11a; 802.11b; 802.11e; 802.11g ; 802.11n ; 802.11ac Wave 2**;** 802.11ad **;** 802.11ah**;** 802.11r; 802.1X. Secili prej standarteve është një specifik i tipit wireless që operon në banda të ndryshme, të përcaktuara frekuencash.

P.sh 802.11e; është një draft standard wireless që përcakton mbështetjen e cilësisë së shërbimit (QoS) për LAN, dhe është një përmirësim/shtim për specifikimet wireless LAN (WLAN) të 802.11a dhe 802.11b. 802.11e shton karakteristikat e QoS dhe mbështetjen multimediale për standardet wireless ekzistues IEEE 802.11a dhe IEEE 802.11b, duke ruajtur pajtueshmërinë e plotë me këto standarde.

- **Protokolle që lidhen me kontrollin e trafikut**

HRMA(Hop Reservation Multiple Access)- Një protokoll MAC shumëkanalësh i ri për rrejtat packet-radio i bazuar në spektër përhapje i kapërcim - frekuencave shumë të ngadalta. HRMA e lejon një çift të nyjeve komunikuese të rezervoj një kanal duke përdorur një rezervim - hop dhe mekanizëm shtrëngues në çdo hop për të garantuar transmetimin e të dhënave pa-përplasje në prani të terminaleve të fshehura. HRMA siguron një bazament për të ofruar QoS në rrjetet ad-hoc bazuar në radio e thjeshtë të ngadaltë gjysmë-duplex FHSS. Pra siç mund të vërehet protokolli HRMA në ndryshim nga protokolli MAC arrin të realizojë nëpërmjet mekanizmit të përdorur(siç tekoshet më lartë) transmetimin e të dhënave pa përplasje, por deri në çfarë mase mund ta arijë këtë? Dhe gjithmonë problem ngelet bandwidth i përdorur dhe fuqia e baterisë në nyjet, operacioni i shpërndarjes dhe sinkronizimit, etj..

1.4.2 Konkluzione

Pavarësisht nga metodat, sistemet dhe shërbimet e Navigimit të përdorura nga Marina deri më sot probleme të rëndësishme shfaqen në komunikimet ndër- navale të emergjencës. Këto probleme nuk shfaqen vetëm tek nevoja për bandwidth por edhe tek siguria në shërbime dhe sistemet e përdorura, tek shkëputjet në komunikimet anije me breg dhe anije me anije. Këto problem i shohim të shfaqen qoftë tek sistemet Satelitore ashtu edhe tek rrjetat celulare. Por jo vetëm, edhe tek protokollet që ne përmendëm më lartë u vu re se ka nevojë për përmirësim dhe rregullim të transmetimit të paketave të të dhënave nga nyja në nyjë, rritje të informacionit të sigurtë për nyjen fqinje, minimizimin e konsumit të energjisë totale të transmetimit për komunikime multi-hop, zgjedhjen e një rrugë me fuqi më minimale të transmetimit, por jo me shumë Hop_e, dhe rrjedhimisht të gjitha këto ndikojnë në komunikimin mjet me mjet.

GAO(Government Accountability Office) në kërkimet e saj së fundmi zbuloi se në sistemet e komunikimit mungon besueshmëria e nevojshme, shpejtësia dhe bandwidth_i. Dhe ndërtimi i një infrasrukture për këto lloje komunikimesh rezulton shumë i shtrenjtë. Sipas saj Marina nuk e ka trajtuar plotësisht pamjaftueshmërinë për të trajtuar të dhënat e rrjedhshme të vazhdueshme të nevojshme LCS të një sistemit të madh.

Edhe në trajtimin që iu bë protokolleve të rutimit të përdorura në komunikimet ndërmjetor/internavale u vërejt që këto protokolle përdornin përmbytjen (flooding) i cili performon relativisht mirë për një numër të kufizuar të nyjeve, por kjo performancë bie ndjeshëm nëse numri i nyjeve rritet. Kur secila nyje merr dhe transmeton mesazhin pothuajse në të njëjtën kohë, kjo shkakton konflikt dhe përplasje, probleme në transmetim dhe konsumim të lartë të bandwidth_it.

Prandaj, një algoritëm i mirë rutimi mund të shmang bllokimin e trafikut mbi të gjitha linjat. Dhe sfida e të gjitha protokolleve adreson në drejtim të shkallëzimit (scalability) dhe efektivitetit, dhe ky është edhe synimi ynë në këtë punim kërkimor shkencor. Synim ky që do të mundohemi ta përmbushim duke përdorur një protokoll të ri rutimi, ***protokollin tonë InterNavComm.***

KAPITULLI II: AD-HOC KOMUNIKIMI I SIGURT

2.1 Hyrje. Një vështrim i përgjithshëm mbi dy tipet e rrjeteve ad-hoc wireless, MANETs dhe VANETs.

Nëse i referohemi objektit të studimit që u theksua në hyrje, në komunikimin anije me anije komunikimi i lëvizshëm ad-hoc është i përshtatshëm pasi ai ofron pathet e komunikimit alternative për infrastrukturat e komunikimit pa nevojën e mbulimit nga stacionet bazë. Protokolle të ndryshme rutimi janë zhvilluar për rrjetet ad-hoc wireless.

Ashtu siç e dimë tashmë, rrjetat ad-hoc janë rrjeta spontane, të krijuara nga nyje spontane në mjedise me ose pa mbulim të rrjetit të zakonshëm celular. Këtij përkufizimi i përshtaten dhe grupimet e anijeve në porte ose pranë tyre. Për këtë arsye në këtë punim komunikimi ndërmjet anijeve do të modelohet si një komunikim ndërmjet nyjeve të rrjetit ad-hoc, si një komunikim i shpejtë, efiçent dhe i sigurtë.

Rrjeti ad hoc wireless:

- ✓ është rrjeti pa stacione bazë "pa-Infrastrukturë "ose multi-hop
- ✓ një koleksion i dy ose më shumë pajisjeve të pajisur me komunikim pa-tel dhe aftësinë e rrjeteve
- ✓ mbështet në çdo kohë dhe kudo informatikën
- ✓ dy topologji:
  - heterogjene (majtas)
    - dallimet në aftësitë
  - homogjene ose plotësisht simetrike (Djathtas)
    - të gjitha nyjet i kanë njëjta aftësitë dhe përgjegjësitë



Figura 2.1 Infrastruktura e rrjetit ad hoc

Të kuptosh dhe paraqitësh këtë lloj të ri rrjetash është një sfidë sa e bukur po aq dhe e vështirë. Një karakteristikë kryesore është nevoja për të kuptuar çështje nga shumë fusha të ndryshme, duke filluar nga aspekte të nivelit të ulët të hardware dhe komunikimit radio te konceptet e nivelit të lartë si bazat e të dhënave apo dhe të vetë aplikacioneve të shumta.

Prandaj si fillim në këtë kapitull do të trajtojmë, karakteristikat e dy tipve të rrjeteve ad-hoc wireless, MANETs dhe VANETs, arkitekturën e rrjetave ad-hoc wireles për të kuptuar aspektin hardware te tyre, më pas komunikimin pikë me pikë dhe sigurinë si një pikë e fortë e rrjeteteve ad-hoc wireless, sfidat si dhe fushat e aplikimit për këto lloje rrjetesh.

2.1.1 MANETs

Për t'i kuptuar protokollet e komunikimit, bëjmë një krahasimin mes komunikimit të tyre dhe njerëzve. Që të mund të kuptohen dy njerëz duhet patjetër të flasin në të njëjtën gjuhë. Njëri person e fillon bisedën, psh. me një përshëndetje. Me këtë rast personat ndoshta do të duhen patjetër të merren vesh rreth "protokollit të komunikimit", d.m.th. gjuhës që do të përdorin. Personi tjetër (i dytë) pranon ftesën për bisedë dhe komunikimi është vendosur. Personat bisedojnë në atë menyrë që kur njëri flet tjetri dëgjon dhe nuk e ndërpret. Nëse të dy flasin njëkohësisht, komunikimi praktikisht është i pamundur. Në fund njëri nga personat dërgon një thirrje për përfundim të bisedës. Mbas pranimit të personit tjetër për përfundimin e bisedës, komunikimi ndërpritet. Kjo procedurë, e cila përmban rregulla të komunikimit të përcaktuara në mënyrë precize, njihet si " protokoll ". Në të njëjtën mënyrë, dy kompjutera mund të komunikojnë vetëm nëse "flasin" me të njëjtin protokoll.

Protokolli është një bashkësi rregullash të vendosura që bëjnë të mundur komunikimin e dy kompjuterave së bashku. Këto rregulla përfshijnë mënyrën se çfarë :

- metodë aksesi do të përdoret.
- topologjie fizike përdoret.
- lloje kabllosh mund të përdoren.

3.1 Protokollet E Rutimit Për Rrjetat E Lëvizshme Ad Hoc Wireless

Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për të rritur shkallën e komunikimit kjo varet nga aplikimet në jetën e vërtetë, prandaj në këtë punim shkencor kemi nevojë për të studiuar dhe krahasuar protokolle të ndryshme rutimi duke përdorur mbingakimin e rrjetit dhe konsumin e bandwidth si parametra të rëndësishëm dhe për këtë do të shfrytëzojmë rrjetat Ad Hoc Wireless.

Një numër i madh protokollesh janë zhvilluar për rrjetet ad hoc wireless që prej ardhjes të DARPA(Defense Advanced Research Projects Agency) rrjetave 'packet radio' në fillim të 1970_ës.(J. Jubin and J. Tornow vol. 75, no. 1, 1987, pp, 21-32).

Protokollet e rutimit në rrjetet packet-switched tradicionalisht përdorin ose algoritmin e rutimit distance-vector ose link-state. Dy prej tyre lejojnë një host[33] për të gjetur hopin tjetër apo të rradhës për të arritur në destinacion nëpërmjet asaj që është quajtur "rruga më e shkurtër". Si metrikë për "rrugën e shkurtër" mund të jetë numri i HOP_eve, vonesa kohore në milisekonda, numri i përgjithshëm i paketave në pritje përgjatë rrugës, etj... Këto protokolle me path më të shkurtër janë përdorur me sukses në shumë rrjete packet-switched dinamike. Në parim, çdo protokoll i tillë mund të përdoret gjithashtu edhe në rrjetet ad hoc.

E meta kryesore e të këtyre dy protokolleve distance-vector dhe link-state është se ata marrin shumë kohë për të konvergjuar dhe kanë një kompleksitet të lartë të mesazhit. Prandaj, për këtë shkak edhe të Bandwidth_it të kufizuar të lidhjeve pa tel, në një rrjet ad hoc kompleksiteti i mesazhi duhet mbajtur i ulët. Përveç kësaj, ndryshimi i shpejtë i topologjisë kërkon që protokollet kurs të mund të gjejnë rrugë të shpejta. Pra, protokollet e reja kurs duhet të zhvillohen për të përmbushur këtë filozofi themelore.

Në bazë të karakteristikave të tyre, këto protokolle në përgjithësi ndahen në dy tipe:

- **Table-driven**
- **Source-initiated(demand-driven)**

Në mënyrë skematike më poshtë paraqiten këto dy tipe protokollesh së bashku me "nën protokolle" të tjera që bëjnë pjesë në tipet që përmendëm më lartë:

[33]Host- Mikëpritës rrjeti që mund të ofrojë burimet e informacionit, shërbimet dhe aplikacionet për përdoruesit apo nyjet e tjera në rrjet.



Diagrama 3.1. Paraqitja skematike e të dy tipeve të protokolleve të rutimit ad-hoc

Protokollet e rutimit Table - Driven përpiqen që të mbajnë qëndrueshmëri, dhe informacionin e rutimit(kursit) up-to-date në secilën prej nyjeve, pra nga njëra nyje në tjetrën në të gjithë rrjetin. Këto prokolle kërkojnë që për secilën nyje të mbajnë një ose më shumë tabela për të grumbulluar informacionin. Për të mbajtur një pamje të qëndrueshme të rrjetit, ndryshimeve në topologjinë e rrjetit këto protokolle iu përgjigjen duke propaganduar updates të rutimit në të gjithë rrjetin. Më poshtë do të trajtojmë disa prej këtyre protokolleve që bëjnë pjesë në protokollet Table – driven:

1. **(DSDV) Destination-Sequenced Distance-Vector Routing,** që është sqaruar në(J. Jubin and J. Tornow vol. 75, no. 1, 1987, pp, 21-32), është bazuar mbi mekanizmin e rutimit klasik Bellman-Ford. (L.R.Ford Jr. And D.R.Fulkerson, 1962). Është zhvilluar nga

Figura 3.1. Komunikim i thjesht ndermjet 3 nyjeve

C.Perkins dhe P.Bhagwat në 1994. Ideja ishte të zgjidhej problem I rutimit të ciklit(loop). Çdo hyrje në tabelën e rutimit përmban një numër rendor, numrat rendor janë nëse një link është present përndryshe një numër rastësor përdoret. Çdo nyje e lëvizshme në rrjet mban

një tabelë rutimi në të cilin të gjitha drejtimet e mundshme brenda rrjetit dhe numri i hop_eve janë të rregjistruara. Numrat e renditur i mundësojnë nyjeve të dallojnë ruterat e kaluara dhe të provuar më parë nga ato të reja, duke shmangur formimin e cikleve(loops) të rutimit. Ai adreson mangësitë lidhur me vetitë e varfra të ciklimit të mbyllur në RIP(protokoll i informimit të rrugëzimit) përballë lidhjeve të thyera. Modifikimi i përshtatur në DSDV e bën atë një protokoll kurs më të përshtatshëm për rrjetet ad hoc.
P.sh në këtë rrjet të thjeshtë, tabela e nyjes A do të ishte si më poshtë:[wiki]

Tabele 3.1. Paraqitja e hopeve të një nyje në një rrjet të thjeshtë.

Destinacioni	Hop_i tjetër	Numri i Hop_eve	Numrat rendor	Koha e vendosur
A	A	0	A 46	001000
B	B	1	B 36	001200
C	B	2	C 28	001500

Për të zbutur sadopak potencialin e sasisë së madhe të trafikut të rrjetit që updated mund të gjenerojnë, update_et router mund të përdorë dy lloje paketash.(E.Royer,Ch.K.Toh.,1999) E para është njohur si 'full dump', kjo lloj pakete mbart të gjithë informacionin e rutimit dhe kërkon njësi të dhënash për protokolle të rrjetit. Ndërsa lloji i dytë i paketave, paketa të vogla inkrementuese janë përdorur për të transmetuar vetëm atë informacion që ka ndryshuar që nga 'full dump' i fundit. Secili prej këtyre transmetimeve mund të përshtatet në masë standarte NPDU, duke zvogëluar sasinë e trafikut të gjeneruar. Broudcast_et[34] e ruterit të ri përmbajnë adresën e destinacionit, numrin e hop_eve që arrijnë destinacionin, numrin rendor të informacionit të marrë në lidhje me destinacionin. Përdoret gjithmonë ruteri i etiketuar me numrin rendor të fundëm.

Konsiderojmë një nyje burim S dhe një nyje destinacion D. Çdo hyrje e tabelë -rutimit në S është etiketuar me një numër rendor që e ka origjinën nga nyja destinacion. Për shembull, hyrja për D-në është etiketuar me një numër rendor që S e ka marrë nga D (ndoshta përmes

[34] Transmetime

nyjeve të tjera). Ne na nevojitet që të ruajmë qëndrueshmërinë e tabelave kurs në një topologji dinamike të ndryshueshme. Çdo nyjë periodikisht transmeton përditësime dhe kryhet nga çdo nyje kur informacion i ri i rëndësishëm është në dispozicion. Ne nuk supozojmë asnjë orë- sinkronizimi mes nyjeve celulare. Mesazhet e përditësimit tregojnë se cilat nyje janë të aksesueshme për secilën nyje dhe numrin e hops_ve për t'i arritur ato. Ne e konsiderojmë numërimin- hop si distancën midis dy nyjeve.

Megjithatë, protokolli DSDV mund të modifikohet për metrika të tjera. Ku një fqinj nga ana e vet kontrollon rrugën më të mirë nga tabela e vet e rutimit dhe ia përcjell mesazhin fqinjit të duhur të tij. Rutimi zhvillohet në këtë mënyrë. Ekzistojnë dy çështje në këtë protokoll:

a**.** Se si të ruajmë tabelat-kurs lokale.

b. Si të mbledhim informata të mjaftueshme për mirëmbajtjen e tabelave- kurs lokale.

a. Ruajtja e tabelave- kurs lokale

Ne së pari do të supozojmë se çdo nyjë ka të gjitha informatat e nevojshme për mbajtjen e tabelës-kurs të vet. Kjo do të thotë se çdo nyje e njeh të gjithë rrjetin si një grafik. Informacioni i nevojshëm është lista e nyjeve, kufijtë midis nyjave dhe kostoja e secilit kufijë. Kostot kufijë mund të përfshijnë: distancën (numri i hops_ve), normën e të dhënave, çmimin, bllokimet e trafikut ose vonesat. Ne do të supozojmë se kostoja kufi është 1 në qoftë se të dy nyjet janë brenda intervalit të transmetimit të njëri-tjetrit. Protokolli DSDV gjithashtu mund të modifikohet për kosto të tjera kufi.

b. Mirëmbajtja e tabelave të rutimit

Çdo nyjë mban tabelën e vet lokale të rutimit duke përdorur algoritmin e Bellman_Ford. Çdo nyjë 'i' mban, për çdo destinacion 'x', një grup të distancat 'dij (x)' për çdo fqinj 'j'. Nyja 'i' trajton të afërmit 'k' si hop të ardhshëm për një paketë të destinuara për 'x' në qoftë se 'dik (x)' është e barabartë me minimumin e të gjitha dij (x) kilxm (Jaya Bhatt, Naveen Hemrajani, nëntor 2013).

Mesazhi do të dërgohet nga *i* tek *l* si kosto minimale do të jetë path-i nga *x* përmes *l*.



Figura 3.2. Lokalizimi i tabelës së rutimit për secilën nyjë.

DSDV (Problemi i Luhatjeve)

Cilat jane Luhatjet

4. Hyrja për D në A: [D, Q, 14, D-100]
5. Bën Transmetimi me seq. Nr. D-102
6. A merr nga P Update (D, 15 D-102)

-> Hyrja për D në A: [D, P, 15, D-102]

A duhet ta propagandojë/përhap këtë rrugë menjëherë**.**



Figura 3.3 Luhatjet.

- A merr nga Q Update (D, 14, D-102),

  - Hyrja për D në A: [D, Q, 14, D-102]

A duhet ta përhap këtë rrugë menjëherë.

Kjo mund të ndodhë çdo herë që D apo ndonjë nyje tjetër bën transmetimin e saj dhe të çojë në njoftime rrugëtimi të panevojshme në rrjet, këto quhen luhatjet(fluktacione).

Si të shuhen luhatjet(fluktacionet)

- Regjistro kursin e fundit dhe të mesit. Bëhet vendosja kohë e çdo rrugëzimi në një tabelë të veçantë. (Të dhëna të qëndrueshme) Vendosje Kohe = Koha midis ardhjes së rrugës së parë dhe rrugës më të mirë me një numër sekuencial të caktuar.

- Lind pyetja a duhet ende të update_ojë tabelën e rutimit të vet mbi ardhjen e parë të një rruge me një numër sekuencial të ri, por ai mund të presi për ta reklamuar atë. Koha e pritjes është propozuar të jetë 2 * (Vendosje Kohe mesatare).

- Në rrjetet më të mëdha luhatje të tilla mund të shuhen për të shmangur shpalljet e panevojshme, duke kursyer bandwidth[35]

Kompleksiteti në DSDV:-Kompleksiteti kohë është O (d=diametër rrjetit), dhe kompleksitetin e komunikimit (Lidhje/dështimi linku) është O (N = numri i nyjeve të rrjetit)((Jaya Bhatt, Naveen Hemrajani, nëntor 2013). Performanca e DSDV kërkon që çdo nyje të mbajë dy tabela. Dhe pikërisht pjesa më e madhe e kompleksitetit në DSDV është për gjenerimin dhe ruajtjen e këtyre tabelave. Update/përditësimet u transmetohen fqinjëve periodikisht ose të planifikuar sipas nevojës. Me rritjen e lëvizshmërisë dhe numrit të nyjeve në rrjet, madhësia e bandwidth dhe tabelat e rutimit të nevojshme për të rinovuar këto tabela rriten njëkohësisht. Ngarkimet për mirëmbajtjen dhe përditësimin e këtyre tabelave do të rriten edhe ato njëkohësisht. Është e natyrshme që ngarkimet e larta të kursit do të pakësojnë punën e rrjetit.

Përmbledhje e protokollit DSDV:

- DSDV është proaktiv (Tabela Driven).
- Çdo nyjë mban informacionin kurs për të gjitha destinacionet e njohura.
- Informacioni Kurs duhet të përditësohet periodikisht.
- Trafiku i lartë edhe në qoftë se nuk ka ndryshim në topologjinë e rrjetit.
- Mban rrugët të cilat nuk janë përdorur.
- Mban thjeshtësinë e Distancë Vector.
- Garanton lirshmëri të ciklit(loop).
- Lejon reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve topologjike.
- Çdo nyjë mban një tabelë-kurs i cili ruan metrikën e kostos së hop_it të ardhshëm drejt çdo destinacioni, si dhe një numër sekuencial që është krijuar nga vetë destinacioni.
- Çdo nyjë periodikisht përcjell tabelën e rrugëzimit për te fqinjët e saj.
- Çdo nyje rrit dhe bashkangjit numrin e vet rendor kur dërgon tabelë – kursin/rutimin e tij lokal.

[35] gjerësi e brezit

- Çdo rrugë është etiketuar me një numër rendor; rrugët me numër më të madh rendor janë të preferuara. Çdo nyjë reklamon një numër sekuencial çift me rritje monotonike për veten.



Figura 3.4. DSDV – Reklamim i rutimit

Rregullat për të vendosur informacionin e numrit rendor:

1. Në çdo reklamim/shpallje rritë vetë numrin rendor te destinacionit (përdorim vetëm numrat çift)
2. Nëse një nyje nuk është më e arritshme (timeout) rritë numrin rendor të kësaj nyje me 1 (numër rendor tek) dhe vendos metrikë = ∞

- Kur një nyje konstaton se një rrugëtim është thyer, ajo rrit numrin sekuencial/rendor të rrugëtimit dhe e reklamon atë me metrikë infinit.
- Destinacioni reklamon numrin e ri rendor.
- Stabiliteti dhe shkallëzueshmëria e DSDV garanton rutime me cikël – të lirë në paketat kurs. Ai përdor shuarje të plota dhe në rritje për përditësime. Përditësimi rritës është përdorur në mënyrë që të gjithë tabelat kurs të mos kenë nevojë që të transmetohen për çdo ndryshim në toplogjinë e rrjetit. Gjithësesi, DSDV kërkon periodikisht update të shuarjes se plotë, pavarësisht nga numri i ndryshimeve në topologjinë e rrjetit. Në këtë aspekt, DSDV nuk është efikas në update_et e rrugëtimit/kursit.
- Rutimi QoS me DSDV. Kërkesat e rutimi QoS në rrjetat ad hoc që mbështesin trafikun në kohë reale janë përmbledhur si më poshtë:

7. Rezervimi i brezit

8. Rutimi
9. Kontrolli i mbingarkesës:
10. Lëvizshmëria

2. CGSR(Clusterhead Gateway Switch Routing) – Protokolli CGSR ndryshon nga protokolli që përmendëm më lartë në mënyrën e adresimit dhe funksionimit të skemës së organizimit të rrjetit. Ky është një rrjet i lëvizshëm wireless me multihop_e të grumbulluar. (E.Royer,Ch.K.Toh.,1999) Përdoret një algoritëm për të zgjedhur një nyje që shërben si 'cluster head' duke përdorur një algoritëm shpërndarës brenda 'cluster'(tufës).

Në një sistem clustering[36], secili nga numërat e paracaktuara të nyjeve janë formuar në një cluster të kontrolluar nga një cluster head[37], e cila është caktuar duke përdorur një algoritëm të shpërndarë të clustering. Megjithatë, me skemën clustering, një cluster head mund të zëvendësohet shpesh nga një tjetër nyje, për disa arsye, të tilla si energjia e nivelit të poshtëm që mbetet në nyje ose një nyje lëviz jashtë kontaktit. Në këtë protokoll, çdo nyjë mban dy tabelat: një tabelë cluster- anëtarë dhe një tabelë kurs. Tabela cluster-anëtar regjistron kreun cluster për çdo nyje të destinacionit, dhe tabela kurs përmban hopin e ardhshme për të arritur në destinacion. Ashtu si me protokollin DSDV, çdo nyjë përditëson tabelën e cluster-anëtar me marrjen e një update të ri nga fqinjët e saj.



Figura 3.5. Komunikimi me protokollin CGSR (Communication with cluster-head gateway switch routing)

Disavantazhi qëndron në faktin se pikërisht në 'cluster head' frekuentë, ndryshimet mund të kenë efektin e kundërt në performancën e protokollit të rutimit ndërkohë që nyjet janë të

[36] grumbullimi
[37] Kreu-Klaster

zëna në përzgjedhjen 'cluster head' në vend që paketa të transmetohet. CGSR përdorin DSDV duke iu referuar si skemë themelore rutimit.

3. **WRP (The wireless Routing Protocol) –**qëllimi është të mbajë informacionin e ruterit në të gjitha nyjet e rrjetit(S. Murthy and J. J. Garcia-Luna-Aceves, Oct. 1996). Secila nyje është përgjegjëse në rrjet.Çdo nyje në rrjet është përgjegjëse për ruajtjen e katër tabelave:
   - Tabela për distancën (Distance table)
   - Tabela e rutimit(Routing table)
   - Tabela e Link – kosto(Link-cost)
   - Tabela e listës së mesazheve të ritransmetimit.(MRL)

Nyjet e lëvizshme informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet në link duke përdorur update_in e mesazheve. Ky mesazh dërgohet ose shpërndahet ndërmjet nyjeve më të afërta dhe përmban një listë update_esh .Çdo path i ri kalon në nyjet origjinale të më parshme në mënyrë që dhe ato të update_ojnë tabelat në përpuhje me rrethanat. Në lëvishmëri kur merret një mesazh hello nga një nyje e re, kjo nyje shtohet në tabelën e rutimit të lëvizshëm dhe i dërgohet informacioni i tabelës së rutimit. Kjo ndihmon në eleminimin e situatës të cikleve(looping), duke përfituar një konvergjencë më të shpejtë kur ndodh një ngjarje dështim-linku.

4. **HSR(Hierarchical Routing Protocols)**

Lidhja i referohet mbajtjes së të gjithë rrjetit, lëshimin e përditësimeve të rutimit, duke mbajtur gjurmët e nyjeve që hyjnë dhe dalin në rrjet etj. Me rritjen e madhësisë së MANET, rritet gjithashtu edhe trafiku i kontrollit. Kur nyjet janë të ngarkuar me gjetjen e rrjetit si dhe të transferimit të të dhënave, bottlenecks[38] janë krijuar brenda rrjetit kryesor jo vetëm në daljen nga puna të baterisë, por dhe në performancën e ngadaltë të rrjetit.

Prandaj është shumë e rëndësishme që të distancojmë të dyja këto funksione për të parandaluar dështime të nyjes për shkak të vështirësive dhe të kushteve të ulta të energjisë siç shihet në modelet hierarkike. Ne gjithashtu kemi për të zgjidhur problemin e

[38] Pengesa

scalability[39]. Kjo mund të bëhet duke ndarë Manet në grupe me një që ngarkohet me përgjegjësi të detyrueshme. Grupimi brenda MANETs është thelbësore pasi ai i dekurajon tabelat e mëdha kurs. Secili sektor mund të ketë vetëm një numër të kufizuar të nyjeve celular që cluster-head mund të mbështesi. Nëse numri tejkalohet një tjetër cluster mund të jetë krijuar me një cluster-head. Kjo gjithashtu kufizon trafikun e kontrollit brenda sektorit. Claster-head i secilit sektor është i lidhur me claster-head të grupimeve fqinje të tij të menjëhershme nëpërmjet një nyje portë (shih figurën 3.6). Cluster-heads nuk marrin pjesë në transferimin e të dhënave, përgjegjësia kryesore e tyre është të lidhin cluster dhe të mbajnë updated tabelat e rutimit. Kjo gjithashtu e ruan clusterhead nga ikja/mbarimi i energjisë dhe shmang krijimin e bottlenecks në pathin e rutimit që ndodhë për shkak të trajtimit të dy detyrave.



Figura 3.6. Ndarja hierarkike e rrjetit

Rrugëzimi në kurset e protokollit HSR mund të jetë dy llojësh; e parë që përfshin vetëm një cluster, dhe i dyti, që përfshin cluster të shumëfishta. Në rastin e rrugëzimeve që përfshin cluster të shumëfishta, e gjithë rruga është e ndarë në segmente. Ky rrugëzim aktiv menaxhohet në mënyrë hierarkike duke përdorur dy protokollet



Figura 3.7. Segmentimi i Rrugës

[39] Shkallëzueshmërisë



Figura 3.8. Rrugëzimi nga Burimi “S” në Destinacionin “D”

kurs; një në nivel inter-segmentit dhe tjetri në nivel intrasegment. E gjithë rruga nga burimi në destinacion ka nyjet që përfshijnë cluster të shumëfishta dhe janë të ndara në segmente. Një segment është një pjesë e një rruge që formon një pjesë të një claster_i të caktuar. Kjo është rruga midis dy nyjeve portë apo rruga midis nyjes portë dhe nyjes burim apo nyjes destinacion. Me fjalë të tjera, një rrugë është një lidhje e një ose më shumë segmenteve dhe segmenti ka një kokë- segment. Ku informacioni i nevojshëm për të ruajtur kursin është dhënë në nyjen qendrore segment nga kreu- cluster i kësaj zone. E gjithë rruga reduktohet në një lidhje një dimensionale të segmenteve që përfshin shumë cluster-a nga burimi në destinacion. Siç tregohet në figurën 3.6 nyjet kre-cluster nuk formojnë një pjesë të itinerarit të kursit. Nyjet e errëta që janë treguar në figurën 3.6 janë nyje cluster- portë që ndërfaqosin dy cluster- fqinje. Gjithashtu vini re se nuk ka nyje cluster header pjesëmarrëse në këtë kurs. Ndërsa DSR përcakton itinerarin e plotë nga burimi në destinacion. Në HSR vetëm adresat e nyjeve portë specifikohen siç tregohet në figurën 3.8 e cila tregon një krahasim të rrugëzimit të kreut ndërmjet HSR dhe CGSR gjatë 'udhëtimit' të paketës nga Burimi "S" në Destinacion “D”. Vini re se CSR është zbatuar në nivel intra-cluster dhe DSR në nivel inter-cluster. Hierarkike, rrugët menaxhimit mund të jetë e dobishme kur është fjala deri te paketa e sipërme dhe duke minimizuar vonesën pikë me pikë(end-to-end). Në protokollet e sheshtë kurs, sa herë që një nyje pjesëmarrëse bie jashtë apo bëhet joaktive gjithë rruga duhet të themelohet. Me rritjen e madhësisë së MANET rrugët bëhen më të gjatë dhe thyehen më shpesh. Kjo shkakton harxhim të madh të burimeve dhe kohës. Ku si në rastin e zgjidhjes së propozuar, sa herë që një dështim nyje ndodh për ndonjë arsye ajo mund të riparohet në vend, pa pasur nevojë të hidhet poshtë itinerari i plotë i rrugës. Kjo kursen shumë kohë dhe në masë të madhe zvogëlon rrjetin e lartë të panevojshëm. Prandaj dy

protokollet janë shkrirë së bashku në këtë hierarki duke zbatuar CGRP në nivel intra-segment dhe DSR në nivel inter-segment. Më poshtë po paraqesim dy kurset:

Kursi DSR	**Kursi HSR**
1.At Source S–D R4 G3 R3 G2 R2 G1 R1	1. At Source S – D G3 G2 G1 R1
2. At G1 – D R4 G3 R3 G2 R2	2. At G1 – D G3 G2 R2
3. At G2 – D R4 G3 R3	3. At G2 – D G3 R3
4. At G3 – D R4	4. At G3 – D R4

5. Protokolli FSR

FSR(Fisheye Shteti Routing) është një protokoll implicit hierarkik kurs. Gjithashtu konsiderohet si një protokoll proaktive dhe është një protokoll kurs i bazuar në gjendjen e linkut(link-state) që është përshtatur me mjedisin ad hoc wireless. Nyjet shkëmbejnë hyrjet e link state me fqinjët e tyre me një frekuencë e cila varet nga distanca për destinacion.

Ky protokoll përdor teknikën "fisheye"(teknika e Peshkut) e propozuar nga Kleinrock dhe Stevens (L.Kleinrock and K.Stevens,1971), ku kjo teknikë është përdorur për të zvogëluar madhësinë e informacionit që kërkohet për të përfaqësuar të dhënat grafike. Syri i një peshku kap me hollësi të lartë pixel_at pranë pikë fokale/qëndrore. Detaji zvogëlohet ndërsa distanca nga Pika Fokale rritet. Në kurs, përqasja fisheye përkthehet në ruajtjen e saktë të distancës dhe informacionit e cilësisë së rrugës në marrëdhënie fqinjësie të drejtpërdrejta të një nyje, me më pak detaje në mënyrë progresive me rritjen e distancës.



Figura 3.9 Paraqitje e teknikës "Fisheye"

FSR është funksionalisht i ngjashëm me rugëtimin LS (Link State) në atë që ajo mban një hartë topologjie në çdo nyje. Në LS, paketat janë gjeneruar dhe përmbytur/vërshuara në rrjet sa herë që një nyje zbulon një ndryshim topologji. Në FSR, paketat link- state nuk janë

të vërshuara. Në vend të kësaj, nyjet mbajnë një tabelë link-state bazuar në informacionin up-to-date të marra nga nyjet fqinje, dhe periodikisht e shkëmbejnë atë vetëm me fqinjët e tyre lokale (pra nuk ka vërshime). Tabela periodike e shkëmbimit FSR i ngjan vektorit shkëmbimit në Distributed Bellman-Ford (DBF), në një ambient pa tel, një lidhje radio midis nyjeve celular mund të përjetojnë shkëputje të shpeshta dhe rilidhje. Protokolli LS lëshon një përditësim të link-state për çdo ndryshim të tillë, i cili përmbyt rrjetin dhe shkakton prurje të larta. FSR shmang këtë problem duke përdorur këmbimin periodik të hartës topologjike, duke reduktuar në masë të madhe ngarkesen e mesazh kontrollit. Kur madhësia e rrjetit rritet shumë, mesazhi përditësimit mund të konsumojë sasi të konsiderueshme të Bandwidth, e cila varet nga periudha e përditësimit. Në mënyrë që të zvogëlojë madhësinë e mesazheve të përditësimit pa ndikuar seriozisht saktësinë e kursit, FSR përdor teknikën Fisheye (shih Fig. 3.9) të shpjeguar më lartë.

Siç e theksuam diçka edhe më lartë protokollet që bëjnë pjesë në këtë grup mbështeten në një mekanizëm update$_{imi}$ të tabelës së rutimit që përfshin përhapjen konstante të informacionit të rutimit. Kur një nyje i nevojitet një kurs për një destinacion të ri asaj i duhet të pres derisa ky ruter apo kurs të zbulohet. Nga ana tjetër duke qenë se i gjithë informacioni përhapet në mënyrë konstante dhe mbahet në protokollet e rutimit table-driven, një kurs për secilën nyje në rrjetat ad hoc wireless mbahet në dispozicion, pavarësisht nëse është apo jo e nevojshme. Të gjitha protokollet që permendëm përveç CGSR përdorin skemë adresimi monoton ose të sheshtë (flat), faktikisht ky lloj adresimi është më pak i komplikuar dhe më i lehtë për tu përdorur.

Protokollet e rutimit Source–Initiated On–Demand - Ky lloj rutimi krijon ruterat(rrugët) vetëm kur këtë e kërkon nyja burim. Kur një nyje kërkon një rrugë për një destinacion, ajo inicon një proçes rutim-zbulimi brenda rrjetit. AODV, DSR si dhe disa protokolle të reja bëjnë pjesë në këtë grup protokollesh.

1. **AODV (Ad Hoc On-Demand Distance Vector Routing)-** AODV është një përmirësim i protokollit DSDV. Nyjet që nuk ndodhen në rrugën e përzgjedhur nuk përmbajnë informacionin e rutimit ose marrin pjesë në shkëmbimet e tabele- rutimit. (E.Royer,Ch.K.Toh, Aprile 1999).

AODV përdor destinacionin e numrave të renditur(sekuencës) për të siguruar se të gjitha rrugët janë loop-free dhe të përmbajë informacionin më të fundit të ruterit. Dy aktivitet e rëndësishme të këtij protokolli janë:

– Zbulim Rrugëtimi - kryhet sa herë që një nyje ka nevojë për një "hop tjetër" për të përcjellë një paketë në një destinacion
– Mirëmbajtje e Rrugëtimit - Përdoret kur shkëputet linku, duke e bërë hop_in tjetër të papërdorshëm

Nëse një nyje- burim lëviz, kjo shkakton ri-inicializimin e protokollit te rutimit për gjetje zbulim- rrugëtim, pra për të gjetur një ruter te ri për në destinacion. Nëse një nyje lëviz përgjatë rrugës, fqinji i saj në rrjedhën e sipërme jep masën- njoftime dhe propagandon ose i shpërndan nje mesazh dështim-linku secilit prej fqinjëve të saj me aktive(afërt) për ta informuar atë për fshirjen e asaj pjese të kursit.

Mekanizmi Zbulim -Rrugëtim është i përdorur për të gjetur një rrugë drejt një destinacioni. Kurdo që një nyje gjeneron një pako, ajo kontrollon nëse ajo ka një rrugë të vlefshme për destinacionin e vet. Nëse nuk ndodh kështu, ajo transmeton një mesazh kërkesë – rrugëtim (RREQ) që do të marrë nga të gjitha terminalet që janë fizikisht më afër me të. Ndodhin tri situata kur një RREQ është pranuar: (1) nyja është vetë destinacioni dhe do përgjigjet me nje mesazh përgjigje- rrugëtim (RREP), (2) Nyja e kishte përpunuar tashmë një tjetër RREQ me të njëjtin çift nyjesh objektiv- burim si identifikim unik; (3) nyja shton adresën e saj më pas ritransmeton RREQ. Siç mund të shihet, kur RREQ arrin nyjen e synuar, ajo ka informacion në lidhje me të gjitha nyjet e vizituar gjatë rrugës drejt destinacionit.

Route Request (RREQ) - kërkesë rrugëtimi/kurs

Route Reply (RREP) - përgjigje rrugëtimi/kurs

Processing a RREQ Message:



Figura 3.10 Mekanizmi Zbulim -Rrugëtim

- <ID- transmetimi, IP- adresa > çift i burimit S formon një identifikues unik për RREQ. Supozoni një nyje N që merr RREQ nga S. N kontrollon së pari nëse ajo ka marrë këtë RREQ më parë. Secila nyje magazinon çiftet< ID- transmetimi, IP- adresa > për të gjithë RREQ_tet e fundit që ajo ka marrë. Nëse N e ka parë këtë RREQ nga S tashmë, N discards RREQ. Përndryshe, N përpunon RREQ: N krijon një hyrje të kundërt të kursit në tabelën e saj të rrugëtimit për burimin S. Kjo hyrje përmban adresën IP dhe numrin aktual sekuencial të S, numrin e hops në S dhe adresën e fqinjit prej të cilit N mori edhe RREQ.

Tre gjëndje të rëndësishme:

Unicasting

- AODV është rrugëtimi pikë-me-pikë, kur një nyjë burim dëshiron të dërgojë një mesazh në një nyje destinacion.

Multicasting

- Në këto situata, një nyje dëshiron të dërgojë një mesazh në një grup nyjesh në rrjet. Ky quhet multicasting dhe grupi quhet një grup multicast.

Broadcasting

- Broadcasting/Transmetimi është një rast i veçantë i multicasting kur të gjitha nyjet në rrjet janë në grupin multicast.

AODV mbështet multicasting dhe unicasting brenda një kuadri uniform. Madhësia paketë në AODV është uniforme ndryshe nga DSR. Ndryshe nga AODV, DSDV nuk ka nevojë për transmetime të gjerë të sistemit për shkak të ndryshimeve lokale.

Ne mund përmbledhim se:

- Kërkesë-rrugëtimi (RREQ) përfshin numrin rendor të fundit të njohur për destinacionin
- një nyjë e ndërmjetme mund të dërgojë një rrugë Përgjigje- rrugëtimi (RREP) me kusht ose duke siguruar që ajo e di një rrugë më të fundit se ajo e njohur më parë për te dërguesi.
- nyjet e ndërmjetme që përcjellin RREP, gjithashtu regjistrojnë hop_in tjetër në destinacion
- një tabelë- kurs që hyn duke mbajtur një rrugë të kundërt, shlyhet pas një kohe jashtë intervalit.

2. DSR(Dynamic Source Routing) është një protokoll rutimi për rrjetat MESH wireless**.** DSR**-** është bazuar në konceptin e rutimit burim. Nyjet në lëvizje ngarkohen të kenë një memorje të vogël por të shpejtë, tip memorje cashe[40], të cilat mbajnë kursin e burimit pë të cilat lëvizja është e vetdijshme. Përmbajtja e cashes update$_{\text{-ohet}}$ vazhdimisht sa herë që një kursi I ri mësohet. Dhe në fakt ky protokoll përmban dy faza(E.Royer,Ch.K.Toh, Aprile 1999):

a. Zbulimi i rutimit(kursit)
b. Mirëmbajtja e rutimit.

Kështu kur një nyje e lëvizshme ka një paketë për të dërguar në destinacion, së pari konsulton cashe$_{\text{_n}}$ rutimi për të përcaktuar se kur mund të disponojë nje kurs(rutim) për në destinacion. Në të kundërt nëse nyja nuk ka një ruter të disponueshëm inicalizohet faza e kërkimit ose zbulimit të rutimit duke broadcasting një paketë kërkesë – rutimi, që përmbajnë adresën e destinacionit, bashkë me adresën e nyjeve burim dhe një numër unik identifikues. Secila nyje që merr paketën kontrollon njëherë nese ajo e njeh këtë rrugë për në destinacion. Kur është negative, pra nuk e njeh, ajo shton adresën e vet në rekordin-

[40] Memorje e vogël e shpejtë, pjesë e memorjes qëndrore

rutimit të paketës, përcjell paketën përgjatë linkut të daljes. Një përgjigje rutimi (ruter replay) gjenerohet kur kërkesa për rutim arrin në destinacionin e vet ose nyjen që përmban cashe me rekordin- rutim që lëshon skuencat e marra Hops. *Mirëmbajtja e rrugëtimit* realizohet nëpermjet përdorimit të paketave gabim-rutimi dhe pranimeve (acknowledgments) ose njohjet që përdoren për të verifikuar operacionet e rregullta të linke_ve kurs. Pako gabimit rrugë janë të krijuara në një nyje kur shtresa Lidhje të dhënave ballafaqohet me një problem fatal të transmetimit. Kur një paketë me gabim-rrugëzimi është pranuar, hop_i në gabim ka larguar nga rruga cache nyjen dhe të gjitha rrugët që përmbajnë hop janë cunguar në atë pikë. Përveç mesazhet e gabim- rrugëzimit, mirëmbajtja është përdorur për të verifikuar funksionimin korrekt të lidhjeve rrugës. Njohuri të tilla përfshijnë mirënjohje pasive, ku një celular është në gjendje të dëgjojnë hop tjetër duke forwarding paketën përgjatë rrugës.

3. TORA (Temporally Ordered Routing Algorithm) - shpikur nga Vincent Park dhe M.Scott Corson nga Universiteti i Marylandit. Tora është një protokoll rutimi on-demand.

• Objektivi kryesor i Tora është të limitohet përhapja e mesazh- kontrollit në mjedis dinamik mobile.

• Çdo nyjë duhet të iniciojë një query kur i nevojitet dërgimi i të dhënave në një destinacion të veçantë

Tora kryen tri detyra(E.Royer,Ch.K.Toh, Aprile 1999):

- Krijimi i një routeri nga burimi në destinacion
- Mirëmbajtja e ruterit
- Fshirja e ruterit kur rruga nuk është më e vlefshme

Tora tenton të ndërtojë atë që është i njohur me grafi i drejtuar aciklik(DAG) i cili është i ingranuar në destinacion.

Ideja është së pari të ndërtohet një DAG nga burimi në destinacion dhe pastaj nëse kemi dështim linkesh, bëhet i nevojshëm rindërtimi i një DAG i tillë që të gjejë ruterin.

Në kohën e lëvizshmërisë nyjes DAG -kursi prishet, dhe për mirëmbajtjen e kursit e nevojshme të krijojet një DAG i ngulitur në të njëjtin destinacion. Siç është paraqitur në

Figurën 2.12. b(E.Royer,Ch.K.Toh, Aprile 1999), pas dështimit të lidhjes së fundit në drejtim të rrymës, një nyje gjeneron një nivel të ri referimi që rezulton në propagandimin e këtij niveli të referencës nga nyjet fqinje, duke koordinuar në mënyrë efektive një reagim të strukturuar ndaj dështimit.



Figura 3.11 a) Krijim- rutimi në TORA; b) Mirëmbajtje-rutimi në TORA

Metrikë i Tora është një pesëfish i përbërë nga pesë elemente, të emërtuar:

1. Koha logjike e një dështim-Linku
2. ID unike e nyjës që përcakton referenca e re
3. Një bit tregues reflektimi
4. Një parametër urdhër- përhapje/propagandimi
5. ID unike e nyjes

Tre elementët e parë së bashku përfaqësojnë nivelin e referencës. Një nivel i ri i referencës është përcaktuar sa herë që një nyje humbet lidhjen e tij të fundit në drejtim të rrymës për shkak të dështim- link_ut. (E.Royer,Ch.K.Toh, Aprile 1999). Faza fshirje -rrugës në Tora në thelb përfshin përmbytjet e një pakete qartë e transmetuar (CLR) në të gjithë rrjetin për të fshirë rrugët e pavlefshme.

Pra TORA përdor koordinim ndërnyj_or, paqëndrushmëria e problemit të tij është e ngjashme me "të numëruarit-deri-në pafundësi " problem ky në protokollet e rutimit distancë-vektor, përveç se duhet thënë se luhatje të tilla janë të përkohshme dhe konvergjenca- kurs do të ndodhë në fund të fundit.

ABR(Associativity-Based Routing) – ABR është një kompromis midis rutim-transmetimit dhe atij të dyanshme [point-to-point]. ABR siguron rrugëtimin vetëm për ato burime që e dëshirojnë një gjë të tillë. Por ABR nuk ka funksionin e rindërtimit të rrugëtimit mbi bazën e informacionit për rrugët alternative, të depozituar në IN-të (duke mënjanuar kështu rrugët e konsumuara). Veç kësaj, vendimet e rrugëtimit performohen në DEST ku vetëm rruga më e mirë zgjidhet e përdoret ndërsa të gjitha rrugët e tjera të mundshme mbeten pasive, gjë që shmang duplikimin e paketës. Gjithashtu, për shkak të cilësisë së bashkëshoqërimit/ ndërlidhjes, siç përshkruhet më poshtë, rruga e zgjedhur ka gjasa të jetë më jetëgjatë. Ndonëse protokolli ABR nuk është projektuar për të mbështetur garancitë e QoS-it, protokolli ynë i ABR-së megjithatë i dallon cilësisht rrugët e mundshme. Rrjedhimisht, krahas mbështetjes së aplikimeve bashkëpunues, ABR mund të përdoret për të mbështetur edhe aplikimet multimediale adaptive të lëvizshme. (Sugikawa, Y. Morioka, K. Iwamura, Y. Tajika and M. Nakamura April 1995)

Në të dallohen qart tri faza:

- Zbulim kursi
- Rindërtimi i kursit(RRC)
- Fshirja e kursit

Faza zbulim- kursi është kryer nga një query transmetimi dhe një cikli ‘presë-përgjigje’ (BQ-REPLY). Një nyjë që dëshiron një rrugë transmeton një mesazh BQ në kërkim të

mobile_ve që kanë një kurs për në destinacion Të gjitha nyjet që marrin këtë query (që nuk janë destinacioni) ia bashkëngjitin adresat e tyre dhe ticks[41] shoqëruese fqinjëve të tyre, së bashku me informacionin e QoS së paketës query. Një nyjë pasardhëse fshin hyrjet tik shoqeruese të fqinjëve në rrjedhën e sipërme të saj dhe ruan vetëm hyrjen që ka lidhje me të dhe nyjen e saj në rrjedhën e sipërme. Në këtë mënyrë, çdo paketes rezultante që mbërrin deri në destinacion do të përmbajë ticks shoqëruese të nyjeve përgjatë rrugës për në destinacion. Destinacioni është në gjendje për të zgjedhur rrugën më të mirë duke ekzaminuar ticks shoqëruese përgjatë secilës prej rrugëve. RRC mund të përbëhet nga zbulimi i pjesshëm i rrugës, fshirja e rrugës së pavlefshme, përditësimet e rrugës së vlefshme, dhe zbulim i rrugës së re, në varësi të rrugës përgjatë së cilës nyja (s)lëviz. Kur një rrugë e zbuluar nuk dëshirohet, nyja burim fillon një transmetim fshi-kurs(rout – deleted/RD) në mënyrë që të gjitha nyjet përgjatë rrugës të update_ojnë tabelat e tyre të rutimit. Mesazhi RD është përhapur nga një transmetim i plotë, në krahasim me një transmetim të drejtuar, sepse nyja burim nuk mund të jetë në dijeni të ndonjë ndryshim të rrugës së nyjes që kanë ndodhur gjatë RRC.

4. **SSR (Signal Stability Routing):** Ky është një tjetër protokoll që bënë pjesë në protokollet on-demand. Ndryshe nga algoritmet e përshkruara deri më tani, SSR zgjedh rrugët e bazuar në fuqinë e sinjalit ndërmjet nyjeve dhe stabilitetit të vendodhjes lokacionit së një nyje. Ky kriter përzgjedhje- rrugëzimi ka efektin e zgjedhjes të rrugëve që kanë lidhje "të fortë". SSR mund të ndahet në dy protokolleve të bashkëpunimit: Dynamic Routing Protocol (DRP) dhe Static Routing Protocol(SRP). Ku DRP është përgjegjës për mirëmbajtjen e Tabelës së Stabilitetit të Sinjalit (SST) dhe Tabelës së Rutimit (RT). SST regjistron fuqinë e sinjalit të nyjeve fqinje, e cila është marrë nga sinjalizuesit periodike nga shtresa link e çdo nyje fqinje. Fuqia e sinjalit mund të regjistrohet si një kanal i fortë apo i dobët. Të gjitha transmetimet janë marrë nga, dhe të përpunuara në DRP. Pas përditësimit të të gjitha hyrjeve të nevojshme tabelë, DRP kalon një paketë të marrë në SRP. Të SRP përpunon paketat duke kaluar paketën gjer në grumbullim, nëse është marrësi i synuar apo në kërkim deri në destinacion në RT dhe

[41] Tik-tak/tike

pastaj e përcjell paketën në qoftë se nuk është e duhura. Nëse nuk ka hyrje në RT për destinacionin, një proçes rrugë-kërkimi është iniciuar për të gjetur rrugën. Kërkesat për rrugë propagandohen në të gjithë rrjetin, por janë dërguar vetëm për hop_in tjetër në qoftë se ata janë pranuar mbi kanale të forta dhe nuk janë përpunuar më parë (për të parandaluar krijim laku/looping).

3.2 Krahasimi Mes Protokolleve Të Rutimit Për Rrjetet Ad – Hoc Wireless

Më poshtë do të jepet një krahasim midis të gjithë këtyre protokolleve që u përmendën më lartë për rrjetet ad-hoc wireless.

Për protokollet e rutimit Table-driven, ky krahasim do fillojë të paraqitet me anë të një tabele të dhënë më poshtë **(**E.Royer, Ch.K.Toh, Aprile 1999)

Tabela 3.2. Krahasimi ndërmjet protokolleve të rutimit Table-driven

Parametrat	**DSDV**	**CGSR**	**WRP**
Kompleksiteti Kohë / (shtesë linku/dështim)	**O(*d*)**	**O(*d*)**	**O(*h*)**
Kompleksiteti i komunikimit/ (shtesë linku/dështim)	**O(x=N)**	**O(x=N)**	**O(x=N)**
Filozofia e rutimit	**I rrafshët**	**Hierarkik**	**I rrafshët***
Cikël i Lirë(loop free)	***Po***	***Po***	***Po(por jo i menjëhershëm)***
Aftësi Multicast	***Jo***	***Jo****	***Jo***
Numri i tabelave të kërkuara	**2**	**2**	**4**
Frekuenca e Transmetimeve të përditësuara	**Periodikisht dhe sipas nevojës**	**Periodikisht**	**Periodikisht dhe sipas nevojës**
Përditësimet Transmetohen në	**Fqinjët**	**Fqinjët dhe kreu-**	**Fqinjët**

		grup(claster head)	
Shfrytëzon numrat sekuencial	***Po***	***Po***	***Po***
Shfrytëzon mesazhet hello	***Po***	***Jo***	***Po***
Nyjet kritike	***Jo***	***Po(cluster head)***	***Jo***
Metrikë rutimi	***Rruga më e shkurtër(shortes path)***	***Rruga më e shkurtër***	***Rruga më e shkurtër***
Shkurtime: **N= numri i nyjeve në rrjet** **d= diametri i rrjetit** **h= Lartësia e pemës kurs** **x= Numri i nyjeve të ndikuar nga një ndryshim topologjik** *** Ndërsa WRP përdor adresimin e sheshtë, ajo mund të përdoret në mënyrë hierarkike** **** Vetë Protokolli momentalisht nuk e mbështet multicast; Megjithatë, ekziston një protokoll i veçantë, i cili shkon në krye të CGSR dhe siguron aftësi multicast**			

Përveç krahasimit tabelor, i cili na jep dijeni mbi performancën dhe disa elemente të protokolleve të rutimit Table-driven, mund të shtojmë në vazhdimësi për secilin prej tyre se:

DSDV: kërkon një up-to- date të rregullt të tabelës së rutimit, përdor të gjithë fuqinë e baterisë si dhe një sasi të vogël të 'bandwidth' edhe kur rrjeti është bosh ose jo i ngarkuar. Topologjia e rrjetit ndryshon dhe një sekuenë numerike e re është e nevojshme para se rrjeti të ri-konvergjjë. Ky protokoll nuk është i përshtatshëm për rrjetat me dinamikë të lartë. Stabiliteti dhe shkallëzueshmëria e DSDV garanton rutime me cikël-të lirë në paketat kurs. Ai përdor shuarje të plota dhe në rritje për përditësime. Përditësimi rritës është përdorur në mënyrë që e gjithë tabela kurs të mos ketë nevojë që të transmetohet për çdo ndryshim në toplogjinë e rrjetit. Gjithësesi, DSDV kërkon periodikisht update të shuarjes se plote, pavarësisht nga numri i ndryshimeve në topologjinë e rrjetit. Në këtë aspekt, DSDV nuk është efikas në update_imin e rrugëtimit/kursit.

CGSR: ngjason me protokollin DSDV, vetëm se këtu nevojiten 'cluster- heads' and 'gateways'(portat). Një avantazh i këtij protokolli është që mund të përdoren disa metoda heuristike për të përmirësuar performancën e protokollit.

WRP: ky protokoll ndryshon në disa pika nga protokollet e sipër përmendura. Së pari ky protokoll kërkon që çdo nyje të mbaje katër tabela rutimi. Kjo mund të çojë në kërkesa sinjifikante, reale të memorjes, sidomos kur numri i nyjeve në rrjet është i madh. Gjithashtu ky protokoll kërkon përdorimin e paketave hello sa herë që nuk ka transmetime recente të paketës nga një nyje e caktuar. Ky protokoll bënë pjesë në klasën e algoritmave gjetje-path_i (path –finding), por ky si protokoll ka një avantazh, ai shmang problemin e krijimit të cikleve (loops) të rutimit të përkohshëm që këto algoritma kanë gjatë verifikimit të informacionit parardhës. Ka kompleksitet kohe më të ulët sesa DSDV.

Pasi krahasuam me rradhë të gjithë protokollet e rutimit Table-driven, po nisim me krahasimin e protokolleve të rutimit *Source –Initiated On –Demand:*. Edhe këtë krahasim do ta nisim me ilustrimet dhe krahasimin e parametrave të paraqitur në tabelën e më poshtme të modeluar dhe sqaruar tek **(**E.Royer, Ch.K.Toh, Aprile 1999).

Tabela 3.3 Krahasimi ndërmjet protokolleve të rutimit source-initiated on-demand

Performanca e Parametave	**AODV**	**DSR**	**TORA**	**ABR**	**SSR**
Kompleksiteti Kohë (inicializimi)	***O(2d)***	***O(2d)***	***O(2d)***	***O(d+z)***	***O(d+z)***
Kompleksiteti Kohë (pasdështim)	***O(2d)***	***O(2d)ose 0****	***O(2d)***	***O(d+j)***	***O(d+j)***
Kompleksiteti Komunikimi (inicializimi)	***O(2N)***	***O(2N)***	***O(2N)***	***O(N+y)***	***O(N+Y)***
Kompleksiteti Komunikimi	***O(2N)***	***O(2N)***	***O(2x)***	***O(x+y)***	***O(x+Y)***

(pasdështim)					
Filozofia e rutimit	***I rrafshët***	***I rrafshët***	***I rrafshët***	***I rrafshët***	***I rrafshët***
Cikël/Lak-Lirë (loop-free)	***Po***	***Po***	***Po***	***Po***	***Po***
Aftësi Multicast	***Po***	***Jo****	***Jo***	***Jo***	***Jo***
Kërkesa sinjalizuese	***Jo***	***Jo***	***Jo***	***Po***	***Po***
Mundësi për rutim të shumëfishtë	***Jo***	***Po***	***Po***	***Jo***	***Jo***
Rutimi i mbajtur në:	***Tabelë-Rutimi***	***Cache-Rutimi***	***Tabelë-Rutimi***	***Tabelë-Rutimi***	***Tabelë-Rutimi***
Përdor cache të rutimit / Kohëmatës i skadimit të tabelës	***Po***	***Jo***	***Jo***	***Jo***	***Jo***
Metodologjia e konfigurimit të rutimit	***Fshi rutim / Njofto burim***	***Fshi rutim / Njofto burim***	***Pezullim Linku/ Riparm rutimi***	***Lokalizim i quer_it të transmetimit***	***Fshi rutim / Njofto burim***
Metrika të Rutimit	***Rruga më e freskët dhe më e shkurtër***	***Rruga më e shkurtër***	***Rruga më e shkurtër***	***Shoqërizimi dhe rruga e shkurtër dhe te tjera******	***Shoqërizimi dhe Stabiliteti***

Shkurtime:

l= diametri i segmentit të prekur të rrjetit

y= numri totatl i nyjeve që formojnë pathin e drejtuar ku paketa REPLY kalon

z= diametri i pathit të drejtuar ku paketa REPLY kalon

***cache qëllon/arrin sukses**

****ashtu si CGSR edhe TORA gjithashtu nuk e mbështet multicast, megjithatë është një protokoll i**

veçantë, LAM, i cili vepron në krye te TORA dhe i siguron mundësi multicast.
ABR- gjithashtu përdor rutimin duke zhvilluar sërisht(replaying) ngarkesën dhe vonesat kumulative përcjellëse si metrika te rutimit.

- AODV i nevojitet një numër shumë më i vogël paketash overhead[42], krahasuar me DSDV.
- Paketat e overhead në AODV janë si pasojë e mesazheve RREQ, RREP dhe RERR.
- Numri i paketave overhead rritet me rritjen e lëvizshmërisë, duke qenë se kjo e fundit shkakton rënie të shpeshta linje dhe gjetje rrugësh.
- Vonesa në gjetjen e rrugëve në AODV është më e vogël krahasuar me DSR dhe DSDV.
- Vonesa është thuajse e pandryshueshme edhe me rritjen e lëvizshmërisë nëse përqendrimi i nyjeve [nodes] mbetet i ngjashëm.
- Gjatësia mesatare e path_it për gjetjen e rrugëve është po ashtu mjaft e ulët.
- DSR, AODV janë të ngjashme në fuqinë e përcjelljes së paketave.
- DSR ka harxhim shumë më të ulët trafik rrugësh transmetimi [routing] (përjashtuar zgjatimin e rrugëve të transmetimit të DSR-së në çdo paketë të dhënash).

Dobësitë tek protokolli AODV vërehen tek:

- Latenca
- Transmetime të Zbulim-rrugëzimit
- ICMP i pakapshëm vetëm pas përpjekjes për zbulim-rrugëzimi

[42] të ngarkuara

Përsa i përket konvergjencës së Performancës:

- Konvergjenca është aftësia e protokollit të rutimit për të "stabilizuar" me shpejtësi rrugët që njeh.
- DSR & AODV gjithmonë përcjellin të paktën 95% të paketave të dërguara në çdo rast.
- TORA nuk arrin të konvergjojë në më pak se ~500s kohë pushimi por gjithmonë konvergjon për 10 dhe 20 burime.
  - Krijohet Lak/Cikël për shkak të ngjeshjes/mbipopullimit
- DSDV nuk konvergjon me kohë pushimi më të ulët se ~300s kur nyjet lëvizin me shpejtësi 20 m/s.

3.3 Paraqitja e Performancës me Dy Simulator, MATLAB dhe DARS.

3.3.1 Implementimi dhe Performanca e Protokollit AODV me anë të simulimeve në MATLAB simulator.

Efektiviteti i komunikimit navigacional rritet duke optimizuar parametrat e protokollit AODV per rrjetat e lëvizshme ad-hoc wireless. Sigurisht shihet paraqitja e efiçencës më të mirë, për një numër të caktuar nyjesh, deri në pikën optimale.

SIMULIMI: Si simulator është përdorur MATLAB për algoritmin e rutimit AODV, për karakteristikat e të cilit kemi folur në paragrafët më sipër. Si metrik, zakonisht në rrjetat ad hoc wireless, për këto lloj protokollesh përdoret '*numri i hopeve për në destinacion'*

Kodi për performancën (implementation and Source code in MATLAB, by Rupam):

```
function [thrput]=performance(packet_total,node,dist,Max)
 r=randperm(100);
d=dist;
% per packet transmission watt energy loss.threashold 20% of original.
for j=1:1:length(node)-1
n1.es=node(j).es;
n2.es=node(j+1).es;
```

```
 threashold=n1.es*.2
packetsent=0;
eloss=d*.01;
  % each packet looses .01 watt energy%
while(n1.es> threashold)
   n1.es=n1.es-eloss;
   node(j).es=n1.es;
  if(packetsent<packet_total)
    packetsent=packetsent+1;
  end
end
```

Kodi për lëvizjen e nyjeve, hopet në destinacion:

```
 clc;
clear all;
Max=10;
for(i=1:1:Max)
n(i,:)=randint(1,2,[2 100])
end
%n(2,:)=randint(1,2,[2 100])
%n(3,:)=randint(1,2,[2 100])
%n(4,:)=randint(1,2,[2 100])
%n(5,:)=randint(1,2,[2 100])
for i=1:1:Max
%stem( n(i,1),n(i,2))
plot( n(i,1), n(i,2),'--rs','LineWidth',2,...
                'MarkerEdgeColor','k',...
                'MarkerFaceColor','g',...
                'MarkerSize',10,...
                'Tag','hi')
```

```
hold on;
end
grid on;
hold on;
 % e RREQ të gjenerua
RREQ.Src=1
RREQ.Dst=5
 %%%%%%%% të gjitha nyjet gjenerojnë një paketë 'Hello' duke vënë kohën e fillimit
kur merren nga destinacioni koha është llogaritur dhe kjo distancë është marrë.
xs=0
ys=0
for i=1:1:Max
   for j=1:1:Max
      if(i==j)
      d(i,j)=0
      else
         xs=(n(i,1)-n(j,1))*(n(i,1)-n(j,1))
         ys=(n(i,2)-n(j,2))*(n(i,2)-n(j,2))
         d(i,j)=sqrt(xs+ys)
      end
         end
end
%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%
%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%%
 path=RREQ.Src;
current=RREQ.Src;
INF=999999999999999
small=INF
```

```
tmp=0;
while current~=RREQ.Dst
      for i=1:1:Max
       if current~=i
         if( d(current,i)<small)
           k=ismember(path,i);
           k=find(k);
           if(k)
             disp 'hi'
           else
           small=d(current,i)
           tmp=i;
           end
         end
      end
  end
   current=tmp;
   path=[path current]
   small=INF
   end
disp 'loop ends'
path
 sz=size(path)
sz=sz(:,2)
x1=n(path(1),1)
rows=x1
   x2=n(path(1),2)
 col=x2
for i=2:1:sz
```

```
    x1=n(path(i),1)
 rows=[rows  ;x1]
    x2=n(path(i),2)
    col=[col;x2]
  end
 x=[rows col]
  plot(x(:,1),x(:,2))
   r=randperm(100);
  for j=1:1:4
    node(j).es=r(j);
 end
 A=[20,60,100,120,160,200,250,300]
  for i=1:1:8
   thrput(1,i)=performance(A(1,i),node,d,Max);
  end
 figure()
 plot(A, thrput)
```

Sipas këtij algoritmi:

- pasi vendoset vlera për variablin max (që nënkupton maksimumin e nr. të nyjeve),
- proçesohet një mesazh RREQ

  RREQ.Src- kërkesë burimi(request source)

  RREQ.Dst –kërkesë destinacioni (request destination)

- njihen fushat për RREQ:
- më pas të gjitha nyjet gjenerojnë një paketë 'Hello(Hi)'në kohën e startimit.
- kur merren nga destinacioni llogaritet koha, përftohet distanca.
- xs dhe ys, vlerat që do të mbajne këto dy variabla përfaqësojnë koordinatat e nyjes dhe ndihmojnë në llogaritjen e distancës 'd', d(i,j)= sqrt(xs+ys).

Tabela përmbledhës e paraqitur më poshtë paraqet dhe shpjegon disa parametra, që bëjnë pjesë në këtë algoritëm rutimi:

Tabela 3.4. Parametrat e Simulimit për protokollin AODV

Parametrat e Simulimit	
Routimi	AODV
MATLAB	7.10.0(R2010a)
xs, ys	koordinatat per nyjen sipas boshteve
d-distanca	d(i,j)= sqrt(xs+ys)
A[ ]	[20,60,100,120,200,250,300]
Max(nr e nyjeve)	9, 10, 15, 20,,25,30,35,40,45,50,60,70, 80, 90
Hapsira e simulimit	100 x 100
Thrput	r=randperm(100)
Threshold	15

Më poshtë, nga 14 matjet e kryera janë paraqitur vetëm 4, mjaftueshëm për të parë sesi ndryshon performanca dhe koha me rritjen e nr. të nyjeve.

[throuput] = performance/xhirot

[threshold]= prag/kufi

Matja 1: max= 9nyje, t = 2 sec - midis thruput dhe threshold





Matja 2: max= 10 nyje, t =30sec





Matja e 7: max =50, t = 2min e 30 sec





Matja 12; max =90, t = 4min





Siç shihet me rritjen e numrit të nyjeve rritet edhe koha e performancës pra nga një thruput në një threshold dhe një numër i madh nyjesh nuk kanë një fqinjësi, ngelen të pambuluara. Deri tek matja 7 me max= 50 duket se është optimaliteti. Kjo dhe për faktin se n.q.s ne i referohemi metodologjisë kërkimore, paraqitur më lartë, për topologjinë e rrjetit, rrjeti ynë ka një topologji të rregullt kur max=50nyje.

Vërehet se për nr. nyjesh të =10 ose më të vogël se 10, sigurisht koha nga një thruput në një threshold është e vogël dhe topolgjia pak a shumë është e rregullt, por numri i nyjeve që nuk komunikojnë me njëra –tjetrën është më i madh ose mbulimi i rrjetit më i vogël.

2.3.3. Implementimi dhe Performanca e Protokollit AODV dhe DSDV me anë të simulimeve në DARS simulator

- DARS është projektuar për të lehtësuar kuptimin e Rrjetave Mobile Ad-hoc.
- I lejon përdoruesit të kryejnë skenare/plane të ndryshme, të zbatojnë protokolle të ndryshme të komunikimit dhe të studiojnë sjelljen e rrjetit.
- Ai shpjegon funksionimin e dy protokolleve të ndryshme AODV dhe DSDV në një mjedis miqësore dhe interaktive shumë përdorues.
- Simulatori jep të dyja edhe paraqitjen tekstuale dhe grafike të simulimit të rrugëtimit.
- Qëllimet kryesore të DARS konsistojnë në tre pjesë:
    1. Krijmin e një plani tërheqës dhe miqësor me përdoruesin.

2. Aftësinë për të aplikuar protokolle të ndryshme për një skenar/plan.
3. Mban/ruan gjurmët e ngjarjeve të rrjetit dhe t'i shfaq ato për përdoruesit.

DARS është projektuar të pranojë lehtësisht shtimin e protokolleve të reja te rutimit.

Shtimi i një protokolli mund të ndahet në tre hapa të mëdha:

- Freskimi i NodeFactory
- Zgjerimi i Klasës së Nyjeve
- Krijimi i një Kutize Dialogu të Protokollit

Freskimi i NodeFactory

- Fresko dars/proto/NodeFactory.java

Hapi 1: Shto një deklaratë të importit për klasë të re protokolli

import dars.proto.newproto.NewProto;

Hapi 2: Shto emrin e protokollit në renditjen NodeType.

public enum NodeType f AODV, DSDV, NewProto g;

Hapi 3: Trajtohen kërkesat e reja te nyjes për llojin e ri të protokollit. Shto një case te deklarata e radhës. Rasti i ri duhet të thërrasi ndërtuesin për protokollin. Ndërtuesi duhet të pranojë një argument të vetëm të tipit atribut i Nyjes. Ky konstruktor kërkohet si pjesë e klasës bazë abstrakte të nyjes. rasti NewProtoName : kthe NewProto(na); ?

Zgjerimi i Klasës Nyje

Klasa Nyje kërkon që një protokoll i ri të zbatojë gjashtë funksione. Zbatimi i protokollit mund të mos thërras asnjë nga këto funksione. Këto funksione po i paraqesim më poshtë:

1. messageToNetwork - Ky funksion është përdorur për të kthyer një mesazh off, radhën e transmetimit të një nyje dhe do ta kthejë ate për motor simulimi për tu konsumuar.

2. messageToNode - Ky funksion është përdorur për të dhënë një mesazh në një nyje. Mesazhi do të vendoset në nyje të fituara nga radhë efektike, nyja është duke marrë mesazhin.
3. newNarrativeMessage - Dërgo mesazh përshkrues nga një nyje në një tjetër.
4. clockTick - Procesi i një përsëritje të kësaj nyje. Ky do të bëjë të gjithë përpunimin për interval kohor të një nyje.
5. getNodeDialog - Kthim i një JDialog që do të shfaqet nga GUI.
6. updateNodeDialog - Përditësimi i JDialog i kthyer më parë me informacionin e fundit për një nyje që do të tregohet tek GUI.

Krijimi i një Protocol Dialog Box

- Çdo protokoll duhet të sigurojë një dialog box[43] që mund të shfaqet tek përdoruesi, që tregonë informacion në lidhje me një nyje të caktuar tek përdoruesi.
- Ky dialog duhet të zgjerojë klasen standarde JDialog.
- Zbatimi dhe dizajni i Protocol Dialog box i është lënë zhvilluesit i cili po zbaton protokollin.



Figura 3.12. Arkitektura e DARS

[43] Kuti dialogu

Për të gjitha nyjet ne mund të marrin nga simulatori këto atribute: DEST,# HOPS, NXT HOP, SEQ#, INST TI.., siç tregohen edhe në figurën më poshtë:

DEST	# HOPS	NXT HOP	SEQ #	INST TI...
AA	3	AQ	159	192
AB	4	AF	160	192
AC	4	AF	147	192
AD	3	AQ	141	192
AE	4	AF	170	192
AF	1	AF	169	192
AG	1	AG	127	192
AH	2	AQ	45	184
AI	2	BR	36	192

Figura 3.13 Parametra të Simulatorit

Matjet: Ndër matjet e kryera kemi paraqitur vetëm një pjesë prej tyre dhe për çdo matje është figura përkatëse. Matjet janë kryer për të dy protokollet AODV(Source –Initiated On –Demand) dhe DSDV (Table-Driven).

Matje 1. Numri i nyjeve = 15nyje, AODV

Matje 2. Numri i nyjeve = 35nyje, AODV



Matje 3. Numri i nyjeve = 50nyje, AODV



Matje 1. Numri i nyjeve = 15nyje, DSDV



Matje 2. Numri i nyjeve = 35nyje, DSDV



Matje 3. Numri i nyjeve = 50 node, DSDV



Gjatë këtyre simulimeve ne vërejtëm se kur numri i nyjeve rritej dhe në mënyrë konseguente distanca ndërmjet tyre ngushtohet kemi një përmirësim të komunikimit dhe një transmetim të sukseshëm të mesazhit.

3.4 Aplikueshmëria dhe Konkluzione

3.4.1 APLIKUESHMËRIA

Përparimi i shpejtë teknologjik në komunikimin e bazuar navigacional dhe hapsinor, kombinuar me karakteristikat rregullatore në rritje, si dhe presoni për të ulur sa më shumë rreziqet dhe koston përfaqësojnë mundësi të reja.

Niveli i lartë i sigurisë është një shqetësim i vazhdueshëm dhe në rritje. Aktiviteti detar i qëndrueshëm është vital për rritjen e sigurisë dhe ekonomisë botërore.

Duke u bazuar në karakteristikat e komunikimit mobile ad-hoc mund të themi se shërbimet e navigimit në rastet e emergjencës janë një aplikim i rëndësishëm i rrjeteve sensor dhe ad-hoc wireless për shpëtimin dhe sigurimin e jetës së njerëzve. Këto rrjete mund të gjejnë aplikueshmëri edhe në Shqipëri, me anë të protokolleve të përshtatshme rutimi mund të rritimin efektshërinë në komunikimin mjet me mjet dhe sidomos në komunikimet

navigacionale, p.sh anije me anije, ku ka nevojë për rrjetat wireless pa infrastrukturë mbështetëse.

Disa fusha ku mund të aplikohen këto protokolle:

- Ushtri – sistemet e luftimit, te mbikqyrjes(survejimit), zbulim.
- Menaxhimin e fatkeqesive
- Emergjencat mjeksore
- Navigim
- Edukim distance

Po kështu në këtë çështje u fol gjatë edhe për protokollin e rutimit AODV routing i cili është disenjuar për rrjetat mobile ad hoc wireless. Ky protokoll AODV mund të trajtojë norma të ulëta, të moderuara, dhe relativisht lëvizshmëri të lartë. AODV është projektuar për përdorim në rrjeta ku nyjet mund të besojnë njëri-tjetrit. AODV është disenjuar për të reduktuar përhapjen e kontrollit të trafikut dhe për të eleminuar të dhënat që e ngarkojnë trafikun

3.5 KONKLUZIONE

- Komunikimi efektive ndërmjet mjeteve rritet duke përdorur protokolle efektive rutimi.
- Një algoritëm i mirë rutimi mund të shmang bllokimin e trafikut mbi të gjitha linjat.
- Le të themi se rrjetat ad hoc janë të mirë- krijuar si një zonë praktike kërkimore. Kanë shumë aplikueshmëri.
- Një protokoll On-demand ofron shumë avantazhe
- AODV i përdor avantazhet si tek Distance-Vector dhe në On-demand
- AODV ka shance të mira për standartizimin.
- Rrjetat Ad hoc mund të vendosen në Internet dhe më pas të sigurojnë domain_et wireles. Teknikat e autokonfigurimit të addresave janë mirë-përshtatur.

KAPITULLI IV: PROPOZIMI I PROTOKOLLIT InterNavCom. SIMULIMET

4.1 Hyrje

Në këtë punim, ashtu siç theksuar edhe më parë, kemi menduar të prezantojmë një algoritëm rutimi, i cili merr në konsideratë problemet që lidhen me thithjen dhe shpërndarjen e mesazheve me anën e sinjaleve wireless, praninë e zonave 'gri', hazardet, në të cilat përjetohen pritje të rëndësishme, të ndryshueshme dhe të paqëndrueshme me kalimin e kohës dhe deri në rrezikun e dështimit të transmetimit. Ky algoritëm rutimi bazohet në një guidë të sigurtë për njerëzit për të realizuar një dalje të shpejtë nga zona e rrezik.

Kjo temë fokusohet në mundësimin dhe optimizmin e komunikimit ndërmjet nyjeve të një rrjeti ad-hoc që modelon rrjetin e komunikimit ndërmjet anijeve në port ose zonave përreth. Përdorimi i protokollit InterNavComm që merr në konsideratë të gjitha detajet specifike të komunikimit mes anijeve do të prezantojë një komunikim të shpejtë dhe efiçent.

Qëllimi *është që shpërndarja ose dorëzimi i mesazheve apo emergjencave të navigimit të bëhet në kohën e duhur, duke përdorur sa më pak burime te rrjetit dhe në kohën më të shkurtër të mundshme.*

Hipoteza: *Rritja e efektivitetit, disponibilitetit dhe sigurisë në protokollet ad-hoc inter-navale është një domosdoshmëri. Protokolli i ri InterNavComm është një protokoll i ri që siguron komunikim të vazhdueshëm dhe të sigurtë ndërmjet anijeve edhe në rastet e mungesës së infrastrukurës.*

Në portet shqiptare ngrihet nevoja e krijimit të aplikimeve të reja dhe të besueshme. Implementimi i protokollit InterNavComm edhe në portin e Vlorës do të ndihmonte në plotësimin e mangësive ekzistuese sidomos në zona me mungesë mbulimi valor.

Pyetja kërkimore: *Duke u nisur nga qëllimi që duam të arrijmë: A është me të vërtetë efiçent përdorimi i protokollit* InterNavComm *të rutimit për rrjetat ad-hoc wireless në navigacion, në komunikimin pikë më pikë/ anije me anije?*

- Si do të bëhet modelimi i rrjetit të kompjuterave në një rrjet wireless ad-hoc?
- Cilët janë protokollet dhe strukturat ekzistues të komunikimit internaval në botë?
- Po në Shqipëri, veçanërisht në Vlorë?
- Cilat janë specifikat e dallimit të rrjetit të anijeve nga rrjeti i makinave në rastin e inter-vehicle communications,etj.
- Cilat do të ishin përdorimet e një protokolli të veçantë për komunikimet naval
- A ekziston një përfitim qualitativ në përdorimin e këtij protokolli?
- Si do te përcaktohet vendodhja e çdo anije në çdo cast të kohës?
- Pse zgjedh simulatorin NS2?
- Në cilat kushte supozohet të realizohen simulimet?

Ideja kryesore: në protokollin InterNavComm është krijimi i një infrastrukture virtuale të përbërë nga qeliza me dimensione të caktuara(300-400m) dhe për çdo qelizë zgjidhet një anije që të shërbejë si qendër komunikimi për anijet e tjera në atë zonë. Kjo do të jetë baza e strukturës hierarkike të rrjetit ad-hoc të krijuar për anijet.

Ne i konsiderojmë anijet si nyje të një rrjeti ad-hoc, të ndarë në qeliza virtuale që formojnë infrastrukturën virtuale specifike për këtë protokoll. Nyjet në një sipërfaqe të madhe, që mund të përfaqësojë sipërfaqen e zonës rreth portit, janë organizuar në dy nivele të hierarkisë. Çdo nyje ka pozicionin gjeografik të dhënë nga GPS.

Në nivelin e parë janë përfshirë të gjitha nyjet në një qelizë. Këto nyje komunikojnë me njëra-tjetrën dhe ato gjithashtu mund të komunikojnë me nyjet e qelizave respektive fqinjë, të cilat janë në një fushë ose linjë komunikimi.



Figura 4.1. Komunikimi hierarkik i nyjeve në një rrjet ad- hoc

Niveli i dyte hierarkik është i përfaqësuar nga ato që i quajme Qendra_Qelizë(Cel_Center-CC), të cilat janë një grup i vogël nyjesh të vendosura afër qendrës gjeografike të çdo qelizë. Qendra_Qelizë mund të komunikojë me antarët e qelizave respektive ose antarët e qelizave fqinjë që janë në një linjë komunikimi me CC. Komunikimi ndërmjet nyjeve të një qelize me atë të CC respektive përfaqëson komunikimin e nivelit te dytë të hierarkisë me nivelin e parë.

Komunikimi ndërmjet anëtarëve në nivel të dytë të hierarkisë përfaqësohet nga komunikimi midis Qendra_Qelizë. Kjo është e mjaftueshme që ato të komunikojnë në mënyrë sekuenciale njëra pas tjetrës kështu që çdo Qendër_Qelizë mund të komunikojë me njërën nga CC fqinjë. Qendrat_Qelizë fqinje sillen si pjesë e zinxhirit që lidh qendrën aktuale(korente) me gjithë gjatësinë e rrugës në tërësi. Ne mendojmë apo supozojmë se CC_at kanë një rang transmetimi të tillë që të mund të mbulojnë prezencën e vrimave që mund të krijohen midis qelizave.

Është e rëndësishme të theksohet se pozicioni i CC optimizon(përmirëson) komunikimin brenda qelizës dhe me qelizat fqinjë, duke mundësuar që të ketë cilësi të ngjashme transmetimi thuajse me të gjithë antarët e qelizës.Përveç kësaj, çdo CC mban pothuajse një cilësi simetrike në komunikimin me qendrat fqinjë(më të afërta), duke siguruar kështu një barazpeshë ose cilësi të ekuilibruar për të dy drejtimet e lëvizjes së informacionit. Pra

kërkesa e vetme për të qenë një CC është që të jetë në një linjë komunikimi me antarët Qelizë. Në këtë filozofi dhe këndvështrim do të vazhdoj të shtrihet studimi im.

Supozohet se një mesazh emergjence duhet të transmetojë ose shpërndahet menjëherë dhe në numër minimal hopesh ky mesazh duhet të merret nga të gjitha nyjet. P.sh në rastin e përmbytjes(flooding) do të kishim një mbingarkim të rrjetit duke rezultuar në humbje të sinjalit dhe vonesa në komunikim. Duke përdorur këtë infrastrukturë virtuale, pra protokollin InterNavComm, ngarkesa e rrjetit bie ndjeshëm, bëhet broadcast vetëm te liderat e qelizës dhe këta të fundit te çdo anije në veçanti.

4.2 Implementimi NS2dhe Vlerësimi i Protokollit InterNavComm me Anë te Simulatorit

4.2.1 Protokolli i Propozuar dhe Transmetimi në Rrjetin e Gjerë.

Në pjesën më të madhe të protokolleve të rutimit të zhvilluara për rrjetet ad-hoc wireless, performanca e transemtimit në rrjet nuk është e kënaqshme edhe për shkak se pjesa më e madhe e këtyre protokolleve bazohen mbi flooding. Duke përdorur këtë teknikë, rrjedhimisht këto protokolle nuk mund të kenë peformancën e duhur në komunikimet pikë me pikë dhe në situatat e emergjencës. Kështu, në mënyrë që të përmirësojmë cilësinë e komunikimeve pikë me pikë, ne propozuam në këtë punim një protokoll të ri, protokollin InterNavComm që ka një strukturë hierarkike.

Ne supozuam se varkat lëvizin në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtën hapsirë gjeografike, ku secila varkë njeh pozicionin dhe destinacioni e vet duke përdorur GPS, kanë fuqi optimale për transmetim, dhe ekziston një protokoll i tillë që secila nyje të transmetojë pa interferenca, ky është protokolli MAC(Medium Access Controll). Gjithashtu ne supozuam që kjo hapsirë është ndarë në qeliza virtuale duke patur të njëjtën gjatësi optimale të barabartë, gjatësi që mund të lejojë transmetim dhe marrje optimale të mesazheve. Për të tilla raste një zgjedhje e mirë do të ishte IEEE802.11(kemi folur në kapitujt më sipër) si dhe gjithshtu përzgjedhja e gjatësisë së qelizës të jetë midis 300-400m.

Në figurën 4.2 është ilustruar koncepti i GPS dhe rrjetit sensor ad-hoc wireless për marinën, në një hartë të vendit tonë, Shqipërisë mbi veprimin e varkave të vogla për peshkim si nyje

transmetimi/rele. Si dhe kombinimin e veprimit Ruter +Antenë + GPS, si dhe ndërveprimin me protokollin tonë të rutimit InterNavComm.

Aplikacionet e Monitorim, Kërkim dhe Shpëtimit (MSnR), veprohet si më poshtë: Lidhja përpara nga toka në det (shigjeta e kuqe në Fig. 4.2) përdor sistemin aktual radio me fuqi të lartë stacion - bazë përgjatë vijës bregdetare për të transmetuar motin dhe informacione të rëndësishme për të gjitha anijet e peshkimit.



Figura 4.2. Ilustrimi i konceptit GPS dhe rrjetit sensor ad-hoc wireless për marinën, në një hartë të Shqipërisë

Në këtë studim, është spërzgjedhur frekuenca Tx/Rx i 8.294 MHz [44] (sipas spektrit elektromagnetik fig.4.3). Për shkak se antenat transmetuese janë të montuar në stacione-bazë në një lartësi tipike prej 100 metra dhe një fuqi e lartë është në dispozicion, kjo lidhje

[44] ISM/SRD License-Free Frequency Bands

përpara mund të arrijë të gjitha anijet e peshkimit në horizont. Në kontrast me lidhjen përpara, lidhja e kthimit nga deti në tokë (shigjetat blu në Fig.4.2) është i kufizuar nga fuqia e ulët dhe lartësia e antenës e instaluar në të gjitha anije e vogla të peshkimit. Ky problem rregullohet nga ***rrjeti sensor wireless ad hoc***, i cili lejon lidhjen e kthimit që do të krijohet për herë të parë ndërmjet të gjitha anijeve të peshkimit dhe të lidhur nga anijet më të afërt të stacioneve-bazë qëndrore.



Figura 4.3. Spektri elektromagnetik(Texas instrument Inc, 2006)

Përshkrimi i Përgjithshëm i Strukturës

Ndajmë zonën më të afërt bregdetare në qeliza virtuale që përmbajnë nyje të një rrjeti ad hoc, ku si të tilla merren anijet, varkat etj. Këto qeliza lëvizin së bashku me shumicën e nyjeve të tyre. Prandaj, një infrastrukturë fleksibël virtuale është krijuar dhe mirëmbahet për të mundësuar komunikim të shkallëzuar dhe efektiv. Në çdo qelizë kemi zgjedhur një ose më shumë qendra qelizë (CC-Cell Center).

Në nivelin e parë hierarkik janë përfshirë të gjitha nyjet në një qelizë. Këto nyje komunikojnë me njëra-tjetrën dhe gjithashtu mund të komunikojnë edhe me nyjet respektive fqinje që janë në rangun e komunikimit.

Niveli i dytë i hierarkisë përfaqësohet CC që siç e kam theksuar më lartë janë një grup i vogël nyjesh të vendosura zakonisht afër qendës gjeografike të qelizës. CC mund të komunikojnë me antarët e qelizave fqinje që janë në të njëjtin rang komunikimi të CC. Dhe komunikimi midis nyjeve të një qelize me CC_at respektive përfaqëson komunikimin e nivelit të dytë të hierarkisë me nivelin e parë. Komunikim është në mënyrë sekuenciale kështu që çdo CC mund të komunikojë me CC_at fqinjë. Pozicioni i CC_ve optimizon komunikimin brenda qelizës dhe me qelizat fqinje. Çdo CC mban pothuajse një cilësi/kualitet simetrik në komunikimin me qendrat fqinje, duke siguruar cilësi të balancuar për të dy drejtimet e lëvizjes së informacionit.

Figura 4.4. Struktura hierarkike në proçesin e rutimit. Zona afër portit Vlorë

Struktura hierarkike mundëson optimizimin e procesit të rutimit. Zona e portit është e ndarë në qeliza virtuale, të cilat lëvizin siç lëvizin nyjet, fig.4.4.

Çdo qelizë ka një qendër, e cila është zgjedhur nga anëtarët e qelizave dhe është e vendosur afërsisht në qendër gjeografike të qelizës. Në një normë të caktuar çdo nyjë përditëson të dhënat nga GPS, e cila jep koordinatat (x, y) për çdo nyje në një moment të caktuar.

Anëtarët qelizë zgjedhin një qendër që do të sillet për një interval të caktuar kohor, si një stacion bazë(BS). Çdo nyjë ka pozicionin e saj gjeografik të dhënë nga Global Positioning System (GPS).

Kur një nyje burim ka një mesazh për një nyje destinacion, ia dërgon atë në Cell Center_in e saj. Atëherë mesazhi është përcjellë përmes Qendrave të tjerë Cell. Cell Center së pari verifikon nëse nyja destinacion i përket qelizës së tyre. Së fundi Cell Center destinacion do ta dërgoje mesazhin tek nyja destinacion.

Niveli i tretë përfaqësuar nga NC(Network Centers[45]) të cilat janë një grup i vogël nyjesh të lidhura afër qendrës gjeografike të rrjetit. NC mbajnë të update_uar informacionin e vendodhjes për të gjitha nyjet në rrjet duke siguruar informacionin për CC.

Llogaritja e Kompleksiteti të Komunikimit dhe Kohës për algoritmin tonë të rutimit*:*

Nëse dy nyje në rrjet komunikojnë me njëri-tjetrin, atëherë ne duhet të llogarisim *kompleksitetin e komunikimit* ndërmjet tyre duke përdorur bazën matematikore. Kompleksiteti i Komunikimi është një masë asimptotike e numrit të mesazheve të dërguara në rrjetin gjatë shtrirjes kohore të algoritmit. Për shembull, në qoftë se unë kam një rrjet të plotë (dmth, një grafik të plotë), dhe algoritmi me dërgon të gjithë fqinjët e mi, pastaj algoritmi përfundon mbi secilin procesor, numri i mesazheve të dërguar është n (n-1) i cili është në O (n ^ 2).

Kompleksiteti i kohës së një algoritmi vlerëson sasinë e kohës që një algoritmi i duhet për të vepruar/ekzekutuar në funksion të madhësisë së input_it të problemit. Kompleksiteti i kohës së një algoritmi zakonisht shprehet duke përdorur simbolin O. Ku simboli O është një kufi i sipërm, që shpreh kohën më të keqe të nevojshme në të cilin vepron një algoritëm për inputet e ndryshme. Megjithëse, disa inpute mund ta lejojnë algoritmin të veprojë/ekzekutojë më shpejt.

Transmetimi i rrjetit të gjerë është një tipar thelbësor për rrjetet pa tel. Metoda më e thjeshtë për shërbimin e transmetimit është përmbytja/flooding. Ndër përparësitë e saj është

[45] Qendrat e rrjetit

thjeshtësia, megjithatë, për një transmetim të vetëm, përmbytja gjeneron ritransmetime të bollshme që ndikojnë në fuqinë e baterisë dhe humbje të bandwidth. Gjithashtu, ritransmetimet e nyjeve të afërta kanë gjasë të ndodhin në të njëjtën kohë. Si rezultat, flooding shpejt çon në përplasje mesazh dhe zënie kanali. Ky është i njohur si problemi stuhi transmetimi. Për shkak të disa karakteristikave qenësore të përbashkëta ndërmjet rrjeteve sensor dhe rrjeteve Mobile ad hoc (MANETs) të gjithë protokollet e transmetimit të propozuara për MANETs mund të zgjerohen për rrjetet sensor. Problemi i transmetimit është studiuar gjerësisht për rrjetet multihop. Zgjidhjet optimale për të llogaritur Minimum Connection Domination Set (MCDS) janë marrë për rastin kur çdo nyje e di topologjinë e të gjithë rrjetit (transmetimit centralizuar). Protokolli i transmetimit përfundon transmetimin e një mesazhi në O (Dlog2n) hapa, ku 'D' është diametri i rrjetit dhe 'n' është numri i nyjeve në rrjet. Nga rezultatet, ky protokoll është optimal për rrjetet me diametër konstant. Për rrjetet me një diametër më të madh, një protokoll nga Gaber et al e përfundon transmetimin brenda O (D +) log5n time slots[46], dhe kjo është optimale për rrjetet me D ∈ (log5n). Këto zgjidhje janë përcaktuese dhe garantojnë një vonesë kufizuese në shpërndarjen e mesazhit, por kërkesa që secila nyje duhet të dijë të gjithë topologjinë e rrjeti është një kusht i fortë, jopraktik për tu mbajtur në rrjetet wireless.

Përsa i përket algoritmit tonë të rutimit, proçedura e përcjelljes së mesazhit nga një burim S në një destinacion D jepet në mënyrë skematike në figurën 4.5, ku CC përcaktohen si BS(Stacione Bazë) sepse ato luajnë rolin e stacioneve bazë virtuale.

[46] Time slot është një koncept në rrjetet kompjuterike. Ky është të paktën dyfishi i kohës që duhet për një impuls elektronik (OSI Shtresa 1 - Fizike) për të 'udhëtuar' në gjatësinë e distancës maksimale teorike midis dy nyjeve



Figura 4.5. Skematizimi i përcjelljes së mesazhit duke përdorur qendrat virtuale.

Në situata të veçanta ku burimi S 'është i vendosur në rangun e komunikimit të CCi + 1 dhe kjo është edhe më afër destinacionit sesa CCi, mesazhi do të përcillet direkt me CCi +1.

Një situatë e ngjashme ndodh kur destinacion D është në rangun e komunikimit te BS të mëparshëm. Mesazhi është përcjellë drejtpërdrejt nga CCd-1 tek D (CCd është CC për destinacionin D). Numri maksimal i hop_eve në nyjen destinacion është **(L + 2),** ku L është numri i hop_eve ndërmjet CCs. Për një rrugë të drejtë, L zakonisht paraqet diferencën në treguesit CCs . Skematikat përjellëse tek figura 4.5. përdorin CCs virtuale. Tabela kurs hyrëse janë krijuar gjatë shkëmbimit të parë të mesazhit "hello" dhe janë përditësuar më pas në çdo interval update_uar. Madhësia e tabelës së rutimit është minimale dhe është i harmonishëm/ akordueshëm në kuptimin që për trafik të lartë dhe densitet të nyjeve të lartë një gjatësi qelizë më e vogël përdoret. Nëse numri i nyjeve në një qelizë është n, rendi në tabelën e rutimit është O (n). Kur tabela e kursit zgjerohet për të përfshirë hyrjet për të gjitha nyjet në rangun e komunikimit, rendi është O (2 n), (duke pasur parasysh një shpërndarje afërsisht uniforme të nyjeve).

4.2.2 Hapat për ndërtimin e Algoritmit.

Protokolli i propozuar: InterNavComm, komponentet e protokollit tonë:

- ***Krijimi Struktures***. Algoritmi fillon me krijimin e infrastrukturës virtuale. Nyjet e së njëjtës qelizë ose e qelizave fqinje, që janë brenda rrezes së komunikimit shkëmbejnë mesazhin fillestar "Përshëndetje". Si rezultat çdo nyjë e di pozicionin e të gjitha nyjeve që mund të komunikojnë me të. Në mënyrë që të kemi të dhënat e fundit, pozita e çdo nyje është përditësuar periodikisht duke shkëmbyer mesazhe "Hello". Në protokollin

tonë procesi i update është njësoj si i rutimit gjeografik ndërkohë që nyjet lëvizin në të njëjtin drejtim dhe afërsisht me të njëjtën shpejtësi mesatare në vijë të drejtë. Intervali i update_imit varet nga lëvizshmëria e nyjes, nëse kjo lëvizshmëri është e lartë nevojitet një interval i shkurtër update.

Të gjitha nyjet vendosin/ krijojnë antarët qelizë duke patur parasysh që të kenë një distancë të shumëfishuar me 400m. Shënojmë me X_0 dhe Y_0 koordinatat e kufirit të qelizës së parë. Në çdo qelizë secila nyje shkëmbenë mesazhin *Hello* duke përfshirë: koordinatat e nyjes së parë, pozicionin korent të nyjes, shpejtësinë aktuale, numrin aktual të qelizave.

Numri aktual i qelizave llogaritet si:

$$Numer\_Qelizave = \left\lfloor \frac{D}{400} \right\rfloor$$

$$D = mod400\sqrt{(my\_X - X_0)^2 + (my\_Y - Y_0)^2}$$

ku D-distanca euklidiane midis nyjes me koordinata $(my\_X; my\_Y)$ dhe kufirit të qelizës së parë. Për një performancë më të mirë, mesazhet *Hello* shkëmbehen midis nyjeve të afërta që i pëkasin nyjeve fqinje.(M.Durresi, 2005 IEEE)

- ***Përzgjedhja e Qendrës_Qelizë***. Anëtarë të së njëjtës qendër_qelizë marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes së Cell Center_ve përkatëse. Qendra Cell janë vetë zgjedhur si nyje duke qenë në një gamë të caktuar minimale në afërsi të qendrës së qelizës dhe duke pasur cilësi të mirë të pritjes sinjal.

  - Procesi i numërimit të qelizave: Gjatë këtij proçesi së pari çdo anije merr nga GPS informacionin mbi pozicionin e koordinatave x dhe y. Anija e parë që nuk arrin qelizat e tjera konsiderohet si qeliza pikënisëse ose me kufi 0 që transmeton, me koordinata (X_0, Y_0). Kjo qelizë ia transmeton pozicionin dhe informacionin e vet të gjitha nyjeve që janë brenda rangut të komunikimit. Të gjitha nyjet brenda këtij rangu komunikimi vendosin/krijojnë automatikisht antarët qelizë respektiv dhe i deklarojnë ato tek të gjitha nyjet në qelizë duke shkëmbyer mesazhet “Hello“ duke

përfshirë: ID e nyjes; koordinatat X_0, Y_0; pozicionin e nyjes korente; shpejtësia korente dhe numri aktual i qelizave. (M.Durresi, 2005 IEEE)

Procesi i numërimit të qelizave ilustrohet me anë të figurës më poshtë:



Figurë 4.6. Proçesi i numërimit të qelizave në vijë të drejtë

- ***Komunikimi Pikë-me-pikë*** **.** Ky algoritmi përcakton veprimin e nyjeve dhe CC_at për komunikimet burim-destinacion. (M.Durresi, 2005 IEEE)

1. nyjet burim përfshihen në qelizën *i*:
   - kontrollo drejtimin e komunikimit me destinacionin nëse distanca është:

$$d = \sqrt{(X_d - X_s)^2 + (Y_d - Y_s)^2}$$

2. përndryshe përcill mesazhin tek qendër_qeliza e vet ose në stacionin baze(BS) të tij, pasi vet CC mund ti konsiderojme si BS. Pas marrjes së mesazhit BS e dërgon atë tek BS($X_{\_bs}$,$Y_{\_bs}$) që është afër destinacionit. Stacioni bazë më i afërt do të ketë distancën minimale për në destinacion (*d_BS_min*) të llogaritur më poshtë:

$$d\_BS\_min = min\sqrt{(X_{bs} - X_d)^2 + (Y_{bs} - Y_d)^2}$$

3. Pas marrjes së një mesazhi të ri një qendër BS, së pari kontrollon në tabelën e tij të rutimit nëse destinacioni është një antarë e kësaj qelize. Nëse jo ai vazhdon proçesin përpara tek qendrat e tjera duke aplikuar të njëjtin algoritëm në mënyrë që mesazhi të shkojë përpara në destinacion. Nyja burim menjëherë transmeton mesazhin tek të gjitha nyjet në qelizën ku bën pjesë. Më pas qeliza BS_{ij}, ku bën pjesë kjo nyje, e dërgon mesazhin, duke u bazuar në politikat e veta, tek qendrat e tjera fqinje. Çdo qendër tjetër e transmeton këtë mesazh duke ndjekur një politikë skedulimi si në figurën 4.6. Në një numër minimal hope_sh destinacioni

merr mesazhin. Transmetim i komunikimit mund të bëhet i nevojshëm sidomos në rastet e emergjencës.

- ***Transmetim i Komunikimit***. Algoritmi përcakton veprimin për nje komunikim te pjesshëm ose të plotë të transmetuar në rrjet. Struktura hierarkike e protokollit është veçanërisht e përshtatshme për komunikimet elektronike.



Figura 4.7. Bllok-skemë e thjeshtë për marrjen dhe transmetimin e të dhënave në rrjet

4.2.3 Vlerësimi I performancës së protokollit InterNavComm. Kodi dhe Rezultati nga Simulimet me Simulatorin NS2

Për të vlerësuar performancën e protokollit marrim parasysh 2 metrika:

Vonesa (End-to-End) Pikë me pikë, e matur ne ms. Kjo përdoret për shkëmbim informacionit ndërmjet burimeve dhe destinacioneve të ndryshme të marra rastësisht dhe që kanë distancë të ndryshme ndërmjet tyre. Sigurisht rezultatet varen nga ngarkesa e trafikut, shpeshtësia e mjeteve, ne kemi përdorur metrikun për distancë të normalizuar, figura

4.8.(kodi për end-to-end delay, është shfaqur dhe sqaruar tek pjesa e gjithë kodit të protokollit, si më poshtë)

Distance	RTT ms
100	2
200	2
300	2
400	2
500	3
600	3
700	3
800	4
900	4
1000	4
1100	5
1200	5
1300	6
1400	7
1500	8



Figura 4.8. Ku paraqitet vonesa pikë me pikë(end- to-end delay), shoqëruar me të dhënat në tabelë.

End-to-fund vonesa i referohet kohës që duhet marrë për një paket që do të transmetohet nëpër një rrjet nga burimi në destinacion. Ky është një term i zakonshëm në IP, dhe ndryshon nga koha vajtje-ardhjet, RTT(Round Trip Time).

Vonesa fund-me-fund është llogaritur ndërmjet dy pikave të sinkronizuara A dhe B të një rrjet IP, dhe se paraqet kohën që një paket kalon gjatë një udhëtimi përmes gjithë rrjetit IP nga A në B.

Paketat e transmetuara duhet të identifikohen në burim dhe destinacion në mënyrë për të shmangur humbjen e paketës apo riorganizimin e saj. Metoda e matjes bën të qartë se kjo vlerë është në thelb e ndryshme nga RTT/ 2 value.

dend-end= N[dtrans+dprop+dproc+dqueue]

ku:

$d_{end-end}$= end-to-end delay(vonesa fund me fund)

d_{trans}= transmission delay(vonesa e transmetimit)

d_{prop}= propagation delay(vonesa e përhapjes)

d_{proc}= processing delay(vonesa e proçesimit)

d_{queue}=Queuing delay(vonesa e radhitjes)

N= number of links (Number of routers - 1)(nr. i linke_ve)

Each router will have its own d_{trans}, d_{prop}, d_{proc} hence this formula gives a rough estimate.

Këto katër komponentë ndahen më tej:

1. Përpunimi nyje:
    - Kontrolloni gabimet të bit_it
    - Përcaktoni link_un e daljes
2. Radhitja:
    1. Koha duke pritur linkun e daljes për transmetim
    2. Varet nga niveli i ngjeshjes(kongjestionit) të ruterit
3. Vonesa e Transmetimit:
    1. R=Link bandwidth (bit/s)
    2. L=Packet length (bits)
    3. Time to send bits into link = L/R
4. Vonesa e Përhapjes:
    1. d = Length of physical link
    2. s = Propagation speed in medium

3. Propagation delay = d/s

Duke u nisur edhe nga të dhënat e paraqitura në tabelë dhe kurba e grafikut siç tregohet në figurën 4.9 ne krahasojmë end-to-end delay midis protokollit InterNavComm dhe Flooding(i jemi referuar grafikut të nxjerrë nga paper i M.Durresi, A.Durresi, L.Barolli, 2007 IEEE) për komunikime të ndryshme ndërmjet nyjeve me një distancë të dhënë siç është treguar në grafikun më lartë. Për nyje të afërta të dy së bashku protokolli InterNavComm dhe Flooding performojnë thuajse njësojë. Por vërejmë qartë se protokolli ynë InterNavComm është një protokoll i shkallëzueshëm(scalable), që performon shumë më mirë për nyje më në distancë, dhe me një vonesë pikë me pikë(end-to-end delay) më të vogël se Flooding. Kjo shpjegohet edhe me faktin se, në krahasim me flooding duke përdorur një skemë hierarkike edhe numri i mesazheve që do të shkëmbehet do të jetë i njëjtë me qelizat ndërmjet burimit dhe destinacionit plus 2(pra një komunikim midis nyjes burim dhe CC_it të tij më të afërt dhe CC_it të fundit tek destinacioni). Numri i mesazheve të shkëmbyera nga Flooding është më i lartë dhe numri i mesazheve të shkëmbyera rritet shumë shpejt me rritjen e nr. të nyjeve gjatë komunikimit. Në protokollin tonë të rutimit ky numër është më i vogël.

Ngarkim rutimi, i matur në bazë të numrit të mesazheve që transmetohen për çdo burim komunikimi në destinacion. Për të patur ide më të qarta, protokollin tonë të rutimit e krahasojmë me protokolle të tjera rutimi, p.sh me një protokoll të njohur të përdorur në rastin kur kemi vërshime ose e njohur ndryshe “përmbytje”.

Për të dy protokollet, krahasohet numri total i mesazheve të shkëmbyera ose ngarkim rutimi për çdo burim-destinacion dhe nxjerrim si përfundim se cili prej protokolleve, protokolli i paraqitur prej nesh paraqet performancën më të lartë.

Shumë protokolle rutimi të zhvilluar për rrjetet ad-hoc wireless janë modifikuar dhe adaptuar për përdorim në sistemet e transportit. Në pjesën më të madhe të këtyre protokolleve performanca nuk është e kënaqshme për shkak të rrugës proçesi i zbulimit i bazuar në përmbytjen(flooding) dhe si rrjedhojë këto lloj protokolle nuk mund të kenë

performancën e duhur për komunikimet pikë me pikë dhe në situatat e emergjencës. Për t'i ardhur në ndihmë kësaj situate ne propozojmë protokollin tonë të rutimit InterNavComm.

InterNavCom është një algoritëm jo-uniforme table-driven, me ndarje faktike të zonës dhe bazuar në kurs gjeografike. Ky protokoll bën më eficient përdorimin e burimeve dhe shmang proçesin e zbulimit të kursit (protokollet reaktive).

Supozime dhe modeli i Simulimit

Ne zbatojmë një skemë rutimi multihop ku simulatori i përdorur është NS2. Në këtë eksperiment apo simulimet tona supozojmë se rrjeti përbëhet nga afërsisht 50 nyje roaming në një hapësirë 1000x1000 metër. Zona roaming për rrjetin me madhësi 50, 200, 400 dhe 1000 është respektivisht 700x700, 1500x1500, 2000x2000 3000x3000 metër katror. Gama e transmetimit radio është 120 metra dhe kapaciteti i kanalit është 2Mbits/sec. Ne përdorim protokollin MAC IEEE 802.11 me Funksioni Shpërndarje Koordinimi (DCF) si shtresa MAC në eksperimentet tona.

Packet Delivery Ratio[47](PDR)

Packet Delivery Ratio është raporti i paketave të të dhënave të ofruara/shpërndara për destinacionet kundrejt paketave të të dhënave të rifituara/marra nga burimet. Ky numër paraqet efektivitetin e protokollit të rutimit.

- **Kodi për Simulimin e lëvizshmërisë së varkave.**

SIMULIMI i Protokollit ad-hoc tek Varkat në levizje:

 # Si fillim do të bëhet deklarimi i pjesëve përbërëse të tilla si: Lloji i kanalit te komunikimit; Lloji i ndërfaqeve të rrjetit; Shtresa e linkut, link layer type.....

```
set val(chan)        Channel/WirelessChannel        ;# Lloji i kanalit te komunikimit
set val(prop)        Propagation/TwoRayGround       ;# Modeli i radio-propagation
set val(netif)       Phy/WirelessPhy                ;# Lloji i nderfaqeve te rrjetit
```

[47] Raporti I dorëzimit të paketave

```
set val(mac)          Mac/802_11                    ;# Lloji i MAC (media access control)
set val(ifq)          Queue/DropTail/PriQueue       ;# interface queue type
set val(ll)           LL                            ;# Shtresa e linkut, link layer type
set val(ant)          Antenna/OmniAntenna           ;# Modeli i antenave
set val(ifqlen)       50              ;# Numri max i paketave ne ifq (interface priority queue)
set val(nn)           10              ;# numri i varkave ne levizje
set val(rp)           InterNavComm      ;# protokolli i rutimit
set val(x)            500             ;# Kordinatat/Dimesnionet ne rrafshin horizontal X
set val(y)            400             ;# Kordinatat/Dimesnionet ne rrafshin vertikal Y
set val(stop)         150             ;# Koha kur simulimi mbaron
set ns        [new Simulator]
set tracefd     [open test InterNavComm.tr w]
set windowVsTime2 [open win.tr w]
set namtrace    [open test InterNavComm.nam w]
$ns trace-all $tracefd
$ns namtrace-all-wireless $namtrace $val(x) $val(y)
# konfigurimi i vendodhjes se varkes
set topo      [new Topography]
$topo load_flatgrid $val(x) $val(y)
create-god $val(nn)
#
```

Pasi bëhet deklarimi i pjesëve përbërse, në vazhdim do të ndërtojmë kodin për krijimin e nn VARKA [$val(nn)] dhe më pas do ti lidhim ato në komunikim.

#

 # Konfigurimi i varkave

```
        $ns node-config -adhocRouting $val(rp) \
             -llType $val(ll) \
             -macType $val(mac) \
             -ifqType $val(ifq) \
             -ifqLen $val(ifqlen) \
             -antType $val(ant) \
             -propType $val(prop) \
             -phyType $val(netif) \
             -channelType $val(chan) \
             -topoInstance $topo \
             -agentTrace ON \
             -routerTrace ON \
             -macTrace OFF \
             -movementTrace ON
    for {set i 0} {$i < $val(nn) } { incr i } {
        set node_($i) [$ns node]
        $node_($i) set X_ [ expr 10+round(rand()*480) ]
        $node_($i) set Y_ [ expr 10+round(rand()*380) ]
        $node_($i) set Z_ 0.0
    }
    for {set i 0} {$i < $val(nn) } { incr i } {
        $ns at [ expr 15+round(rand()*60) ] "$node_($i) setdest [ expr 10+round(rand()*480) ]
[ expr 10+round(rand()*380) ] [ expr 2+round(rand()*15) ]"
```

}

 # Gjenerimi i lëvizjeve. Ku do të përcaktohen të gjitha lëvizjet ne rrjet me klasat IP dhe subnetet përkatëse

$ns at 10.0 "$node_(0) setdest 250.0 250.0 3.0"

$ns at 15.0 "$node_(1) setdest 45.0 285.0 5.0"

$ns at 70.0 "$node_(2) setdest 480.0 300.0 5.0"

$ns at 20.0 "$node_(3) setdest 200.0 200.0 5.0"

$ns at 25.0 "$node_(4) setdest 50.0 50.0 10.0"

$ns at 60.0 "$node_(5) setdest 150.0 70.0 2.0"

$ns at 90.0 "$node_(6) setdest 380.0 150.0 8.0"

$ns at 42.0 "$node_(7) setdest 200.0 100.0 15.0"

$ns at 55.0 "$node_(8) setdest 50.0 275.0 5.0"

$ns at 19.0 "$node_(9) setdest 250.0 250.0 7.0"

$ns at 90.0 "$node_(10) setdest 150.0 150.0 20.0"

 # Pikërisht në këtë pikë/pjesë të kodit simulohet ngritja e një lidhje TCP mes varkave 2 dhe 8 , me nje protokoll FTP

set tcp [new Agent/TCP/Newreno]

$tcp set class_ 2

set sink [new Agent/TCPSink]

$ns attach-agent $node_(2) $tcp

$ns attach-agent $node_(8) $sink

$ns connect $tcp $sink

```
set ftp [new Application/FTP]

$ftp attach-agent $tcp

$ns at 10.0 "$ftp start"

set tcp [new Agent/TCP/Newreno]

$tcp set class_ 2

set sink [new Agent/TCPSink]

$ns attach-agent $node_(5) $tcp

$ns attach-agent $node_(0) $sink

$ns connect $tcp $sink

set ftp [new Application/FTP]

$ftp attach-agent $tcp

$ns at 10.0 "$ftp start"
```

Shaqja e dritares se punës

```
proc plotWindow {tcpSource file} {

global ns

set time 0.01

set now [$ns now]

set cwnd [$tcpSource set cwnd_]

puts $file "$now $cwnd"

$ns at [expr $now+$time] "plotWindow $tcpSource $file" }

$ns at 10.1 "plotWindow $tcp $windowVsTime2"
```

 # Është i rëndësishëm deklarimi i pozicioneve të varkës siç është edhe pozicioni filestar, kështu në këtë pjesë do të bëhet deklarimi i pozicionit fillestar të varkës

```
for {set i 0} {$i < $val(nn)} { incr i } {
# 30 percakton madhesine e varkes per nam (network address module)
$ns initial_node_pos $node_($i) 30
}
```

 # Deklarimi i përfundimit të simulimit të varkes

```
for {set i 0} {$i < $val(nn) } { incr i } {
   $ns at $val(stop) "$node_($i) reset";
}
```

 # Dhe si përfundim kjo pjesë e kodit ka të bëjë me mbylljen e simulimit dhe perfundimin e këtij momenti komunikimi mes varkave.

```
$ns at $val(stop) "$ns nam-end-wireless $val(stop)"
$ns at $val(stop) "stop"
$ns at 150 "puts \"end simulation\" ; $ns halt"
proc stop {} {
   global ns tracefd namtrace
   $ns flush-trace
   close $tracefd
   close $namtrace
}
$ns run
```

- **Le të trajtojmë me radhë, duke i shpjeguar, të gjitha ato pjesë kodi që inicializojnë matjen e vonesës pikë me pikë (end to end delay)**

Bit rate, ku do të vendoset edhe koha korente, numri i nyjeve dhe paketave, koha e startimit.

```
cout<<CURRENT_TIME<<endl;
set tcp_(0) [new Agent/TCP]
$ns_ attach-agent $node_(v4) $tcp_(0)
set null_(0) [new Agent/Null]
$ns_ attach-agent $node_(v5) $null_(0)
set cbr_(0) [new Application/Traffic/CBR]
$cbr_(0) set maxpkts_ 1000
$cbr_(0) attach-agent $tcp_(0)
$cbr_(0) set packetSize_ 3
$cbr_(0) set interval_ 0.3
$cbr_(0) set random_ 1
$ns_ connect $tcp_(0) $null_(0)
$ns_ at CURRENT_TIME "$cbr_(0) start"
```

Në këtë pjesë të kodit do të kryhet ngarkimi i rrjetit, burim i rrjetit, vendoset lidhja TCP midis nyjes 4 dhe 5, agjenti është në gjendje të dedektojë një anije të re(nyje te re) vendoset rangu, numri i paketave dhe kryehet aplikimi i ri, ftp.

```
# networkLoad.tcl
set ns $ns_
$ns_ color 1 Green
$ns_ color 1 Red
source trafiku.tcl
# establish TCP connection on node_(4) and node_(5)
set tcp [new Agent/TCP/NewShip]
```

```
$tcp set rate_ 120k

$tcp set packetSize_ 100

set ftp [new Application/FTP]

$ftp attach -agent $tcp

$ns_ at 2.0 "$ftp start"

set sink [new Agent/TCPSink]

$ns_ attach-agent $node_(0) $tcp

$ns_ attach-agent $node_(9) $sink

$ns_ connect $tcp $sink
```

Ndërsa në pjesën e kodit që vjen më poshtë do ti referohemi topologjisë së lëvizjes, ku si fillim përcaktohet origjina për anijet që ndodhen afër ose përgjatë bregut të detit, me tri koordinatat përkatëse x, y, z. Pra vendoset pika e startimit dhe finale për lëvizjen e anijeve/varkave, dhe gjithshtu edhe shpejtësia(fillon me 30 m/s) e tyre.

```
# move.tcl

# set TOPOlogy_Y $val(y)

# The starting origin for the ships along the sea

set ori_x 20.0

set ori_y [expr {$val(y)/30.0}]

set ori_z 0.0

# the final point that the ships move

set final_x 995.0

set final_y [expr {$val(y)/30.0}]

# the speed of the ships along the sea in m/s

set speed 30
```

```
set lane 0
set lanecnt 0
set xpos 0
for {set i 0} {$i < $num_ships} {incr i} {
if {[expr {$i % 10}] == 0} {
incr lane
set xpos 0
}
$node_($i) set X_ [expr {$ori_x + 100 + $xpos * $spacing}]
$node_($i) set Y_ [expr {$ori_y
-
$lane * 15}]
$node_($i) set Z_ $ori_zincr xpos
}
$node_(0) set X_ 5
$node_(0) set Y_ [expr {$ori_y + 30}]
for {set i 0} {$i < $num_ships} {incr i}
{
$ns_ at 0.0 "$node_($i) setdest $final_x $final_y $speed"
}
```

Më në fund kemi arritur tek ajo pjesë e kodit ku do llogaritet End –to end delay i protokollit tonë. Pra skripti i mëposhtëm gjeneron nyjen nga do të fillojë lëvizja si dhe vonesën në trafik pikë me pikë. Vendos kohën për të filluar procedura dhe mbledh kohët, gjerësia e bandwidth_it ruhet në një file dhe rivendos numëruesin

```
# This script generate node movement and traffic delay between end to end devices.
set val (loss)   SignalLoss                    ;# Loss of signal due to weather conditions
set val(chan)    Channel/WirelessChannel       ;# Comunication channel
set val(prop)    Propagation/ThreeRayGround    ;# radio propagation way
set val(netif)   Phy/WirelessPhy               ;# network interface type
set val(ifq)     Queue/DropTail/PriQueue       ;# interface queue type
set val(ll)      LL                            ;# link layer type
set val(ant)     Antenna/OmniAntenna           ;# antenna model
set val(ifqlen)  100                           ;# packet size
set val(nm)      10                            ;# number of ships
set val(rp)      InterNavComm                  ;# routing protocol
set val(x)       1000                          ;# X dimension
set val(y)       20                            ;# Y dimension
set val(stop)    20                            ;# simulation periode
set ns_          [new Simulator]
set node_size 20
set spacing 100
set num_ships $val(nm)
# Record creates periodically records the bandwidth received by
# traffic sinc 0 and writes it to the three files f0
proc record {}
{
global sink f0
```

```
set ns_ [Simulator instance]
# Set the next time to call the prcedure and collect the time and bw
set time 0.5
set bw0 [$sink set bytes_]
set now [$ns_ now]
# Save the bandwidth to a file and reset the counter and set up the next
# time to call record again
puts $f0 "$now [expr $bw0/$time*8/1000000]"
$sink set bytes_ 0
$ns_ at [expr $now+$time] "record"
}
# Printing the window size
proc plotWindow {tcpSource file}
{
global ns_
set time 0.01
set now [$ns_ now]
set cwnd [$tcpSource set cwnd_]
puts $file "$now $cwnd"
$ns_ at [expr $now+$time] "plotWindow $tcpSource $file"
}
proc stop {}
{
```

```
global ns_ tracefd namtrace f0

$ns_ flush-trace

close $tracefd

close $namtrace

close $f0

exec xgraph fourwaytraffic.tr - geometry 800x400 &

#Execute nam on the trace file

exec nam simwrls.nam &

exit 0

}

$ns_trace-all $tracefd

$ns_ namtrace-all-wireless $namtrace $val(x) $val(y)
```

Në këtë pjesë të kodit si fillim konfigurohet protokolli MAC, përdorë standartin 802.11p, krijimi dhe konfigurimi i të githa nyjeve deri në nn numër nyjesh. Përcaktohet modeli i trafikut, pozicioni fillestar i nyjes dhe i tregohet asaj se kur simulimi mbaron, procedura mbaron pas 5 s të kohës së simulimit.

```
# Configure the MAC Protocol to use the 802.11p

standard source IEEE802-11p.tcl

# Initialize the Topography, god object and area

set topo       [new Topography]

set god_ [create-god$val(nm)]

$topo load_flatgrid $val(x) $val(y)

#  Create and configure all the nodes upto nn number of nodes

$ns_ node-config-adhocRouting $val(rp)\
```

```
-lossType $val(lo)\
-llType $val(ll)\
-ifqType $val(ifq)\
-ifqLen $val(ifqlen)\
-antType $val(ant)\
-propType $val(prop)\
-phyType $val(netif)\
-channelType $val(chan)\
-topoInstance $topo\
-movementTrace ON

# set num_nodes [expr {$val(nm) * 2}]
for {set i 0} {$i < $val(nm) } { incr i }
{
set node_($i) [$ns_ node]
}
# Define traffic model
puts "Loading move.tcl file..."
source $val(sc)
puts "Loading networkTraffic.tcl file..."
source $val(cbr)
#Start logging the received bandwidth
$ns_ at 0.0 "record"
```

```
$ns_ at 10.1 "plotWindow $tcp $windowVsTime2"
# Define node initial position in nam
for {set i 0} {$i < $val(nm)} { incr i }
{
# 30 defines the node size for nam
$ns_ initial_node_pos $node_($i) 20
}
# Telling nodes when the simulation ends
for {set i 0} {$i < $val(nm) } { incr i }
{
$ns_ at $val(stop) "$node_($i) reset";
}
# ending nam and the simulation
$ns_ at $val(stop) "$ns_ remote-ship $val(stop)"
$ns_ at $val(stop) "stop"
$ns_ at $val(stop) "puts\"end simulation\" ; $ns_ halt"
#Call the finish procedure after 5 seconds of simulation time
$ns_ run
```

Mbi simulatorin NS2

Ns është një simulator diskret ngjarjesh që drejtohet/tragetohet në hulumtim të rrjeteve. Ns siguron mbështetje të konsiderueshme për simulimin e TCP, rutimit, dhe protokolleve multicast mbi rrjetet me tel dhe pa tel (lokale dhe satelitore). Ns filloi si një variant i simulatorit të rrjetit REAL në vitin 1989 dhe ka evoluar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Në

1995 zhvillimi ns u mbështet nga DARPA përmes projektit VINTnë LBL, Xerox Parc, UCB dhe USC / ISI. Aktualisht zhvillimi i ns mbështetet përmes DARPA me SAMAN dhe përmes NSF me CONSER, në bashkëpunim me studiues të tjerë, duke përfshirë ACIRI. Ns ka përfshirë gjithmonë kontribute të ndjeshme nga studiues të tjerë, duke përfshirë kodin wireless nga projektet UCB Daedelus dhe CMU Monarku dhe Sun Microsystems. NS-2 punon në nivel pakete dhe është kryesisht i bazuar te Unix. Përdor TCL si gjuhë kriptimi.

Parametrat e Simulimit

Numri i Nyjeve(vehicles)	10-50
Hapësira e simulimit	1000m*1000m
Gjerësia e qelizës	300m- 400m
Shpejtesia mesatare e nyjes	0 – 25 metre/second?
Perioda e Simulimit	150 m
Simulation duration:	2 000 seconds

Simulimet:

Simulim 1: Varka Nr 1 si pikë nisje dhe 5 si qendër monitorimi



Simulim 2



Simulim 3



Simulim 4



Simulim 5



Simulim 6



4.2.4 Krahasimi i Protkollit InterNavComm me Protokolle të Tjera.

Gjatë këtij studimi ashtu siç mund të jetë vërejtur në përpjekje për të gjetur një protokoll më eficient dhe të sigurt na është dashur të studiojmë një sërë protokollesh të tjerë që përdoren shpesh në rrjetet ad hoc wireless të komunikimit. Tek kapitulli i parë ku kemi trajtuar protokollet e rrjeteve ad hoc wireless për komunikimet internavale, ndërsa në kap II dhe të III trajtuam sigurinë dhe tipet e ndryshme të protokolleve ad hoc wireless, në fund të kap.3 kemi kryer disa matje me 2 protokolle të ndryshme AODV dhe DSDR, me 2 simulator të ndryshëm MATLAB dhe DARS simulator, dhe nëpërmjet grafikëve dhe simulimeve të kryera kemi nxjerrë dhe konkluzionet përkatëse. Por duke qenë se protokolli ynë **InterNavComm** u realizua për tu përdorur në komunikimet ndër-navale mendojmë ta krahasojmë atë me **Flooding** algorithm pasi flooding/vërshimi ishte një nga teknikat e përdoruara në protokollet e komunikimeve ndër-navale për të cilat kemi folur në kapitullin e parë të këtij punimimi.

Flooding është një teknikë e zakonshme e përdorur shpesh për zbulimin e rrugëve dhe shpërndarjen e informacionit në wired dhe wireless rrjetat ad hoc. Strategjia e rrugëzimit është e thjeshtë dhe nuk bazohet në një mirëmbajtje të kushtueshme të topologjisë së rrjetit

dhe algoritma kompleks të rrugëzimit. Kjo mënyrë përdor një qajse reaktive ku secila nyje që merr data ose paketë kontrolli dërgon paketën te të gjithë fqinjët. Pas transmetimit një paketë ndjek të gjitha rrugët e mundshme.Vetëm në qoftë së rrjeti është i shkëputur, paketa do të gjejë destinacionin final. Ndërkohë që topologjia e rrjetit ndryshon transmetimi i paketës ndjek rrugë të reja.

Në figurën më poshtë konsiderojmë një vërshim/flood nga A; së pari arrin B përmes AB dhe E përmes AE. Më pas C përmbyt CD dhe CH; D përmbyt Dc; F përmbyt FG; G përmbyt GF, siç paraqitet tek fig. b



Figura 4.9. Paraqitja e Flooding nga A në H.

Nisemi nga B vërshon BC, BE, BF, BG dhe E përmbyt EB, EC, ED, EF. Ndërsa H nuk ka kë të vërshoje. Këtu mbaron vërshimi/flooding.

Flooding/përmbytja është forma më e thjeshtë në të cilën mund të ndodh që paketa të replikohet nga nyjet e rrjetit. Për të shmangur që një paketë të qarkullojë vazhdimisht në rrjet një fushë e cila përmban numërimin e hopeve përfshihët në paketë. Fillimisht numerimi i hopevë është vëndosur përafërsisht sa diametri i



Figura 4.10. Simulim nga algoritmi i Flooding

rrjetit. Ndërkohë që paketa udhëton përgjatë rrjetit, numërimi i hopevë zvogëlohet me një për çdo hop që përshkruhet. Kur numërimi i hopeve arrin në zero paketa thjesht bëhet discard. Një efekt i ngjashëm mund të arrihet duke përdorur një fushe time to live, e cila rregjistron numrin e njësive të herëve që paketa është e lejuar të "jetojë" në rrjet. Në përfundim të kësaj kohe, paketa nuk dërgohet më. Flooding mund të përmirësohet në saj të identifikimit unik të paketave të të dhënave, duke detyruar çdo nyje të rrjetit ti bëjë drop të gjitha paketat që ajo tani më i ka drejtuar. Pavarësisht thjeshtësisë së rregullit të drejtimit të paketave dhe kostoja e ulët e mirëmbajtjes, kjo teknikë vuan një sërë të metash.

- Disavantazhi i parë i flooding është ndjeshmëria e tij ndaj implosionit të trafikut. Ky efekt i padëshiruar shkaktohet nga kontrolli i dyfishtë ose dërgimi i paketës së të dhënave pambarimisht te e njëjta nyje. Flooding është ineficient pasi një nyje mund të marrë kopje të shumëfishta të mesazhit.
- Disavantazhi i dytë është problemi i mbivendosjes, overlapping. Overlapping ndodh kur dy nyje që mbulojnë të njëjtën zonë dërgojnë paketa që mbajnë informacion të ngjashëm te e njëjta zonë.
- Disavantazhi i tretë dhe më serioz janë burimet e verbëra. Rregulli i thjeshtë i dërgimit që flooding përdor për të rrugëzuar paketat nuk merr në konsideratë kufizimet e energjisë të nyjeve sensor. Dhe kështu energjia e nyjes mund të konsumohet shpejtë, duke reduktuar ndjeshëm jetëgjatësinë e rrjetit.
- Disavantazh tjetër është edhe kompleksiteti I lartë, N^2.

InterNavComm: Për të adresuar rrugët më të shpejta në krahasim me Flooding, një qasje tjetër referuar si InterNavComm është propozuar, i cili është një derivim i protokollit flooding. I ngjashme me flooding, InterNavComm përdor një rol të thjeshtë të drejtimit dhe nuk kërkon një mirëmbajtje të kushtueshme të topologjisë ose algoritma kompleks të rrugëzimit.

Ndryshe nga flooding, ku një paketë data bëhet broadcast te të gjithë fqinjët, InterNavComm kërkon që secila nyje të dërgojë paketën e ardhur te nyja fqinjë rastësore. Algoritmi fillon me krijimin e infrastrukturës hierarkike virtuale. Nyjet e së njëjtës qelizë ose e qelizave fqinje, që janë brenda rrezes së komunikimit shkëmbejnë mesazhin fillestar "Përshëndetje". Si rezultat çdo nyjë e di pozicionin e të gjitha nyjeve që mund të komunikojnë me të. Në protokollin tonë procesi i update është njësoj si i rutimit gjeografik ndërkohë që nyjet lëvizin në të njëjtin drejtim dhe afërsisht me të njëjtën shpejtësi mesatare në vijë të drejtë. Intervali i update_imit varet nga lëvizshmëria e nyjes, nëse kjo lëvizshmëri është e lartë nevojitet një interval i shkurtër update. Kështu si përfundim për InterNavComm mund të thuhet se:



Figura 4.10. Simulim nga algoritmi InterNavComm

- Ky protokoll është i bazuar në rutimin gjeografik dhe ka një strukturë hierarkike, të organizuar në 3 nivele. Eleminon efektin negativë të stuhive të transmetimit.
- Mënjanon problemin e implosion/kolapsit duke reduktuar numri e paketave që secila nyje dërgon te fqinjët e vetë me një kopje.Vonesa që përjeton një paketë në rrugën e vetë drejt destinacionit mund/duhet të tejkalohet, veçanërisht në një rrjet të madh.
- Protokolli ynë përmirësonë cilësinë dhe besueshmërinë e komunikimeve ndërmjetore duke e mbajtur rrjetin pak të ngarkuar dhe është i vlefshëm edhe në situatat e emergjencës.
- Nëse kompleksiteti i flooding është N^2, kompleksiteti i protokollit tonë të rutimit është N+L, pra më i vogël, një sfidë e protokolleve të rutimit është ulja e kompleksitetit.

- Përdorimi i një strukture hierarkike rrit shkallëzueshmërinë (scalability), nga mënyra sesi performon tregon se rrit efektivitetin dhe sigurinë në komunikimet ndër-navale të emergjencës, breg- anije dhe anije me anije.

V. PËRFUNDIME & KONKLUZIONE

Në këtë punim të tezës jemi përpjekur që të merremi me çështjet e sigurisë në rrjetet ad hoc mobile(MANET). Por dhe me rritjen e sigurisë dhe eficiencës të komunikimit në portet e vogla të qytetit të Vlorës dhe jo vetëm por edhe në të gjithë portet e Shqipërisë.

Po pse morëm në studim rrjetet ad-hoc? Një rrjet mobile ad hoc ka natyrën e hapur të mjeteve të komunikimit dhe lëvizjen e lirë që është arsyeja pse ajo ka nevojë të jetë më tepër e prirur ndaj rreziqeve të sigurisë p.sh ndërhyrjet, shpalosjet e informacionit dhe mohimi i shërbimit etj. Një rrjet mobile ad hoc ka nevojë për nivel të lartë të sigurisë, krahasuar me rrjetet tradicionale me tel. Kështu në këtë temë u diskutuan karakteristikat e ndryshme të MANET dhe disa nga çështjet tipike dhe disa dobësi të rrezikshme në rrjetet mobile ad hoc. Qëllimi tjetër i kësaj çështjeje ishte diskutimi i aspekteve të ndryshme të sigurisë në MANET; së pari u diskutua mbi teknikat shumë-shtresore të zbulimit të ndërfutjes në rrjet in multi hop te MANET; së dyti u diskutuan problemet e sigurisë që lidhen midis rrjetit multi hop dhe nyjeve celulare në rrjet mobile ad hoc.

Më pas janë diskutuar disa nga llojet kryesore të sulmit të rrjetit të lëvizshëm ad hoc që është përdorur për të kërcënuar rrjetet. Ne gjithashtu arritën që të dimë se teknika e zbulimit të ndërhyrjes Multi-layer është e realizueshme në rrjetin multi-hop e MANET; përveç kësaj gjithashtu diskutuam probleme të ndryshme të sigurisë të cilat ndërlidhen ndërmjet rrjetit multi hop dhe nyjeve celular në rrjetin mobile ad hoc. Në fund, ne u morëm me protokollet e rutimit, sjelljen e ndërhyrësit dhe se si të merremi me ndërhyrësin dhe të implementojmë disa nga mekanizmat e sigurisë që mund të përdoren për të ndihmuar rrjetet mobile ad hoc nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme të sigurisë. Dhe si përfundim konkluduam se cili nga protokollet e rutimit është i përshtatshëm për mjedise të ndryshme, psh në qoftë se ne përdorim protokollin e përshtatshëm për një MANET, kështu i

vështirësohet një infiltruesi sulmi ndaj rrjetit. Si përfundim në bazë të vërejtjeve, rrjeti ad hoc wireless është zonë shumë e gjerë, në të cilën studiuesit mund të zbulojnë dhe të hetojnë gjërat e reja në çdo fushë.

Në këtë studim gjejmë studime krahasuese të rrjetit celular dhe rrjetit ad hoc, zonat e aplikimit të rrjetit ad hoc wireless, rrjetit mesh wireless, rrjetit sensor wireless, rrjeti hibrid wireless, skemën e medium access e ad hoc rrjetit pa tel, rutimin në rrjetin ad hoc wireless, multicasting në ad hoc rrjet pa tel, protokollet shtresa transport e ad hoc rrjet pa tel, skema çmimi i ad hoc rrjetit pa tel, cilësia e shërbimit të rrjetit ad hoc wireless, vetorganizimin, sigurinë, menaxhimin e energjisë në rrjetin ad hoc wireless, përparimet e fundit në rrjetet wireless.

Rrjetet Ad Hoc të Automjeteve(VANETs) janë një teknologji e re dhe premtuese, kjo teknologji është një rajon i favorshëm për sulmuesit, të cilët do të përpiqen për të sfiduar rrjetin me sulmet e tyre keqdashëse. Ky dokument dha një analizë të gjerë për sfidat aktuale dhe zgjidhjet, dhe kritikat për këto zgjidhje, gjithashtu u propozua një zgjidhje e re që do të ndihmojë për të mbajtur një rrjet të sigurt VANET, në punën e ardhshme ne duam të zgjerojmë idenë tonë për certifikatat e mesazheve të sigurisë, si duhen krijuar, fshirë, dhe verifikuar dhe duke i verifikuar dhe testuar ato me anë të simulimit. Rrjetet e automjeteve jo vetëm që do të ofrojnë siguri dhe aplikacione për të shpëtuar jetën, por ata do të bëhen një mjet i fuqishëm komunikimi për përdoruesit e tyre.

Pas aksesimit të arkivave dhe dokumentacioneve reale të portit të Vlorës si dhe testimin e protokollit InterNavComm, ashtu si në fushat e tjera të kërkimit shkencor përdorëm simulimet. Gjithashtu si në analizë dhe në simulim u përdor krahasimi me protokolle të tjera ekzistues për komunikimet mjet me mjet.

Konkluzione:

- ✓ Në këtë kërkim shkencor, ne paraqesim një skemë të re të rutimit, protokollin InterNavComm, i cili ofron një zgjidhje efikase, të shkallëzuar. InterNavComm dëshmon të jetë një zgjidhje fleksibile në sfidën e mirëmbajtjes së rrugëzimeve të sakta në rrjetet ad hoc wireless.

- ✓ Pas matjeve dhe simulimeve të kryera, themi se protokolli ynë InterNavComm performon më mirë se protokolle të tjera që përdorin teknikën Flooding. Skema hierakike e përdorur prej këtij protokolli bën të mundur implementimin e një politike ndryshe të shpërndarjes(të mesazheve), duke dhënë një shërbim të diferencuar dhe duke përmirësuar QoS(rëndësia e të cilit është përmendur në kapitujt e këtij punimi). InterNavComm mënjanon problemin e implosion/kolapsit duke reduktuar numri e paketave që secila nyje dërgon te fqinjët e vetë me një kopje Ky protokoll mundëson një komunikim në kohë reale midis distancës së varkave dhe varkave antarë të grupit. Gjithashtu mund të nxjerrim si konkluzion se protokollet e bazuar në topologji reaktive janë më të mirë se protokollet e rutimit të bazuar në topologji proaktive. Dhe protokolli ynë, InterNavComm bënë pjesë në protokolle të bazuar në topologji proaktive.
- ✓ Nëse kompleksiteti i flooding është N^2, kompleksiteti i protokollit tonë të rutimit është N+L, pra më i vogël, një sfidë e protokolleve të rutimit është ulja e kompleksitetit.
- ✓ Ky protokoll përmirëson cilësinë e komunikimeve pikë me pikë dhe është i vlefshëm edhe në situatat e emergjencës.
- ✓ Përdorimi i një strukture hierarkike rrit shkallëzueshmërinë (scalability), nga mënyra sesi performon tregon se rrit efektivitetin dhe sigurinë në komunikimet ndër-navale të emergjencës, breg- anije dhe anije me anije.
- ✓ Nga studimi ynë duket qartë se nevoja e krijimit të aplikimeve të reja, të sigurta pra të besueshme ngrihet edhe në portet shqiptare, dhe implementimi i protokollit tonë të ri InterNavComm edhe në portin e Vlorës, ku është fokusuar më shumë studimi im, do të ndihmonte në plotësimin e mangësive ekzistuese sidomos në ato zona ku mbulimi valor është i ulët ose mungon fare(zonat: Karaburunit, midis Qeparoit dhe Borshit, etj...)
- ✓ Pavarësisht nga kufizimet, mundësitë që të ofron ky protokoll rutimi janë më të mëdha se ato që mund të ofrojnë protokolle te tjera. Me protokoll rutimit InterNavComm arrihet koha minimale e komunikimit me konsumin minimal të

burimeve të rrjetit, si dhe merret parasysh prezenca e zonave 'gri' përgjatë rrugës në të cilin mjeti lëviz.

Puna në të ardhmen: Megjithatë, në tezën tonë kemi pranuar se vlerësimi aktual për artin e zgjidhjeve së sigurisë wireless është thuajse ad hoc. Ka disa të meta të cilat duhet të përmirësohen dhe disa prej tyre janë dhënë më poshtë:

- Mungesa e mjeteve efektive analitike, veçanërisht në rast të vendosjes së rrjetit wireless në shkallë të madhe.
- Gjetja dhe bllokimi i një përdoruesi të autentifikuar, i cili fillon të humbasë sjelljet brenda rrjetit.
- Kompromiset shumëdimensionale midis forcës së sigurisë,
- Komunikimi i sipërm(overhead)
- Llogaritja e kompleksitetit
- Konsumi i energjisë,
- Edhe pse është arritur deri diku Shkallzueshmëria ende mbetet kryesisht e paeksploruar.

Duhet të zhvillohet një metodologji efektive vlerësimi dhe udhrrëfyese që ndoshta do të përdoret dhe do të ketë nevojë për përpjekje ndërdisiplinore nga komunitete të ndryshme kërkimore të cilat janë duke punuar në sistemet celular, cryptography, dhe rrjeteve wireless. Në rastin e sigurisë kalimtare multicast është ende një problem i hapur.

Konstatojmë se :

- Komunikimi efektive ndërmjet mjeteve rritet duke përdorur protokolle efektive rutimi.
- Nje algoritem i mire rutimi mund te shmang bllokimin e trafikut mbi te gjitha linjat.
- Sfida e të gjitha protokolleve adreson në drejtim të shkallëzimit (scalability) dhe efektivitetit. Dhe protokolli ynë i propozuar realizon pikërisht këtë.

- Përmirëson shfrytëzimin e rrjetit në krahasim me protokollet ekzistues per komunikimet anije-për-anije. Ky Protokoll mund të përdoret për të zbatuar shërbimet mobile të diferencuara dhe prioritizimin e mesazhit.
- Le të themi se rrjetat ad hoc janë të mirë- krijuar si një zonë praktike kërkimore. Kanë shumë aplikueshmëri.
- Një protokoll On-demand ofron shumë avantazhe
- AODV i përdor avantazhet si tek Distance-Vector dhe në On-demand
- AODV ka shance të mira për standartizimin.
- Rrjetat Ad hoc mund të vendosen në Internet dhe më pas të sigurojnë domain_et wireles
- Teknikat e autokonfigurimit të addresave janë mirë-përshtatur

SHTOJCA

MESAZH STANDART

I DËRGOHET KAPITENERISË SË PORTIT DREJPËRSËDREJTI OSE NËPËRMJET AGJENSISË 24 ORË PARA MBËRRITJES, VETËM PËR ANIJET QË KRYEJNË OPERACIONET E LARJES SË CISTERNËS ME NAFTË BRUTO GJATË OPERACIONIT TË SHKARKIMIT TË NGARKESËS.

STANDARD MESSAGE

TO BE SENT TO HARBOUR MASTER DIRECTLY OR VIA AGENT 24 HOURS BEFORE ARRIVAL

ONLY FOR SHIPS CARRYING OUT COW DURING DISCHARGE.

- EMRI I ANIJES
- ***SHIP'S NAME***
- *TONAZHI DWT*
- ***TONNAGE DWT***
- CILËSIA DHE SASIA E NGARKESËS QË DO TË SHKARKOHET
- ***QUALITY AND QUANTITY OF CARGO TO BE UNLOADED***
- CILËSIA DHE SASIA E NGARKESËS NË TRANZIT
- ***QUALITY AND QUANTITY OF CARGO IN TRANSIT***
- *DRAFT PËR-NE*-MES ANIJE
- ***DRAFT FORE-AFT-MID SHIP***
- ORA E MBËRRITJES
- ***TIME OF ARRIVAL***
- OPERACIONI I BALLASTIMIT NJËKOHËSISHT ME SHKARKIMIN OSE SHKARKIMI DO TË NDËRPRITET ____ ORE PËR BALLASTIMIN

- ***BALLASTING CONCURRENTLY WITH DISCHARGE OR DISCHARGE WILL BE STOPPED ____ HOURS FOR BALLASTING***
- ANIJA TEKNIKISHT EFICENTE PËR SHKARKIMIN E NGARKESËS PËR TË KRYER OPERACIONET E LARJES SË CISTERNËS ME NAFTE BRUTO (COW)
- ***SHIP TECHNICALLY READY TO UNLOAD CARGO AND TO CARRY OUT COW***
- SISTEMI I GAZIT INERT COW, I KONTROLLUAR DHE ME EFIÇENCË TË PLOTË
- ***INERT GAS AND COW EQUIPMENTS TESTED AND FOUND IN EFFICIENT WORKING CONDITIONS***
- KAPITENI DEKLARON QË CISTERNAT E NGARKESËS JANË INERTIZUAR E MBAJTUR NËN PRESION NORMAL
- ***MASTER DECLARES THAT CARGO TANKS ARE INERTED AND PRESSURIZED***
- KAPITENI DEKLARON QË CILËSIA E OKSIGJENIT E PRANISHME NË CISTERNAT GJATË KRYERJES SË OPERACIONIT TË COW, MBAHET MË POSHTË SE 5% E VOLUMIT
- ***MASTER DECLARES THAT OXYGEN IN TANKS DURING COW OPERATIONS WILL BE KEPT BELOW FIVE PERCENT BY VOLUME***
- ANIJA ËSHTË OSE NUK ËSHTË E PAJISUR ME NJË SISTEM TË MBYLLJES HERMETIKE PËR MARRJEN E KAMPIONEVE TË NGARKESËS (MOSTRAVE)
- ***SHIP IS/IS NOT EQUIPPED WITH VAPOUR LOCK SYSTEM FOR CARGO MEASURING AND SAMPLING***

KOMUNIKIMI ANIJE - TOKË

SHIP-SHORE COMMUNICATIONS

Kanali VHF Telefon

VHF Channel Telephone

Harbour Master

Portit të Vlore – 1

The Port

Përfaqësuesi i Terminalit

Port ***Representative***

_____

_____

Asistenti

Assistant

Piloti

Pilots

Rimorkiatori

Tugger

STACIONI I POMPAVE

BOOSTER STATIONS

_____

_____

_____

_____

Njoftim për Motin

Weather **Report**

PAMJE NGA DISA PORTE TË VLORËS



PORTI I VJETËR,VLORË

PORTI TURISTIK I ORIKUMIT (I JAHTEVE)

PORTI RI,VLORË

I N S T R U K S I O N

PER VENDET E DYSHIMTA KU MUNDE TE KETE AKTIVITET TE KUNDRALIGJSHEM NEPERMJETE KUFIRIT BLU.

Grykderdhja e Lumit SEMAN 40 ^{0}52” 93’ N dhe **19^{0}24”** 24’ **E**

Grykderdhja e Lumit Vjose 40 ^{0}39” 01’N 19 ^{0}0 1” 03’ E

Hidrovori i AKERNIS 40^{0} 35” 65’ N 19^{0} 21”42, E

Hunda e Plakut ZVERNEC 40 32 85 N 19 22,65 E

TRIPORTE 40,29 85 19 N ,22 32. E

Ishulli SAZANIT 40 29 85 N 19 18 11 E

SHEN JANI 40, 26 41 N 19 19 92 E

SHEN JVASI 40 26 41 N 19 18 92 E

SHPELLA E HAXHIALIS 40 26 24 N 19 18 50. E

GJIRI I VARKES 40 24 68 N 19 17 89 E

GJIRI I ARUSHES 40 22 11 N 19 20 67 E

GJIRI I BRISTANIT 40 19 05 N 19,22 27. E

GJIRI I ANGLEZIT 40, 14 26 N 19,26 10 E

GJIRI I GRAMES 40 12 66 N 19 68 63 E

GJIU I DAFINES 40 11 40 N 19,31 06 E

Rruget e BARDHA 40,09 42 N 19,35 71 E

PORTO PALERMO 40, 03 02 N 19,26 93 E

BUNECI 39 56 39 N 19,56 04 E

BORSHE 40 02 25 N 19,51 43 E

KAKOME 39 55 58 N 19,56 58 E

SPILLE 40 05 70 N 19 44 74 E

GJIU I VLORES 40 26 19 N 19 23 94 E

Kanal Jug.Karaburun 40 27 76 N 87 19 17. E

Kanal Veri.Karaburun 40,31 54 N 19 15 99 E

RAGUZA 40 21 30 N 40 24 60 E

GJIRI I DUKATIT 40 20 53 N 19 26 16 E

UJI I FTOHTE 40 25 37 N 19 28 16 E

RADA VLORE 40 26 23 N 19 27 77 E

GJIRI I DURRESIT 41,15 91 N 19 24 89 E

RADA E PALLES 41 27 23 N 19, 21 38 E

Shenim: Keto te dhena jane mare nga manulai i lundrimit dhe jane te vleshme per efekt shpejteise ne kryerjen e veprimeve.

Misionii NJLTKM ne raste kur aktivizohen per kerkim shpetim.

Shërbimi i kërkim-shpëtimit ka për mision, të kryejë operacione të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore dhe detare të RSH, në raste fatkeqësish të ndryshme, për të ndërhyrë, kërkuar, gjetur dhe shpëtuar persona të humbur ose të zhdukur, pra kur jeta njerëzore është në rrezik.

Per kerkim shpetimin ne dete

Roja Bregdetare ka përgjegjësinë e organizimit dhe realizimit të Operacioneve të veçanta në hapësirën detare.

Komponentët e shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR).

Sistemi i shërbimit të kërkimit dhe shpëtimit (SAR) si çdo sistem tjetër ka komponentët e tij, të cilët duhet të punojnë të gjithë së bashku për të siguruar funksionimin e sistemit. Zhvillimi i sistemit të kërkim-shpëtimit kërkon përcaktimin dhe ndarjen e rajoneve të kërkim-shpëtimit (SRR), në bazë të aftësive në marrjen e sinjaleve të rrezikut dhe të koordinimit e sigurimit të shërbimeve të kërkim-shpëtimit brenda këtyre rajoneve. Çdo rajon kërkim-shpëtimi (SRR) ka karakteristika unike si llojin e transportit, klima, topografia, kushtet fizike etj. Këto faktorë krijojnë lloje të ndryshme problemesh gjatë një operacioni kërkim-shpëtimi (SAR) në çdo rajon kërkim-shpëtimi (SRR). Faktorë të tillë influencojnë në zgjedhjen dhe përbërjen e shërbimeve, ambjenteve pajisjeve dhe stafit që kërkohet për çdo incident SAR.

✪ ***Detyrat kryesore.te NJLTKM ne operacionet e kerkim shpetimit.***

a.Të kryejë operacione kërkim-shpëtimi për të shpëtuar të mbijetuarit nga aksidentet dhe fatkeqësitë e ndryshme në tokë e në det;

b.Të kryejë operacione kërkimi-shpëtimi në ujërat territoriale për njerëzit dhe mjetet detare në rrezik;

c.Të kryejë operacione kërkim-shpëtimi të personave ushtarake e civile të humbur e në vështirësi në tokë e në det;

d.Të ndërhyjë për kërkimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve që janë në vështirësi në bashkëpunim me forcat e tjera dhe institucionet shtetërorë qendrore e lokale;

e.Të kërkojë dhe shpëtojë anijet e mbytura e mjetet në vështirësi (me persona në bord);

f..Të transportojë urgjent pranë spitaleve të sëmurë dhe të traumatizuar rëndë;

g.Të japë asistencë popullsisë së goditur nga fatkeqësitë natyrore.

h.Të bashkëpunojë me strukturat e kërkim-shpëtimit të vendeve kufitare dhe aleate mbi bazën e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për kërkim-shpëtimin dhe ndihmën e njerëzve në rrezik, shtetas shqiptare ose të huaj, në territorin tokësor dhe në zonën e përgjegjësisë detare të Republikës së Shqipërisë;

i..Të marrë pjesë së bashku me autoritetet kompetente civile qendrore e lokale në operacionet e ndihmës, në aksidentet shumë të rënda katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore, duke ndihmuar per te realizuar operacionet komplekse të kërkim-shpëtimit të strukturave tokësore, apo detare që përfshihen në to, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve për shpëtim dhe ndihmë.

Përveç sistemeve të përshtatshme të lundrimit dhe radio- aparaturave të përdorshme, në bord të mjeteve detare duhet të jenë edhe këto pajisje:

- Një kopje listë të Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve.
- Një kopje të manualit I.M.C.O MERSAR
- Varka dhe mjete shpëtimi, pajisje e veshje nënujore
- Fenerë, llamba kuti ndriçuese e tymuese, fishekë zjarri etj.
- Radio mobile (UHF,VHF) , GPS,
- Ushqime të ndryshme dhe pije të ngrohta
- Dylbi (të zakonshme dhe me rreze infra), aparate fotografike, kamera

- Pajisje mjekësore të ndihmës shëndetësore për dhënien e ndihmës shumë personave në të njëjtën kohë.

Pajisjet e kerkim shpetimit.

Pajisjet e një mjeti kërkim-shpëtimi përveç pajisjeve normale që e bëjnë të mundshëm kryerjen e një operacioni kërkim-shpëtimi (aparaturat e përshtatshme për navigacion e radiokomunikim, vende komode për vrojtim, rezervuar karburanti ndihmës etj) duhet të jenë të gatshëm për përdorim dhe këto pajisje:

a. Dylbi;

b. Një kopje liste e kodit ndërkombëtar të sinjaleve:

c. Pajisje sinjalizuese, llamba, altoparlant, materiale piroteknike etj;

d. Radiostacione të mbartshme (VHF/UHF), kuti ndriçuese, kuti tymuese për përcaktimin e pozicionit të të mbijetuarve;

e. Paketa furnizimi me materiale të mbijetesës;

f. Fikse zjarri;

g. Aparate fotografik;

h. Pajisje shëndetësore të ndihmës shëndetësore;

i. Barela, pajisje për marrjen me vinç nga helikopteri, etj.

ANEKSI III

DETAJE TEKNIKE TË PAJISJEVE TË SINJALEVE ZANORE

1. Sirena

a. Distancat dhe frekuencat e dëgjimit të zërit

Frekuenca bazë e sinjalit do të shtrihet brenda intervalit 70-700 Hz.

Distanca e dëgjimit të sinjalit nga sirena do të përcaktohet nga ato frekuenca të cilat mund të përfshijnë frekuencat bazë dhe ose më të larta, të cilat shtrihen brenda intervalit 180-700

Hz (1 për qind) dhe të cilat japin nivele presioni të zërit të specifikuar në paragrafin 1(c) më poshtë.

b. Kufijtë e frekuencave bazë

Për të siguruar një shumëllojshmëri të gjerë të karakteristikave të sirenave, frekuenca bazë e një sirene do të jetë ndërmjet kufijve që vijojnë:

- 70-200 Hz për një anije me gjatësi 200 metra ose më shumë;
- 130-350 Hz për një anije me gjatësi 75 metra, por më pak se 200 metra;
- 250-700 Hz për një anije me gjatësi më të vogël se 75 metra.

c. Intensiteti i sinjaleve zanore dhe hapësira e dëgjimit

Një sirenë e montuar në anije në drejtimin e intensitetit maksimal të sirenës dhe në një distancë prej 1 metër nga ajo duhet të japë një nivel presioni zanor minimumi 1/3 e bandës oktave brenda hapësirës së frekuencave prej 180-700 Hz (1 për qind) të jo më pak se shifrave përkatëse të dhëna në tabelën më poshtë:

Gjatësia e anijes në metra	1/3 e nivelit të bandës oktave në 1 metër në dB referuar 2x10-5 N/m2	Distanca e dëgjimit në milje detare
200 ose më shumë	143	2
75 por më pak se 200	138	1.5
20 por më pak se 75	130	1
Më pak se 20	120	0.5

Distanca e dëgjimit në tabelën e mësipërme është për informacion dhe e përafërt me atë në të cilën një sirenë mund të dëgjohet në akset përpara anijes me probabilitet 90 për qind në kushtet e një ajri të pastër në bordin e anijes, duke pasur një mjedis mesatar niveli zhurme në vendet e dëgjimit (i marrë 68 dB në brezin e oktavës të përqendruar në 250 Hz dhe 63 dB në brezin e oktavës të përqendruar në 500 Hz).

Në praktikë distanca në të cilën mund të dëgjohet një sirenë është ekstremisht e ndryshme dhe varet në mënyrë kritike nga kushtet e motit; vlerat e dhëna mund të konsiderohen si tipike, por në kushtet e erës së fortë ose ambiente me nivel të madh zhurme në postet e dëgjimit mund të reduktohet shumë.

d. Pajisjet me drejtim

Niveli i presionit të zërit të një sirene me drejtim do të jetë jo më shumë se 4 dB poshtë nivelit të presionit zanor, në akset në çdo drejtim në planin horizontal brenda 45 gradëve nga aksi. Niveli i presionit zanor në çdo drejtim tjetër në planin horizontal do të jetë jo më shumë se 10 dB poshtë nivelit të presionit zanor në akset, kështu që distanca në të gjitha drejtimet do të jetë minimumi gjysma e distancës sesa në akset përpara. Niveli i presionit të zërit do të matet në atë të 1/3 të brezit të oktavës, e cila përcakton distancën e dëgjimit.

e. Pozicioni i sirenës

Kur duhet të përdoret një sirenë me drejtim si e vetmja sirenë në anije, ajo do të instalohet me intensitetin maksimal të drejtuar direkt përpara.

Një sirenë duhet të vendoset në anije praktikisht sa më lart të jetë e mundur, me qëllim të reduktimit të ndërhyrjes të zërave të emetuar, nga pengesa dhe gjithashtu të minimizojë rrezikun e dëmtimit të dëgjimit nga personeli. Niveli i presionit të zërit të sinjalit të vetë anijes në vendin e dëgjimit nuk duhet t'i kalojë 110 dB(A) dhe sa më shumë e praktikueshme nuk duhet të kalojë 100 dB(A).

f. Pajisja me më shumë se dy sirena

Nëse sirenat janë montuar në një distancë nga njëra-tjetra prej më shumë se 100 metra, ajo do të rregullohet në atë mënyrë që ato të mos lëshojnë sinjale spontane.

<u>Kuadri i komandimit</u>

Konsoli është bërë prej GRP dhe i montuar në një copë. Ajo është përshtatur për t'u vendosur në derën komunikuese të kabinës. Pozicioni i makinës është në anën e djathtë, ndërsa tastiera e radio- navigatorit është në të majtë.

Pamja e kuadrit të komandimit

Kuadri i komandimit të drejtuesit

Kuadri i komandimit të drejtuesit përfshin jo vetëm timonin, throttles, instrumentet e motorit dhe çelësat, por edhe çelësin e panelin për dritat, pompën e ËC-së, njësinë larëse-fshirëse, frëngjinë e kontrollit, busullën magnetike, ekranin AIS, Multi-funksional të ekranit FI-50, -33 RD, të dhënat e ekranit, ekosounder Humminbird dhe drita spot.

1. Ekrani Furuno FA-150 AIS	2. Dritë spot
3. Kompas magnetik	4. Humminbird 998CX, ekrani anësor echosounder
5. Ekrani Furuno RD-33 i organizimit të të dhënave	6. Ekrani Furuno FI-50 multi-funksional
7. Instrumentet e motorit (shikoni përshkrimin e hollësishëm më	8. Njësia e kontrollit të larje-fshirjes së xhamave të dritareve

poshtë)	(shikoni përshkrimin e hollësishëm më poshtë)
9. Paneli i çelësave (shikoni përshkrimin e hollësishëm më poshtë)	10. Throttles të motorit, kontrollet e trim dhe animit
11. Timoni	12. Çelësat e motorit

Ekrani Furuno FA-150, busull magnetike, drita spote, ekran Humminbird ekosounder. Shih manualin e ndërtuesit për instrumentet Furuno dhe Humminbird. Rreth Humminbird pamje 3D echosounder, ne kujtojmë se është e mundur të ruhet një sasi e madhe e të dhënave për një kartë shtesë SD (e cila aktualisht nuk është e disponueshme). Të dhënat e ruajtura mund të shfaqen duke përdorur software Humviewer të instaluar në laptopët e vënë në dispozicion.

Ekranet Furuno RD-33 and FI-50 (në krye)

Paneli i çelësave

Çelësat janë të ndarë në seksione. Secili është me etiketë dhe një LED me ngjyrë tregon se aplikimi është në funksion.

"Sirena" është një button që shtypet për të aktivizuar sirenën e instaluar në radar. Ventilatori është instaluar me qëllim që të shkarkojë avujt e benzinës të cilat mund të jenë të pranishme mbi depozitat, për shkak të avullimit të karburantit. Ventilatori (anti-ndezje, i llojit me motor) duhet të punojë për 4 minuta para fillimit OBM. Shih gjithashtu

procedurën "gati për të filluar" në fillim të këtij manuali dhe procedurën "Ndezja e motorit" në vijim.

Kur është e mundur, paralajmëroni njerëzit në bordin e varkës se është e nevojshme një ndalje emergjente.

Kuadri i komandimit të Radio-Navigatorit

Kuadri i komandimit të Radio-Navigatorit është në anën e majtë dhe përfshin të dy radiot VHF dhe UHF, tabelën Furuno, radar dhe të ekranit ekosounder me njësi të kontrollit dhe ekranit Navtex Furuno. Një dorezë është e montuar në tastierë për arsye sigurie. Tabela që është vendosur në mes të dy kuadrove të komandimit dhe e mbështetur nga dy prej tyre (varet nga kuadri i komandimit të majtë), kur nuk përdoret, qëndron e bllokuar vertikalisht, për ta bërë më të lehtë hyrjen në kabinën përpara. Tabela është prej alumini.

Mbi tastierë është vendosur një dritë spot, nën dritaren qendrore, për të ndriçuar tabelën në tryezë.

1. Ekran Furuno NAVTEX NX-300	2. Kuadri i komandimit i radios SEPURA
3. Radio SEPURA me altoparlantë	4. Ekrani multifunksional Furuno MU 155
5. Radio SEPURA me mikrofonin e parë	6. T&T RT5020 VHF radio me kufje
7. Njësia e kontrollit Furuno Navnet 3D	8. Dorezë mbajtëse
9. Socket 12V	

Mjeti lundrues është i pajisur me një tabelë të varur në tastierën e majtë. Ajo duhet të mbahet zakonisht e hapur, me tastierë në të djathtë dhe që përdoret për laptop, hartat detare, etj. Mbylleni atë (d.m.th. vendoseni atë në pozicion vertikal) vetëm kur keni nevojë për hyrje të qetë në kabinë dhe kur anija është e palëvizshme. Është e preferueshme të mos mbahet në këtë pozitë gjatë lundrimit se mund të jetë i rrezikshëm.

KUJDES

Gjatë lundrimit mos i mbani në tryezë tabelat e hartat në pozicion vertikal.

Tabela e hartës e vendosur në mes të kuadrit të komandimit. Copë plastike ose gome në tavolinë për të shmangur dëmet në tastierën e pilotit.

Bullon për të fiksuar tabelën e hartës në pozicion të hapur.

Mbështetëse e fiksuar ndërmjet dritares së majtë dhe asaj qendrore për t'u përdorur kur nuk është e nevojshme tabela e hartës ose kur duhet një akses

Radio Sepura me altoparlantë, ekran Navtex

Mikrofoni i parë Sepura dhe kufje T&T

Radio VHF T&T RT5020 dhe Furuno Navnet

Socket 12V

Poshtë kuadrit të komandimit, nënën e majtë, kutia e njësisë së kontrollit

Furuno HUB-101 i fiksuar te kabina.

Lidhja e PC (komjuter laptop) me Furuno Hub :Në qendër duhet të jetë i lidhur kablli i rrjetit që lejon të lidhë sistemin e Furuno në kompjuter portativ me softëare MaxSea. Ky program lejon të replikohen të gjitha kontrollet e anijes, të ngarkohen harta dhe rrugët, etj, të gjitha të dhënat e lundrimit dhe të varkës që vijnë nga instrumentet Furuno që mund të

Pozicioni i portës Ethernet për t'u përdorur për lidhjen e PC (hiqni kapakun)

Kablli i lidhur

shfaqen duke përdorur kartografi të softëare-it. Ajo do të bëjë gjithashtu të mundur ruajtjen e të dhënave, sipas procedurave të përcaktuara nga programi dhe do të jetë e mundur të shpëtojë vetëm imazhin e treguar nga ana e softëare në një kohë të dhënë duke përdorur procedurën shtyp në ekran - kopjo në aplikim (të tilla si Microsoft Office ® ® Ëord ®). Kjo pastaj do të jetë e mundur për të shtypur të dhënat e ruajtura.

Vini re se, kur lidhni kompjuterin portativ me sistemin, mund të shfaqet një mesazh paralajmërimi, edhe në qoftë se lidhja Ethernet është duke punuar siç duhet: kjo është për shkak të faktit se OS kërkon një lidhje interneti që, në të vërtetë, nuk është i pranishëm, por ky nuk është një mosfunksionim.

Parametrat e lidhjes: adresa I.P.: 172.31.3.150

Subnet mask: 255.255.0.0

KUJDES

Për të gjitha detajet në lidhje me përdorimin e Furuno, Humminbird, Mercury, T & T,: SEPURA, etj. instrumente, radio, softëare Maxsea, etj. ju lutem referojuni manualit

të / ndërtuesit / furnizuesit.

PORTI DURRËS:

Prioritetet kryesore të sigurisë për portin.

Siguria navigacionale në Portin e Durrësit garantohet nga: Sinjalistika detare (fenerët ndricues) e cila mbulohet nga Shërbimi Hidrografik Shqiptar dhe orienton drejt të gjitha anijet (mjetet lundruese) që i afrohen portit dhe radës së Durrësit për të shmangur përplasjet apo rënien në cekëtinë.

Të dhëna më të hollësishme mbi sa më sipër janë të pasqyruara në hartat navigacionale të cilat disponohen nga Shërbimi Hidrografik. Shërbimi i pandërprerë i monitorimit të trafikut detar në Kapitenerinë e Portit ka instruksion të detajuar mbi detyrat që duhet të kryejë gjatë komunikimit me anijet(mjetet lundruese) që i afrohen portit apo radës së Durrësit për ti orientuar në funksion të manovrave të sigurta për qëndrim në radë(spirancë)apo hyrje në port.

Nisur nga këto prioritete është bërë një ndarje më e detajuar si më poshte:

I. Facilitete , që duhet domosdoshmërisht të plotësojnë kodin ISPS,siç janë :
   - Terminali i konteinerëve
   - Terminali i trageteve

- Terminali shumëqëllimësh i kalatës perëndimore
- Terminali i mallrave rifuxho.
- Pontoni i karburantit

II. Facilitete dhe instalime , që nevojiten të përmirësohen duke qenë se konsiderohen pika të dobëta nga pikëpamja e sigurisë për operacione portuale por që nuk ndikohen nga kodi ISPS siç janë :
    - Porti në përgjithësi (hyrjet e portit , rrethimi i portit , ndricimi, dhoma e kontrollit të sigurisë etj).
    - Zonat e kufizuara , që nuk i përkasin faciliteteve të Portit që mund të jenë në përputhje me Kodin ISPS.
    - Zona e depozitave të karburantit
    - Kantieri Detar

III. Facilite dhe instalime që nuk përbëjnë pika të dobëta për operacionet portuale në përgjithësi dhe as preken nga Kodi ISPS , dhe për të cilat nuk janë propozuar masa specifike përmirësuese siç janë :
    - Porti i Peshkimit
    - Pjesa me e madhe e ndërtesave të administratës së autoritetit portual dhe facilitete të tjera .
    - Pjesa me e madhe e kompanive të vogla të vendosura në port.

Plani i sigurisë së Portit të Durrësit

Plani i sigurisë së Portit të Durrësit është aprovuar në 11 korrik 2007 , në të cilin është përcaktuar Niveli 1 i sigurisë detare për portin e Durrësit, është miratuar nga ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit

- Azhornimi i fundit i planeve të sigurisë është kryer nga oficeri i sigurisë së portit dhe janë miratuar nga Drejtori i APD-së në Janar 2012
- Plani i Sigurisë së Portit është përditësuar(çdo 1 vit) me ndryshimet infrastrukturore të kryera në Portin e Durrësit gjatë këtyre viteve.
- Eshtë aprovuar plani i emergjencave për Portin dhe hartuar plane rezerve dhe atyre të evakuimit, bazuar në kërkesat e kodit ISPS.

Zonat kryesore të sigurisë

Bazuar në planin e sigurisë janë përcaktuar 7 zona kryesore sigurie , ku secila prej tyre ka planin dhe oficerin e vet të sigurisë. Zonat e përcaktuara janë:

1. Porti në përgjithësi (zona e ngarkesave të përgjithshme dhe kalata lindore)
2. Terminal i konteinerëve
3. Terminal i trageteve
4. Porti i peshkimit . (që ndodhet brenda portit)
5. Kantieri detar
6. Depot e karburantit
7. Pontoni i karburanteve

Të gjitha zonat janë të rrethuara në përputhje me kërkesat e kodit ISPS dhe të pajisur me ndriçimin dhe sinjalistikën e nevojshme. Duke marrë në konsiderate punimet civile të rikonstruksionit në kalatën lindore , zona afër terminalit të trageteve (kalata 8) përdoret momentalisht për mallra rifuxho.



Të dhënat mbi trafikun në Portin e Durrësit ne vitet 2011 - 2015

Volumet e punës së APD-së për vitet si më poshtë					
PËRSHKRIMI	**2011**	**2012**	2013	2014	2015
TON TOTAL	**3.490.723**	**3.516.447**	**3.569.670**	**3.717.992**	**3.496.366**
EKSPORT	1.326.038	1.341.531	1.665.839	1.606.154	1.340.328
IMPORT	2.164.685	2.174.916	1.903.831	2.111.838	2.156.038
ANIJE TOTAL	**2.086**	**1.941**	**1.635**	**1.702**	**1.617**

Të dhënat mbi trafikun në Terminalin e Trageteve në vitet 2011 - 2015

Volumet e punës së APD-së për vitet si më poshtë					
PËRSHKRIMI	**2011**	**2012**	2013	2014	2015
TON TOTAL	**3.490.723**	**3.516.447**	**3.569.670**	**3.717.992**	**3.496.366**
EKSPORT	1.326.038	1.341.531	1.665.839	1.606.154	1.340.328
IMPORT	2.164.685	2.174.916	1.903.831	2.111.838	2.156.038
ANIJE TOTAL	**2.086**	**1.941**	**1.635**	**1.702**	**1.617**

BIBLIOGRAFIA

Jam mbështetur dhe kam ndjekur udhëzimet Chicago & APA(2001) përsa i përketë përdorimit të referencave në tekst.

Disa prej tyre:

- Andrew Tanenbaum, Computer networks.
- Jim Kurose, Computer Networks- A top down approach.
- Të dhëna të arshivuara të marra nga Marina: "Reparti Delta Forcë për kufirin dhe Migracionin Vlorë", Porti i Vjetër Vlorë dhe http://www.apdurres.com.al/(faqe kryesore për Portin e Durrësit).
- Mohamed Watfa "Survey of Routing Protocols in Vehicular Ad Hoc Networks" 2010, IGI Global.
- Simple AODV for MANET implementation and Source code in MATLAB, by Rupam
- H.Karl, A.Willing, "Protocols and Architectures for Wireless Sensor Networks".
- C. Siva Ram Murthy and B.S. Manoj " A text book on Ad Hoc Wireless Network architectures and protocols" Pearson Education 2013.
- E.Royer,Ch.K.Toh. A Review of Current Routing Protocols Ad Hoc Mobile Wireless Networks. IEE Personal Communication, Aprile 1999.
- Tom Seymour, Ali Shaheen :" History of Wireless Communication", Minot State University, USA , The Clute Institute, 2011.
- Charles E. Perkins and Elizabeth M. Royer. Ad-Hoc On-Demand Distance Vector Routing. In Proceedings of the 2nd IEEE Workshop on Mobile Computing Systems and Applications (WMCSA), pages 90–100, New Orleans, LA, February 1999.
- Fan Li and Yu Wang, "Vehicular Ad HocNetworks: A Survey" , IEEE Vehicular Technology Magazine, June 2007
- J. Jubin and J. Tornow, "The DARPA Packet Radio Network Protocols," Proc. /E€€, vol. 75, no. 1, 1987, pp, 21-32.

- David B. Johnson and David A. Maltz. Dynamic Source Routing in Ad Hoc Wireless Networks. In Tomasz Imielinski and Hank Korth, editors, Mobile Computing, volume 353, pages 153–181. Kluwer Academic Publishers, 1996
- L.R.Ford Jr. And D.R.Fulkerson, Flows in Networks, Princenton Univ. Press, 1962
- K. Sohraby, D.Minoli And T.Znati, "Wireless Sensor Networks Technology, Protocols and Applications", John Wiley & Sons New York 2007
- Mihail L. Sichitiu, Maria Kihl "Inter-Vehicle Communication Systems:A Survey" , IEEE Communications Surveys & Tutorials • 2nd Quarter 2008
- S. Murthy and J. J. Garcia-Luna-Aceves, "An Efficient Routing Protocol for Wireless Networks," ACM Mobile Networks and App. 1.. Special Issue on Routing in Mobile Communication Networks, Oct. 1996, pp. 183-97.
- L.Kleinrock and K.Stevens,"Fisheye: A Lenslike Computer Display Transformation," Technical report, UCLA, Computer Science Department, 1971.
- K. Sohraby ,D. Minoli And T. Znati ,"Wireless Sensor Networks Technology, Protocols,and Applications". John Wiley & Sons, New York, 2007.
- H. Karl ,A. Willig ,"Protocols and Architectures for Wireless Sensor Networks". John Wiley & Sons, New York, 2005 Jaya Bhatt, Naveen Hemrajani, "Effective Routing Protocol (DSDV) for Mobile Ad Hoc Network " International Journal of Soft Computing and Engineering (IJSCE) ISSN: 2231-2307, Volume-3, Issue-5, November 2013.
- Muhammad Arshad Ali &Yasir Sarwar "Security Issues regarding MANET (Mobile Ad Hoc Networks): Challenges and Solutions", Computer Science Thesis no: MCS-2011-11 March 2011.
- M.Durresi, A.Durresi, L.Barolli. Hierarchical Communications for Battlefields. 21st International Conference on Advanced Information Networking and Applications Workshops, 2007 IEEE.
- M.Durresi, A.Durresi, L.Barolli. Optimized Geographical Routing Protocol for Vehicle Communications. Proceedings of the 25th IEE International Conference on

Distributed Computing System Workshops, 2005. International Conference on Advanced Information Networking and Applications Workshops, 2007.

- A. Sugikawa, Y. Morioka, K. Iwamura, Y. Tajika and M. Nakamura, "A computerized support system for nomadic collaboration", in Proceedings of MoMuC2: Second International Workshop on Mobile Multi-Media Communications, April 1995.
- Anu Chaudhary, K.K Gautam, Nirbhay Ahlawat "Effect of Cross Layer optimization of Traffic Management in Ad HOC Mobile Network", (IJCSIS) International Journal of Computer Science and Information Security,Vol. 12, No. 4, April 2014
- Soufiene Djahel, Ronan Doolan, Gabriel-Miro Muntean, and John Murphy "A Communications-Oriented Perspective on TrafficManagement Systems for Smart Cities: Challengesand Innovative Approaches", IEEE Communication Surveys & Tutorials, Vol. 17, No. 1, First Quarter 2015.
- K.Prasanth, Dr.K.Duraiswamy, K.Jayasudha, and Dr.C.Chandrasekar, "Improved Packet Forwarding Approach In Vehicular Ad Hoc Networks Using Rdgr Algorithm", International Journal of Next Generation Network (IJNGN), Vol.2, No.1, March 2010